A·320·2
(3)
EX 1912

Të = Dalëtë

LIBRARY OF THE
Massachusetts
Bible Society

Catalog No. A 320 : 2 (3) / EX 1912
Family INDO-EUROPEAN
Sub-Family THRACO-ILLYRIAN
Branch ILLYRIC
Group —
Language ALBANIAN
Dialect UNION
Locality Albania
Contents EXODUS
Version UNION
Translator
Published by Shtyp. Treg. Nër Kom.
Place MANASTIR] bëtare
Date 1912
Accession No. 492
Accession Date SEPT 17, 1930
Price $ 1 / 16

Të = Dalëtë

Kthyerë prej Evraishtesë

MANASTIR

Shtypëshkronja Treg. Nërkombëtare

1912

TË-DALËTË

Krye 1.

1 Edhe këta janë emërat' e të bijvet të Is-
railit që hynë ndë Egjyptë bashkë me Jako-
binë; hynë gjithë-si-cili bashkë me fëmijën'
2 e ti. Rubini, Simeoni, Leviu, e Juda, Issahari,
3 Zabuloni, e Beniamini, 4) Dani e Neftaliu,
5 Gadi e Asheri. Edhe gjithë shpirtëratë që
duallë nga mezi i Jakobit ishinë shtatë-dhjetë
shpirt; edhe Josifi ishte ndë Egjyptë.
6 Edhe Josifi vdiq, edhe gjithë të vëllezërit'
7 e atij, edhe gjith' ay bres. Edhe të bijt' e Is-
railit ushtuan' e ushumuanë fort tepërë, e u-
shumëzuan' edhe uforcuanë fort shumë; edhe
umbush vëndi nga ata.
8 Edhe ungrit një mbret i-ri ndë Egjyptë,
9 i-cili nuk' e njihte Josifnë. Edhe i tha kom-
bit të ti, Na kombi i të bijvet të Israilit tek
është më i-shumë edhe më i-fortë se neve;
10 Eni, letë punojmë me urtësi kundrë atyreve,
që të mos shtonenë *më shumë*, edhe ndë
gjaftë ndonjë luftë, të mos bashkonenë edhe
këta me armiqtë t' anë, edhe të luftonjënë
kundrë nesh, e të ikënjënë nga vëndi ynë.
11 Vunë pra përmbi ata kujdestarë të punëra-
vet, që t'i mundonin' ata me punërat' e atyre

të-rënda; edhe ndërtuanë për Faraonë qytete
12 për grunarë, Pithomënë, edhe Raamsesënë. Po
sa më tepërë i mundonin' ata, kaqë më tepërë
shumoneshin' e shtoneshinë. Edhe *Egjyptianëtë*
s' gjeninë të-prëjturë për të bijt' e Israilit.
13 Edhe Egjyptianëtë i mundoninë fort të bijt'
14 e Israilit. Edhe u hidhëroninë atyre jetënë me
punë të-rënda, ndë baltët, e ndë pëqisat, e
ndë gjithë punët të fushavet; gjithë punëtë,
me të-cilatë i mundoninë, ishinë të-ashpëra.
15 Edhe mbreti i Egjyptianëvet u foli ma-
micavet t' Ebrejvet, prej të-cilavet njëra qu-
16 hej Shifrahë, edhe tjetëra Puahë; Edhe tha,
Kur u bëni punën' e mamicësë gravet t' E-
brenjvet, edhe shihni ato mbi fronin' e të-pje-
llit, ndë qëntë mashkull, vrit-e-ni atë; po ndë
17 qëntë femërë, atëhere letë rronjë. Po mami-
catë kishinë frikë Perëndie, edhe nukë bëninë,
si i urdhëroj mbreti i Egjyptësë, po i lininë
të-gjallë meshkujtë.
18 Edhe mbreti i Egjyptësë thirri mamicatë,
e u tha, Përse bëtë këtë punë, e latë mesh-
19 kujtë të-gjallë? Edhe mamicatë i thanë Fa-
raonit, Se grat' e Ebrenjvet nukë janë posi
grat' e Egjyptianëvet; sepse janë të-shëndo-
sha, edhe lirohenë përpara se të hynjënë ma-
20 micatë ndër ato. Edhe Perëndia u bënte mirë
mamicavet; edhe gjindja shtonej e forconej
21 fort. Edhe passi mamicatë i kishinë frikë Pe-
rëndisë, u bëri atyre shtëpi.

22 Edhe Faraoni urdhëroj gjithë gjindjen' e ti, dyke thënë, Çdo mashkull që të lintnjë, hidh-e-ni ndë lumët; edhe çdo femërë, lir-e-ni të rronjë.

Krye 2.

1 Edhe vate një njeri nga shtëpia e Leviut, edhe mori *për grua* një nga të bijat' e Leviut.
2 Edhe gruaja umbars, e polli djalë; edhe kur pa, se ishte një djal' i-bukurë, e fshehu atë
3 tre muaj. Edhe passi s' muntte më t'a fshihte atë, mori një arkë prej kulmaku, edhe e leu me asfalltë e me pisë, edhe vuri djalënë nd' atë, edhe e la atë ndër kallamet buzë lumit.
4 Edhe e motër' e ati përgjonte për-së-largu, që të shihte se ç' dot' i bënej ati.
5 Edhe e bij' e Faraonit sbriti që të lahej ndë lumët, edhe shërbëtoret' e asaj po ecëninë buzë lumit; edhe kur pa arkënë ndër mest të kallamevet, dërgoj shërbëtoren' e saj,
6 edhe e mori. Edhe kur e hapi, pa djalënë, edhe na foshneja tek po qante. Edhe i udhëmp asaj për atë, e tha, Ky është nga djemt' e Ebrenjvet.
7 Atëhere e motër' e ati i tha së bijës' së Faraonit, A do të vete e të të thërres një *grua* pëllore nga grat' e Ebrenjvet, që të t' i
8 apë sisë djalit? Edhe e bija e Faraonit i tha, Ecë. Edhe vashëza vate, e thirri t' ëmën' e
9 djalit. Edhe e bija e Faraonit i tha asaj, Merr

këtë djalë, e m'i ep sisë, edhe unë dotë t'a
ap pagënë t'ënde. Edhe gruaja mori djalënë,
10 e i epte sisë. Edhe si urrit djali, j'a pruri së
bijës' së Faraonit, edhe ubë i bir'i asaj. Edhe
j'a vuri emërinë Moisi, sepse, tha, e nxora
nga ujëtë.
11 Edhe nd' ato dit, Moisiu, passi ubë i-math,
dolli te të vëllezërit' e ti, edhe vuri re punë-
rat' e atyre të-rënda; edhe pa një Egjyptian
që rrihte një Ebre, një nga të vëllezërit'e ti.
12 Edhe si vuri re përqark andej e këtej, edhe
pa se nuk' ishte njeri, vrau Egjyptianinë, edhe
e fshehu ndë rërët.
13 Edhe dolli të-dytënë ditë, edhe na dy bu-
rra Ebrenj tek po ziheshinë; edhe i tha ati
që bënte keq, Përse reh të-afërminë t' ënt?
14 Edhe ay *i* tha, Cili të vuri të-parë e gjyka-
tës mbi ne? apo mos do të më vrasç sikun-
drë vrare Egjyptianinë? Edhe Moisiu utrëmp,
e tha, Me të-vërtetë këjo punë umuar vesh.
15 Edhe Faraoni, kur dëgjoj këtë punë, kër-
konte t'a vriste Moisinë; po Moisiu iku nga
syt' e Faraonit, edhe ndënji ndë dhet të Ma-
16 dhiamësë; edhe ndënji afërë një pusi. Edhe
prifti i Madhiamësë kishte shtatë bija, të-cilatë
erthnë e nxuarrë ujë, edhe mbushnë govatatë,
17 që t' u epninë ujë dhënet t' atit të tyre. Edhe
erdhë barinjtë, e i dëbuan' ato; po Moisiu u-
ngrit, e u ndihu atyreve, edhe u dha ujë dhë-
18 net t' atyre. Edhe kur erthnë te Reuili, tek

i at' i tyre, u tha atyre, Si erthtë kaqë çpejt
19 sot? Edhe ato thanë, Një *njeri* Egjyptian na
shpëtoj nga duart' e barinjvet, edhe na nxori
20 ujë, e u dha dhënet të pinë. Edhe ay u tha
bijavet të ti, E ku ësht' ay? përse e latë
jashtë njerinë? thërrit-e-ni atë të hajë bukë.
21 Edhe Moisiut i erdhi mirë të rrijë bashkë
me atë njeri, i-cili i dha Moisiut *për grua*
22 Zepporahënë, të bijën' e ti. Edhe *ajo* polli
djalë; edhe ay j'a vuri emërin' ati Gjersom,
sepse, tha, jam i-huaj ndë dhe të-huaj.
23 Edhe pas shumë kohe, mbreti i Egjyptësë
vdiq; edhe të bijt' e Israilit psherëtitnë nga
robëria, edhe klithnë; edhe klithma e atyreve
24 hipi te Perëndia për punë të robërisë. Edhe
Perëndia dëgjoj psherëtimën' e atyre, edhe Pe-
rëndia pruri ndër mëntt dhiatën' e ti me A-
25 braamin' e me Isaakun' e me Jakobinë. Edhe
Perëndia shtyri sytë mbi të bijt' e Israilit,
edhe Perëndia njohu gjëndjen' e atyre.

Krye 3.

1 Edhe Moisiu kulloste dhënt' e Jethrojt, vë-
jehërrit të ti, priftit të Madhiamësë; edhe pru-
ri dhëntë nd' anët prapa shkretëtirësë, edhe
2 erdhi ndë malt të Perëndisë, ndë Horib. Edhe
i uduk ati ëngjëlli i Zotit ndë flakë zjarri
nga mezi i një ferre, edhe na tek ishte nde-
zurë ferra, edhe ferra nukë digjej.
3 Edhe Moisiu tha, Letë kthenem, e letë

shikonj këtë pamje të-madhe, përse ferra
4 nukë digjetë. Edhe kur pa Zoti *Moisinë* se
ukthye të shikonte, Perëndia i thërriti ati nga
mezi i ferrësë, e tha, Moisi, Moisi. Edhe ay
5 tha, Na këtu jam unë. Edhe tha, Mos uafëro
këtu; sgith shojet' e tu nga këmbët' e tua, se-
pse vëndi, përmbi të-cilinë qëndron, është
6 dhe i-shënjtëruarë. Edhe *i* tha *ati*, Unë jam
Perëndia i t' yt et, Perëndia i Abraamit, Pe-
rëndia i Isaakut, e Perëndia i Jakobit. Edhe
Moisiu fshehu faqen' e ti; sepse kishte frikë
të shtinte sytë mbë Perëndinë.
7 Edhe Zoti tha, Pashë, pashë të-vuajturit'
e gjindjesë s' ime që është ndë Egjyptë, edhe
dëgjova klithmën' e atyreve për punë të keq-
mundonjësvet t' atyre; sepse i di hidhërimet'
8 e atyreve; Edhe sbrita që t' i shpëtonj ata
nga dora e Egjyptianëvet, edhe t' i nxjer ata
nga ay dhe mbë një dhe të-mirë e të-gjerë,
mbë një dhe që rrjeth qumësht e mjaltë, ndë
vëntt të Hanaanitëvet, e të Hittitëvet, e të
Amoritëvet, e të Ferizzitëvet, e të Hivitëvet,
9 e të Jebusitëvet. Edhe tashi na klithma e të
bijvet të Israilit tek erdhi tek unë; mbi këto
pashë edhe shtrëngimnë me të-cilin' i shtrën-
10 gonjën' Egjyptianëtë. Eja pra tashi, edhe dotë
të dërgonj te Faraoni, edhe dotë nxjerç gjin-
djenë t' ime, të bijt' e Israilit, nga Egjypta.
11 Edhe Moisiu i upërgjeq Perëndisë, Cili
jam unë, që të vete te Faraoni, e të nxjer të
bijt' e Israilit nga Egjypta?

12 Edhe *Perëndia* tha, Me të-vërtetë unë dotë
jem bashkë me ty, edhe këjo dotë jetë shë-
nja mbë ty, se unë të dërgova ty; passi të
nxjerç gjindjenë nga Epjypta, dot' i shërbeni
Perëndisë mbë këtë mal.
13 Edhe Moisiu i tha Perëndisë, Na unë *kur*
të vete te të bijt' e Israilit, edhe t' u them
atyre, Perëndia i atërvet t' uaj më ka dërgu-
arë te ju, edhe ata ndë pyeçinë, Ç' emër ka
ay? ç' t' u them atyreve?
14 Edhe Perëndia i tha Moisiut, **Unë jam ay**
që jam; edhe tha, kështu dot' u thuash të
bijet të Israilit, **Ay që është** më dërgoj te ju.
15 Pastaj Perëndia i tha Moisiut, Kështu dot'
u thuash të bijvet të Israilit: Zoti, Perën-
dia i atërvet t' uaj, Perëndia i Abraamit, Pe-
rëndia i Isaakut, e Perëndia i Jakobit, më dër-
goj te ju; ky është emëri im për gjithë jetënë,
edhe këta është të-përmënduritë t' im breza
16 pas brezash. Shko, e mblith bashkë pleqt' e
Israilit, edhe thuaj-u atyre, Zoti, Perëndia i
atërvet t' uaj, Perëndia i Abraamit, i Isaakut, e
i Jakobit, m' uduk, e më tha, U vështrova
juve me të-vërtetë, edhe gjithë sa u bënjënë
17 juve ndë Egjyptë; Edhe thashë, Dot' u ngjit
juve nga të-vuajturit' e Egjyptësë ndë dhet të
Hanaanitëvet, e të Hittitëvet, e të Amoritëvet,
e të Ferizzitëvet, e të Hivitëvet, e të Jebusi-
tëvet, ndë një dhe që rrjeth qumësht e mjal-
18 të; Edhe dot' i dëgjonjënë zërit t' ënt; edhe

dotë veç ti edhe pleqësia e Israilit, edhe dot' i thoni ati, Zoti, Perëndia i Ebrenjvet, upoq me ne; tashi pra lërë-na të vemi tri dit udhë ndë shkretëtirët, që t'i bëjmë kurban Zotit,
19 Perëndisë t' ënë. Edhe un' e di, se mbreti i Egjyptësë nukë dot' u lërë juve të vini, nukë,
20 as me dorë të-fortë. Po dotë ndenj dorënë t' ime, edhe dot' i bje Egjyptësë me gjithë çudit' e mia që dotë bënj ndë mest t' asaj; *edhe*
21 pastaj dot' u lëshonjë juve. Edhe dot' i ap hir kësaj gjindjeje përpara Egjyptianëvet; edhe kur të ikëni, nukë dotë shkoni me duar
22 të-sbrazëta; Po çdo grua ka për të kërkuarë nga fëqinja e saj, edhe nga ajo që rri ndë shtëpit t' asaj, gjërëra të-ergjëntta, e gjërëra t' arta, e rroba; edhe dot' i viri mbi bijt' t' uaj, e mbi bijat' t' uaj, edhe kështu dotë svishni Egjyptianëtë.

Krye 4.

1 Edhe Moisiu upërgjeq e tha, Po na tek nukë dotë më besonjënë, as nukë dot' i dëgjonjënë zërit t' im; sepse dotë thonë, Nukë t' uduk ty Zoti.
2 Edhe Zoti i tha ati, Ç' është këjo që ke
3 ndë dorët t' ënde? Edhe ay tha, Stap. Edhe tha, Hidh-e përdhe. Edhe ay e hodhi përdhe, edhe ubë gjargër; edhe Moisiu iku që për-
4 para ati. Edhe Zoti i tha Moisiut, Ndej dorënë t' ënde, edhe zër'-e prej bishti; (edhe

ay ndejti dorën' e ti, edhe e zuri, edhe ubë
5 stap ndë dorët t' ati;) Që të besonjënë se t'
uduk Zoti, Perëndia i atërvet t' atyre, Perën-
dia i Abraamit, Perëndia i Isaakut, edhe Pe-
rëndia i Jakobit.

6 Pastaj Zoti i tha ati, Vërë dorënë t' ënde
ndë gjit t' ënt. Edhe vuri dorën' e ti ndë gjit
të ti; edhe kur e nxori, na dora e ati tek
ishte e-krromosurë, *e-bardhë* posi dëbora.
7 Edhe tha, Vërë përsëri dorënë t' ënde ndë
gjit t' ënt; edhe vuri dorën' e ti ndë gjit të
ti; edhe kur e nxori nga gjiri i ti, na tek
8 ishte prapë posi *tjetëri* mishi i ati. Edhe Zoti
tha, Ndë mos të besofshinë, as ndë mos i
dëgjofshinë zërit të shënjës' së-parë, dot' i
9 besonjënë zërit të shënjës' së-dytë. Edhe ndë
mos u besofshinë edhe këtyre të dy shënja-
ve, as ndë mos i dëgjofshinë zërit t' ënt, dotë
marrç nga ujët' e lumit, edhe dot' e derthç
mbi tokët; edhe ujëtë që të marrç nga lumi
dotë bënetë gjak mbi tokët.

10 Edhe Moisiu i tha Zotit, Zot, unë nukë
jam njeri i fjalësë as që dje as që parëdje, as
që kur i fole shërbëtorit t' ënt; sepse jam
gojë-mbajturë e gjuhë-mbajturë.

11 Edhe Zoti i tha ati, Kush i ka dhënë go-
jë njeriut? a kush e ka bërë të-pagojinë, a
të-shurdhërinë, a atë që sheh, a të-verbërinë?
12 a nukë jam unë Zoti? Tashi pra shko, edhe

unë dotë jem bashkë me gojënë t' ënde, edhe dotë të mësonj ç' duhetë të flasç.

13 Edhe ay tha, Të lutem, o Zot, dërgo me dorën' e ati që ke për të dërguarë.

14 Edhe Zotit i undes zëmërimi kundrë Moisiut, edhe tha, A nuk' është Aaron Leviti vëllaj yt? e di se ay munt të flasë mirë. Edhe na tek po vjen që të të pjekë; edhe kur të të shohë ty, dotë gëzonetë ndë zëmërët të ti.

15 Ti pra dot' i flasç ati, edhe dot' i vësh fjalëtë ndë gojët t' ati; edhe unë dotë jem bashkë me gojënë t' ënde, edhe bashkë me gojën' e ati, edhe dot' u mësonj juve ç' duhetë të bëni.

16 Edhe ay dot' i flasë gjindjesë ndë vëntt t' ënt; edhe ay dotë të jetë ndë vënt goje, edhe

17 ti dotë jesh tek ay si Perëndi. Edhe merr ndë dorët t' ënde këtë stap, me të-cilinë dotë bënjç shënjatë.

18 Edhe Moisiu shkoj te Jethroj, i vjehërri i ti, edhe i tha ati, Të lutem, letë vete, e letë kthenem te t' im vëllezër, që janë ndë Egjyptë, edhe letë shoh, ndë janë edhe gjall. Edhe Jethroj i tha Moisiut, Shko ndë paqtim.

19 Edhe Zoti i tha Moisiut ndë Madhiam, Shko e ukthe ndë Egjyptë; sepse vdiqnë gjith' ata njerëzitë që kërkoninë jetënë t' ënde.

20 Atëhere Moisiu mori me vetëhe gruan' e ti e djemt' e ti, edhe i hipi ata mbi një gomar, e ukthye ndë dhet të Egjyptësë; mori Moisiu edhe stapin' e Perëndisë ndë dorët të ti.

21 Edhe Zoti i tha Moisiut, Kur të veç prapë ndë Egjyptë, shiko të bënjç përpara Faraonit gjithë çuditë që vura ndë dorët t' ënde; po unë dot' i ashpëronj ati zëmërënë, edhe nukë
22 dotë lërë gjindjenë të shkonjë. Edhe dot' i thuash Faraonit, Kështu thotë Zoti, Israili
23 është biri im, i-parëlinduri im; Edhe të thashë ty, Lësho t' im bir, që të më shërbenjë; edhe nukë deshe t'a lësh të shkonjë; na tek dotë vras t' ët bir, të-parëlindurinë t' ënt.
24 Edhe *Moisiu* kur ishte mb' udhë, nd' atë vënt që kishte rënë, Zoti upoq me atë, edhe
25 kërkonte t'a vriste. Edhe Sepfora mori një gur të-prehëtë, e preu lafshën' e të birt, edhe e hodhi ndër këmbët t' ati, edhe tha, Me të-
26 vërtetë burrë gjaku je tek unë. Edhe *Zoti* iku prej ati. Atëhere ajo tha, Burrë gjaku *je*, për punë të rrethpresjesë.
27 Edhe Zoti i tha Aaronit, Shko të pjekç Moisinë ndë shkretëtirët. Edhe *ay* vate e upoq me atë ndë malt të Perëndisë, edh' e
28 puthi atë. Moisiu i tregoj Aaronit gjithë fjalët' e Zotit, me të-cilat' e kish dërguarë, edhe gjithë shënjatë që i kishte urdhëruarë.
29 Vanë pra Moisiu edhe Aaroni, edhe mblothnë gjithë pleqt' e të bijvet të Israilit;
30 Edhe Aaroni foli gjithë fjalëtë që i kishte folurë Zoti Moisiut, edhe bëri shënjatë përpa-
31 ra gjindjesë. Edhe gjindja besoj; edhe kur dëgjoj, se Zoti kishte vështruarë të bijt' e Is-

railit, edhe se kishte parë të-vuarët' e atyre, unjnë kryetë edhe ufalnë.

Krye 5.

1 Pastaj Moisiu ëdhe Aaroni erdhë e i thanë Faraonit, Kështu thotë Zoti, Perëndia i Israilit, Lërë gjindjenë t' ime të shkonjë, që të kremtëronjënë për mua ndë shkretëtirët.
2 Edhe Faraoni tha, Cili është Zoti, që t' i dëgjonj zërit t' ati për të lënë Israilinë të shkonjë? nuk' e njoh Zonë, edhe as Israilinë s' e kam për të lënë të shkonjë.
3 Edhe ata thanë, Perëndia i Ebrenjvet upoq me ne; të lutemi, Lërë-na të vemi tri dit udhë ndë shkretëtirët, që t' i bëjmë kurban Zotit, Perëndisë t' ënë, semos vinjë mbi ne me murtajë, a me thikë.
4 Edhe mbreti i Egjyptësë u tha atyre, Përse, o Moisi e o Aaron, e ndaloni gjindjenë nga punët' e tyre? shkoni ndë punët t' uaj.
5 Edhe Faraoni tha, Na gjindja e vëndit tek është tashi fort e-shumë, edhe ju i bëni ata
6 të pushonjënë nga punët' e tyre. Edhe atë ditë Faraoni urdhëroj keqmundonjësit' e gjindjesë,
7 edhe krerët' e atyre, dyke thënë, Të mos i epni më *kësaj* gjindjeje kashtë, posi gjer tashi, që të bënjënë pëqisa; letë venë vetë, edhe letë mblethnjënë kashtë për vetëhen' e tyre;
8 Edhe dot' i vini ata *të bënjënë* aqë pëqisa sa bëninë *edhe* më parë; asfare të mos u'a pa-

kësoni; sepse mbetenë pa punë, *edhe* përandaj thërresën' e thonë, Letë vemi *e* t' i
9 bëjmë kurban Perëndisë t' ënë. Let' u vihenë këtyre njerësve punë më të-rënda, që të mundonenë me to, e të mos u vënë vesh fjalëve të-rreme.
10 Duallë pra keqmundonjësit' e gjindjesë, edhe krerët' e atyreve, edhe i folnë gjindjesë, dyke thënë, Kështu tha Faraoni, Nukë dot'
11 u ap juve kashtë; Ju vetë shkoni, e mblithni kashtë, ku të muntni të gjeni; po asgjë
12 nukë dotë pakësonetë nga puna juaj. Kështu gjindja upërnda ndëpër gjithë dhen' e Egjyptësë, për të mbledhurë kallame ndë vëntt të
13 kashtësë. Edhe keqmundonjësitë i shtrëngoninë, dyke thënë, Mbaroni punëtë t' uaj, punëtë *t' uaj* të-përdiçime sikundrë edhe kur *u*
14 epej kashta. Edhe ufrushkulluanë krerët' e të bijvet të Israilit, të-cilëtë i kishinë vënë mbi ata keqmundonjësit' e Faraonit, dyke thënë, Përse nukë mbaruatë dje edhe sot punën' e-ndarë mbë ju, dyke bërë pëqisa posi
15 përpara? Atëhere krerët' e të bijvet të Israilit erthnë e klithnë te Faraoni, dyke thënë, Për-
16 se u bën kështu shërbëtorëvet të tu? Kashtë nuk' u epetë shërbëtorëvet të tu, edhe na thonë, Bëni pëqisa; edhe na tek frushkullonenë shërbëtorët' e tu; po faji është i gjin-
17 djesë s' ate. Po ay upërgjeq, Ju jeni përtesës, ju përtoni; përandaj thoni, Lërë-na të vemi, e

18 t'i bëjmë kurban Zotit. Shkoni pra tashi, *e*
punoni; sepse nukë dot' u epetë kashtë juve;
edhe gjithatë numurë pëqisash dot' epni.
19 Edhe krerët' e të bijvet të Israilit panë se
ishinë ndë gjëndje të-keqe, passi *u* than' atyre,
Nukë dotë pakësoni asgjë nga pëqisatë, nga
20 punëtë *t' uaj* të-përdiçime. Edhe si duallë nga
Faraoni, upoqnë me Moisinë e me Aaroninë,
21 të-cilëtë rrininë ndë udhët *e i pritninë;* Edhe
u thanë atyre, Zoti paftë mbi ju, e u gjykoftë;
sepse ju bëtë erënë t'ënë të qelburë përpara
Faraonit, e përpara shërbëtorëvet t' ati, kaqë
sa të epni kordhë ndë duart t' atyre, që të
na vrasënë.
22 Atëhere Moisiu ukthye te Zoti, e tha, O
Zot, përse i bëre keq kësaj gjindjeje? përse
23 më dërgove? Sepse passi erdha te Faraoni e
i fola mb' emërit t' ënt, e shtrëngoj këtë gjin-
dje; edhe ti asfare nuk' e shpëtove gjindjenë
t' ënde.

Krye 6.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Tashi dotë shohç
se ç' i kam për të bërë Faraonit; sepse me
anë të një dore së-fortë dot' i lërë ata të
shkonjënë, edhe me anë të një dore së-fortë
dot' i dëbonjë ata nga dheu i ti.
2 Pastaj Perëndia i foli Moisiut, edhe i tha
3 ati, Unë jam **Jehovahu;** Edhe i udukçë Abra-
amit, Isaakut, e Jakobit *me emër* Perëndi

Gjithë-pushetës, po me emërinë t' im **Jehovah**
4 nuk' unjohva tek ata. Pastaj bëra me ata
dhiatënë t' ime, t' u ap atyre dhen' e Hanaa-
nit, den' e të-ndënjurit t' atyre, ndë të-cilët
5 ndënjnë si të-huaj. Edhe unë dëgjova edhe
psherëtimën' e të bijvet të Israilit, të-cilët
Egjyptianëtë i mbanjënë ndë robëri; edhe
6 prura ndër mëntt dhiatënë t' ime. Përandaj
thuaj-u të bijvet të Israilit, Unë jam Jehovahu,
edhe dot' u nxjer juve që ndënë punërat' e-
rënda të Egjyptianëvet, edhe dot' u shpëtonj
juve nga robëria e atyreve, edhe dot' u çpër-
blenj juve me krah të-ndejturë, edhe me gjy-
7 qe të-mëdhej; Edhe dot' u marr juve gjindje
për vetëhenë t' ime, edhe dotë jem Perëndia
juaj; edhe dotë njihni, se unë jam Jehovahu,
Perëndia juaj, që u nxjer juve që ndënë
8 punërat' e-rënda t' Egjyptianëvet; Edhe dot' u
bje juve nd' atë dhe, për të-cilinë ngrita do-
rënë t' ime, se dot' j'a ap Abraamit, Isaakut,
e Jakobit; edhe dot' u'a ap atë juve për tra-
shëgim. Unë jam Jehovahu.
9 Edhe Moisiu u foli kështu të bijvet të I-
srailit; po ata nuk' i dëgjuanë Moisiut, për
punë të shtrëngimit të shpirtit, edhe për pu-
në të robëris' s' ashpërë.
10 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
11 Hyrë, *e* fol'-i Faraonit, mbretit t' Egjyptësë, të
lërë të bijt' e Israilit të dalënë jashtë nga
12 dheu i ti. Atëhere Moisiu foli përpara Zotit,

edhe tha, Të bijt' e Israilit na tek nukë më dëgjuanë; e qysh dotë më dëgjonjë Faraoni mua që jam me buzë të-parrethprera.

13 Edhe Zoti i foli Moisiut edhe Aaronit, edhe u dha atyre urdhërë *të venë* te të bijt' e Israilit, e te Faraoni, mbreti i Egjyptësë, që të nxjerrënë të bijt' e Israilit nga dheu i Egjyptësë.

14 Këta janë krerët' e shtëpivet t' atërvet të tyre; të bijt' e Rubinit, të-parëlindurit të Israilit, Hanohu, e Falluj, Hezroni, e Karmiu; këta janë fiset' e Rubinit.

15 Edhe të bijt' e Simeonit, Jemuili, e Jamini, e Ohadi, e Jaqini, e Johari, e Shaulli, i biri i një gruaje Hanaanite; këta janë fiset' e Simeonit.

16 Edhe këta janë emërat' e të bijvet të Leviut, pas brezavet t' atyre, Gjersoni, e Kohathi, e Merariu; edhe vjett' e jetës' së Leviut ishinë
17 një qint e tri-dhjet' e shtatë vjet. Të bijt' e Gjersonit ishinë Libniu e Shimeiu, pas fise-
18 vet t' atyre. Edhe të bijt' e Kohathit *ishinë* Amrami, e Izhari, e Hebroni, e Uzzieli; edhe vjett' e jetës' së Kohathit ishinë një qint e
19 tri-dhjet' e tre vjet. Edhe të bijt' e Merariut *ishinë* Mahliu e Mushiu. Këta janë fiset' e Leviut, pas brezavet t' atyre.

20 Edhe Amrami mori grua për vetëhen' e ti të motrën' e t' et Johebedë; Edhe ajo i polli ati Aaronin' e Moisinë; edhe vjett' e jetës' s'

Amramit ishinë një qint e tri-dhjet' e shtatë vjet.
21 Edhe të bijt' e Izharit *ishinë* Korahu, e
22 Nefegu, e Zihriu. Edhe të bijt' e Uzzielit, Mi-
23 shaili, e Elzafani, e Zithriu. Edhe Aaroni mori grua për vetëhen' e ti Elishebanë, të bijën' e Amminadabit, të motërën' e Naashonit; edhe ajo i polli ati Nadabinë e Abihanë, Eleazari-
24 në e Ithamarinë. Edhe të bijt' e Korahut, Assiri, e Elkanahu, e Abiasafi; këta janë fi-
25 set' e Korahitëvet. Edhe Eleazari, i bir' i Aaronit, mori grua për vetëhen' e ti një nga të bijat' e Putielit; edhe ajo i polli ati Finehasinë. Këta jane krerët' e *shtëpivet* të atërvet të Levitëvet, pas fisevet t' atyre.
26 Këta janë Aaroni e Moisiu, të-cilëvet u foli Zoti, Nxirni të bijt' e Israilit nga
27 dheu i Egjyptësë, pas tufëvet t' atyre. Këta janë ata që i folnë Faraonit, mbretit t' Egjyptësë, për të nxjerrë të bijt' e Israilit nga E-
28 gjypta. Edhe atë ditë që i foli Moisiut Zoti
29 ndë dhet të Egjyptësë, Zoti i tha Moisiut, dyke thënë, Unë jam Zoti; fol'-i Faraonit, mbretit t' Egjyptësë, gjithë sa të them ty.
30 Edhe Moisiu tha përpara Zotit, Na unë tek jam me buzë të-parethprera; edhe qysh dotë më dëgjonjë Faraoni?

Krye 7.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shih, unë të bëra perëndi te Faraoni; edhe Aaroni, yt vëlla, dotë

2 jetë profiti yt. Ti ke për të folurë gjithë sa
që të urdhëronj; edhe Aaroni, yt vëlla, dot' i
flasë Faraonit, që të lërë të bijt' e Israilit të
3 dalënë nga dheu i ti. Edhe unë dotë ashpë-
ronj zëmërën' e Faraonit, edhe dotë shumonj
shënjat' e mia e çudit' e mia ndë dhet t' E-
4 gjyptësë. Po Faraoni nukë dot' u dëgjonjë
juve; edhe dotë vë dorënë t' ime mbi Egjyp-
tënë, edhe dotë nxjer ushtërit' e-mia, gjin-
djenë t' ime, të bijt' e Israilit, nga dheu i E-
5 gjyptësë me gjyqe të-mbëdhenj. Edhe Egjyp-
tianëtë dotë njohënë, se unë jam Zoti, kur
të ndenj dorënë t' ime mbi Egjyptënë, edhe
të nxjer të bijt' e Israilit nga mezi i atyre.
6 Edhe Moisiu e Aaroni bënë kështu: si-
7 kundrë i urdhëroj Zoti ata, kështu bënë. Edhe
Moisiu ishte tetë-dhjetë vjeç plak, edhe Aa-
roni tetë-dhjet' e tre vjeç, kur i folnë Faraonit.
8 Edhe Zoti i tha Moisiut e Aaronit, dyke
9 thënë, Kur t' u thotë juve Faraoni, dyke thë-
në, Dëfte-më-ni një çudi për vetëhenë t' uaj,
atëhere t' i thuash Aaronit, Merr stapinë t' ënt,
e hidh-e poshtë përpara Faraonit; *edhe* dotë
bënetë gjarpër.
10 Moisiu pra edhe Aaroni hynë te Faraoni,
edhe bënë kështu, sikundrë i kishte urdhëru-
arë Zoti; edhe Aaraoni hodhi poshtë stapin'
e ti përpera Faraonit, e përpara shërbëtorë-
vet t' ati, edhe ubë gjarpër.
11 Edhe Faraoni thirri të-diturit' e magjista-

rëtë; edhe magjistarët' e Egjyptësë bënë edhe
ata kështu me mjeshtërit' e tyre të-fshehëta.
12 Sepse nga ata gjithë-sicili hodhi poshtë stapn'
e ti, edhe ubënë gjërpinj; po stapi i Aaronit
13 i përpiu stëpinjt' e atyre. Edhe zëmëra e Fa-
raonit uashpërua, edhe nuk' u dëgjoj atyre;
sikundrë kishte folurë Zoti.
14 Edhe Zoti i tha Moisiut, Zëmëra e Fara-
onit uashpërua; nukë dotë lërë gjindjenë të
15 shkonjë. Shko te Faraoni nesërë ndë mën-
gjest; na tek po del ndë ujët; edhe të rrish
buzë lumit, që të piqesh me atë; edhe stapnë
që ubë gjarpër t'a marrç ndë dorët t' ënde.
16 Edhe t' i thuash ati, Zoti, Perëndia i Ebrenj-
vet, më dërgoj te ti, dyke thënë, Lërë gjin-
djenë t' ime të shkonjënë, që të më lusnjënë
ndë shkretëtirët; po ti na tek nukë dëgjove
17 gjer tashi. Kështu thotë Zoti, Me këtë dotë
njohç, se unë jam Zoti; na me këtë stap që
kam ndë dorët i' ime dotë u bje ujëravet që
18 janë ndë lumët, edhe dotë bënenë gjak. Edhe
pishqetë që janë ndë lumët dotë ngorthnjënë,
edhe lumi dotë qelbetë; edhe Egjyptianëvet
dot' u vinjë të-ndohëtë të pinë ujë nga lumi.
19 Edhe Zoti i tha Moisiut, Thuaj Aaronit,
Merr stapnë t' ënt, edhe ndej dorënë t' ënde
mbi ujërat të Egjyptësë, mbi rrëket t' atyre,
e mbi lumënjt t' atyre, e mbi kënetat t' atyre,
e mbi gjithë pellgjet t' atyre, që të bënenë
gjak; edhe dotë jetë gjak ndëpër gjithë dhen'

e Egjyptësë, edhe ndë enët të-ndrunjta edhe ndë enët të-gurta.

20 Edhe Moisiu e Aaroni bënë kështu, sikundrë urdhëroj Zoti; edhe Aaroni ngriti stapnë, e u ra ujëravet që ishinë ndë lumët përpara Faraonit, e përpara shërbëtorëvet t' ati; edhe gjithë ujëratë që ishinë ndë lumët ubënë gjak.

21 Edhe pishqetë që ishinë ndë lumët ngorthnë, edhe lumi uqelp, edhe Egjyptianëtë nukë muntninë të pininë ujë nga lumi; edhe ishte gjak ndëpër gjithë dhen' e Egjyptësë.

22 Po edhe magjistarët' e Egjyptësë bënë gjithashtu me mjeshtërit' e tyre të-fshehëta; edhe zëmëra e Faraonit uashpërua, edhe nuk' u dëgjoj atyre, sikundrë kishte thënë Zoti,

23 Edhe Faraoni ukthye, e erdhi ndë shtëpit të ti, edhe nuk' usbut zëmëra e ati as nga këjo.

24 Edhe gjithë Egjyptianëtë rëmoninë qark lumit për *të gjeturë* ujë që të pininë; sepse nukë muntninë të pininë nga ujët' e lumit.

25 Edhe umbushnë shtatë dit, që kur i ra lumit Zoti.

Krye 8.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko te Faraoni, e i thuaj ati, Kështu thotë Zoti, Lërë gjindjenë t' ime të shkonjë, që të më lusnjënë.

2 Edhe ndë mos daç t' i lësh të shkonjënë, na unë tek dot' u bje gjithë sinorëvet të tu me

3 bretëkosa; Edhe lumi dotë mizëronjë me bre-

tëkosa, të cilatë dotë dalënë, e dotë hynjënë ndë shtëpit t' ënde, e ndë dhomët që fle, e mbi shtratt t' ënt, e ndë shtëpirat të shërbëtorëvet të tu, e mbi gjindjenë t' ënde, e ndëpër furrat të tua, e ndëpër magjet të tua;
4 Edhe mbi ty, e mbi gjindjenë t' ënde, e mbi gjithë shërbëtorët' e tu, dotë hipënjënë bretëkosatë.
5 Edhe Zoti i tha Moisiut, Thuaj Aaronit, Ndej dorënë t' ënde me stapnë t' ënt mbi rrëket, mbi lumënjt, e mbi kënetat, edhe bëj të hipënjënë bretëkosa mbi dhet t' Egjyptësë.
6 Edhe Aaroni ndejti dorën' e ti mbi ujërat të Egjyptësë; edhe hipnë bretëkosatë, e mbulu-
7 anë dhen' e Egjyptësë. Po edhe magjistarëtë bënë kështu me magjit' e tyre, edhe bënë të hipënjënë bretëkosa mbi dhet t' Egjyptësë.
8 Atëhere Faraoni dërgoj e thirri Moisinë edhe Aaroninë, e tha, I ulutni Zotit të ngrerë bretëkosatë nga unë, e nga gjindja ime; edhe dotë lë gjindjenë të venë e t' i bënjënë kurban Zotit.
9 Edhe Moisiu i tha Faraonit, Kij këtë lavdi mbë mua; për ç' kohë të lutem për ty, e për shërhëtorët' e tu, e për gjindjenë t' ënde, që të farosenë bretëkosatë nga ti, e nga shtëpit' e tua, edhe të mbetenë vetëmë ndë lumët?
10 Edhe ay tha, Për nesërë. Edhe tha, Dotë bënetë pas fjalësë s' ate, që të njohç se s' ka
11 asndonjë posi Zoti, Perëndia unë; Edhe dotë

ngrihenë brëtëkosatë nga ti, e nga shtëpit' e tua, e nga shërbëtorët' e tu, e nga gjindja jote; vetëmë ndë lumët dotë mbetenë.

12 Atëhere Moisiu edhe Aaroni duallë nga Faraoni; edhe Moisiu thërriti mbë Zotinë për bretëkosatë që kishte prurë mbi Faraonë.
13 Edhe Zoti bëri sipas fjalës' së Moisiut; edhe bretëkosatë ngothnë nga shtëpitë, nga obo-
14 rrëtë, e nga aratë. Edhe i mblothnë togje
15 togje, edhe dheu uqelp. Edhe Faraoni kur pa se gjeti prëhje, ashpëroj zëmërën' e ti, edhe nuk' u dëgjoj atyre; sikundrë kishte folurë Zoti.

16 Edhe Zoti i tha Moisiut, Thuaj Aaronit, Ndej stapnë t' ënt edhe bjer'-i pluhurit të dheut, që të bënetë këpusha ndëpër gjithë
17 dhen' e Egjyptësë. Edhe bënë kështu; Aaroni ndejti dorën' e ti me stapn' e ti, edhe i ra pluhurit të dheut, edhe ubë këpusha mbi njerëzit e mbi bagëtit; gjithë pluhuri i dheut ubë këpusha ndëpër gjithë dhen' e Egjyptësë.

18 Po edhe magjistarëtë bënë kështu me magjit' e tyre, për të nxjerrë këpusha, po nukë muntnë; këpushatë pra ishinë mbi njerëzit e
19 mbi bagëtit. Atëhere magjistarëtë i thanë Faraonit, Këjo është gisht Perëndie. Po zëmëra e Faraonit uashpërua, edhe nuk' u dëgjoj atyre; sikundrë kishte foturë Zoti.

20 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ngreu çpejt ndë mëngjest, edhe qëndro përpara Faraonit; na

tek del ndë ujët; edhe i thuaj, Kështu thotë
Zoti, Lërë gjindjenë t' ime të vejë, që të më
21 lusnjënë. Ndryshe, ndë mos daç të lësh gjin-
djenë të vejë, na tek dotë dërgonj shumica
mizash qënsh mbi ty, e mbi shërbëtorët' e tu,
e mbi gjindjenë t' ënde, e ndëpër shtëpit të
tua; edhe shëpit' e Egjyptianëvet dotë mbu-
shenë me miza qënsh, si edhe dheu përmbi
22 të-cilinë rrinë. Po atë ditë dotë ndanj veç
dhen' e Goshenit, ndë të-cilët rri gjindja ime,
që të mos ketë atje asfare miza qënsh, me
qëllim që të njohç se unë jam Zoti ndë mest
23 të dheut. Edhe dotë bënj të-çquarë ndë mest
të gjindjesë s' ime e të gjindjesë s' ate; ne-
sërë dotë bënetë këjo shënjë.
24 Edhe Zoti bëri kështu, edhe erdhë shu-
mica mizash qënsh të-këqia ndë shtëpit të
Faraonit, e ndë shtëpirat të shërbëtorëvet
t' ati; e ndë gjithë dhet të Egjyptësë dheu
uvduar nga mizat' e qënet.
25 Edhe Faraoni dërgoj e thirri Moisin' e A-
aroninë, e tha, Shkoni, *e* i bëni kurban Pe-
26 rëndisë t' uaj ndë *këtë* dhe. Edhe Moisiu tha,
Nukë gjan të bënetë kështu; sepse neve dot'
i bëjmë Zotit Perëndisë t' ënë kurbanë, të-
cilëtë Egjyptianëtë i kanë të ndyrë; na neve
ndë bëfshimë kurbanë, të-cilët' Egjyptianëtë
i kanë të-ndyrë, përpara syvet t' atyre, a nu-
27 kë dotë na vrasënë me gurë? Dotë vemi tri
dit udhë ndë shkretëtirët, edhe dot' i bëjmë

kurban Zotit, Perëndisë t' ënë, sikundrë dotë
28 na porositnjë. Atëhere Faraoni tha, Unë dot'
u lë të veni, që t'i bëni kurban Zotit, Pe-
rëndisë t'uaj, ndë shkretëtirët; vetëmë të mos
29 shkoni shumë lark; lutuni për mua. Edhe
Moisiu tha, Na unë tek po dal prej teje, edhe
dot' i lutem Zotit, që të ngrihenë mizat' e
qënvet nesërë nga Faraoni, e nga shërbëtorët'
e ati, e nga gjindja e ati; veç letë mos na gë-
njenjë edhe më Faraoni, dyke mos lënë gjin-
djenë të vejë, që t'i bënjënë kurban Zotit.
30 Atëhere Moisiu dolli nga Faraoni, e i u-
31 lut Zotit. Edhe Zoti bëri sipas fjalës' së Mo-
isiut; edhe ngriti mizat' e qënvet nga Faraoni,
e nga shërbëtorët' ë ati, e nga gjindja e ati;
32 nukë mbeti asnjë. Po Faraoni edhe këtë herë
ashpëroj zëmërën' e tij, edhe nuk' e la gjin-
djenë të shkonjë.

Krye 9.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko te Faraoni,
e i thuaj, Kështu thotë Zoti, Perëndia i E-
brenjvet, Lërë gjindjenë t'ime të vejë, që të
2 më lusnjënë. Sepse ndë mos daç t'i lësh të
3 venë, e ndë i mbafsh ata edhe më, Na dora
e Zotit tek dotë jetë mbi bagëtit që janë ndë
fushët, mbi kuajt, mbi gomarët, mbi kamillat,
mbi qet, e mbi dhënt; *dotë jetë* një murtajë
4 fort e-keqe. Edhe Zoti dotë bënjë çquarje ndë
mest të bagëtivet të Israilit e të bagëtivet të

Egjyptianëvet; edhe nga gjithë sa janë të bij-
5 vet të Israilit nukë dotë ngorthnjë asnjë. Edhe
Zoti ndau kohënë, e tha, Nesërë dot'a bënjë
Zoti këtë punë ndë dhet.
6 Edhe Zoti bëri këtë punë ditën' e-nesërme,
edhe ngorthnë gjithë bagëtit' e Egjyptianëvet;
po nga bagëtit' e të bijvet të Israilit nukë
7 ngordhi asnjë. Edhe Faraoni dërgoj *të shihte*,
edhe na tek s' kishte ngordhurë asnjë nga
bagëtit' e Israilitëvet. Po zëmëra e Faraonit
uashpërua, edhe nukë la gjindjenë të shko-
njënë.
8 Atëhere Zoti i tha Moisiut edhe Aaronit,
Mbushni duartë t' uaj me hi furre, edhe let'a
çpërndanjë atë drejt qiellit Moisiu përpara
9 Faraonit. Edhe dotë bënetë një pluhur i-ho-
llë mbi gjithë dhen' e Egjyptësë, edhe dotë
bënetë mbi njerëzit, e mbi bagëtit, një të-
nxehëtë që nxjer koqeza me qelp, ndëpër gji-
thë dhen' e Egjyptësë.
10 Muarrë pra hi të furrësë, edhe qëndruanë
përpara Faraonit; edhe Moisiu e çpërndau
atë drejt qiellit, edhe ubë një të-nxehëtë që
nxirte koqeza me qelp mbi njerëzit e mbi
11 bagëtit. Edhe magjistarëtë nukë muntninë të
qëndroninë përpara Moisiut, nga puna e të-
nxehëtit; sepse të-nxehëtitë ishte mbi ma-
12 gjistarët, e mbi të-gjithë Egjyptianet. Edhe
Zoti i ashpëroj zëmërënë Faraonit, edhe nuk'

u dëgjoj atyre; sikundrë i kishte folurë Moisiut Zoti.

13 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ngreu çpejt ndë mëngjest, edhe qëndro përpara Faraonit, e i thuaj, Kështu thotë Zoti, Perëndia i Ebrenjvet, Lërë gjindjenë t'.ime të vejë, që të më
14 lusnjënë. Sepse këtë herë dotë dërgoj gjithë plagët' e mia mbi zëmërënë t' ënde, e mbi gjithë shërbëtorët' e tu, e mbi gjindjenë t'ënde; që të njohç se nuk' është asndonjë posi unë
15 mbi gjithë dhenë. Sepse tashi dotë ndenj dorënë t' ime, edhe dotë bje ty edhe gjindjesë s' ate me murtajë, edhe dotë vdiresh nga
16 dheu. Edhë me të-vërtetë për këtë punë të-ruajta, që të dëftenj ty fuqinë t' ime, edhe që të lëçitetë emëri im ndëpër gjithë dhenë.
17 Edhe po je kryelartë kundrë gjindjesë s'imë,
18 që të mos i lësh ata të shkonjënë? Na nesërë si mbë këtë kohë tek dotë bënj të bjerë breshër fort i-keq, që i-atillë s' ka rënë kurrë ndonjë herë ndë Egjyptë që atë ditë
19 që uthemelua *e* gjer tashi. Tashi pra dërgo të mblethç me të-çpejtë bagëtit' e tua, edhe gjithë ç' ke ndë fushët; *sepse* mbi çdo njeri e shtëzë që të gjendetë ndë fushat, e të mos bihetë ndë shtëpit, dotë bjerë breshër mbi ato, edhe dotë vdirenë.
20 Nga shërbëtorët' e Faraonit ay që pat frikë nga flal' e Zotit mblodhi çpejt ndëpër shtëpit shërbëtorët' e ti, e bagëtit' e tia;

21 Po kushdo që s' i vuri vesh fjalës' së Zotit
la shërbëtorët' e ti e bagëtit' e tia ndëpër
fushat.
22 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ndej dorënë t' ënde
drejt qiellit, edhe dotë bjerë breshër mbi gji-
thë dhen' e Egjyptësë, mbi njerëzitë e mbi
bagëtitë, e mbi gjithë barin' e fushësë ndë
dhet t' Egjyptësë.
23 Edhe Moisiu ndejti stapin' e ti drejt qie-
llit; edhe Zoti dërgoj bubulima e breshër,
edhe zjarr shkonte andej e këtej mbi dhet;
edhe Zoti lëshonte breshër mbi dhet të Egjy-
24 ptësë. Kështu ishte breshër, e zjarr përzjerë
me breshër, *breshër* kaqë i-rëndë, sa i-atillë
s' pat rënë kurrë ndë gjithë dhet të Egjy-
25 ptësë që kur se ubë komp. Edhe breshëri i
ra çdo gjëje që ishte jashtë ndë tërë dhet
të Egjyptësë, që mbë njeri e gjer mbë bagëti;
edhe breshëri i ra gjithë barit të fushësë,
26 edhe theu gjithë drurët' e fushësë. Vetëmë
ndë dhët të Goshenit, ku ishinë të bijt' e Is-
railit, nukë ra breshër.
27 Atëhere Faraoni dërgoj e thirri Moisin' e
Aaroninë, e u tha atyre, Këtë herë fëjeva;
Zoti *qënëka* i-drejtë; po unë edhe gjindja ime
28 *qënkemi* të-liq. Lut-i-uni Zotit, që të pusho-
njënë bubullimat' e Perëndisë e breshëri; e-
dhe unë dot' u lë të shkoni, edhe nukë dotë
mbeti më.
29 Edhe Moisiu i tha ati, Posa të dal nga

qyteti, dotë ndenj duart' e mia te Zoti; bubullimatë dotë pushonjënë, edhe breshër nukë dotë ketë më; që të njohç, se dheu është' i
30 Zotit. Po sa për ty e për shërbëtorët' e tu, e di se edhe nukë dotë trëmbi nga Zoti, Perëndia.
31 Edhe liri e elbi uprishnë; sepse elbi ishte ndë kalli, edhe liri ndë lule; Po gruri edhe
32 grur' i-bardhë nuk' uvranë, sepse nuk' ishinë rriturë.
33 Edhe Moisiu nga Faraoni dolli jashtë qytetit, edhe ndejti duart' e ti te Zoti; edhe bubullimat' e breshëri pushuanë, edhe nukë
34 ra pikë shiu mbi dhet. Edhe Faraoni kur pa se pushuanë shiu e breshëri e bubullimatë, zuri përsëri të fëjente, edhe ashpëroj zëmë-
35 rën' e ti, ay edhe shërbëtorët' e ati. Edhe zëmëra e Faraonit uashpërua, edhe nukë la të bijt' e Israilit të shkoninë; sikundrë kishte folurë Zoti.

Krye 10.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Hyrë te Faraoni; sepse un' e ashpërova zëmërën' e atij, edhe zëmërën' e shërbëtorëvet t' ati, që të dëftenj
2 këto shënjat' e mia ndë mest t' atyre; Edhe që t' i tregonjç ndë veshët t' yt biri edhe të birit të t' yt biri sa bëra mbi Egjyptënë, edhe shënjat' e mia që bëra ndë mest t' atyreve; që të njihni, se unë jam Zoti.

3 Edhe Moisiu e Aaroni hyne te Faraoni,
e i thanë, Kështu thotë Zoti, Perëndia i E-
brenjvet, Gjer kur dotë mohonç të përunjesh
përpara meje? lërë gjindjenë t' ime të vejë
4 që të më lusnjënë. Ndryshe, ndë mos daç
të lësh gjindjenë t' ime të vejë, na nesërë
tek dotë bje karkaleca ndë sinorët të tu;
5 Edhe dotë mbulonjënë faqen' e dheut, kaqë
sa të mos muntnjë njeri të shohë dhenë;
edhe dotë hanë të-mbeturitë që shpëtoj, sa u
la breshëri, edhe dotë hanë gjithë drurëtë që
6 u apënë juve pemë *jashtë* ndëpër fushat; Edhe
dotë mbushenë shtëpitë t' uaj, edhe shtëpit'
e gjithë shërbëtorëvet të tu, edhe shtëpit' e
gjithë Egjyptianëvet, gjë që s' e kanë parë
as atërit' e tu, as atërit' e atërvet të tu, që
atë ditë që kanë qënë mbi dhet *e* gjer mbë
këtë ditë. Pastaj ukthye, edhe dolli nga Fa-
raoni.
7 Edhe shërbëtorët' e Faraonit i thanë ati,
Gjer kur dotë jetë ky njeri dhokan ndër ne?
Lër'-i njerëzitë të venë, që të lusnjënë Zotinë,
Perëndin' e tyre; edhe nukë di se uprish
Egjypta?
8 Atëhere prunë përsëri Moisinë edhe Aaro-
ninë te Faraoni; edhe *ky* u tha atyre, Shkoni,
e lusni Zonë, Perëndinë t' uaj; *po* cilët' edhe
9 cilëtë jan' ata që dotë venë? Edhe Moisiu tha,
Dotë vemi bashkë me djemtë t' anë e me
pleqtë t' anë, bashkë me bijtë t' anë e me bi-

jatë t' ona, bashkë me dhëntë t' ona e me qetë t' anë dotë vemi; sepse duhetë të kemi
10 një të-kremte për Zonë. Edhe ay u tha atyre, Kështu qoftë Zoti bashkë me ju, sikundrë unë dot' u lë të veni bashkë me djemtë t'uaj të-vegjëlë; shikoni; sepse të-keqe ka përpa-
11 ra jush. Jo kështu; *po* shkoni tashi ju burratë, edhe lutni Zonë; sepse këjo është' ajo që kërkoni. Edhe i nxuarnë që përpara Faraonit.
12 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ndej dorënë t' ënde mbi dhet të Egjyptësë, për karkalecatë, që të ngjitenë mbi dhet të Egjyptësë, edhe të hanë gjithë barin' e dheut, gjithë ç' la breshëri.
13 Edhe Moisiu ndejti stapin' e ti mbi dhet të Egjyptësë, edhe Zoti pruri mbi dhet gjith' atë ditë e gjith' atë natë erë djelli; edhe ndë
14 mëngjest era e djellit pruri karkalecatë. Edhe ungjitnë karkalecatë mbi gjithë dhen' e Egjyptësë, edhe ndënjnë mbi gjithë sinorët' e Egjyptësë; fort të-këqinj ishin' ata; më përpara s' kishte pasuarë të-këtillë karkaleca si ata, as pas atyre dotë ketë *kurrë* të-këtillë.
15 Sepse mbuluanë faqen' e gjithë dheut, kaqë sa uerrësua dheu; edhe hëngrrë gjithë barin' e dheut, edhe gjithë pemët' e drurëvet që pat lënë breshëri; edhe nukë mbeti asgjë e-njomë, as dru as bar ndë fushët, ndëpër gjithë dhen' e Egjyptësë.
16 Atëhere Faraoni dërgoj e thirri Moisinë

edhe Aaroninë me të-çpejtë, e tha, Fëjeva kundrë Zotit, Perëndisë t' uaj, edhe kundrë
17 jush. Tashi pra, u lutem, ndje-më-ni fajnë vetëmë këtë here, edhe lutuni Zotit, Perëndisë t' uaj, të ngrerë prej meje këtë vdekje vetëmë.
18 Edhe *Moisiu* dolli nga Faraoni, e i ulut
19 Zotit. Edhe Zoti pruri një erë perëndimi shumë të-fortë, e-cila ngriti karkalecatë, e i hodhi ndë Dett të-Kuq; nukë mbeti asnjë kar-
20 kalec mbi gjithë sinorët të Egjyptësë. Po Zoti ashpëroj zëmërën' e Faraonit, edhe nukë la të bijt' e Israilit të shkoninë.
21 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ndej dorënë t' ënde drejt qiellit, që të bënetë errësirë mbi gjithë dhen' e Egjydtësë, errësirë që ndihetë.
22 Edhe Moisiu ndejti dorën' e ti drejt qiellit, edhe ubë një errësir' e-dëndurë mbi gji-
23 thë dhen' e Egjyptësë tri dit. Edhe nukë shihninë njëri tjatrinë; as ungrit njeri nga vëndi i ti tri dit; po të-gjithë të bijt' e Israilit kishinë dritë ndëpër vëndet të tyre.
24 Atëhere Faraoni thirri Moisinë, e tha, Shkoni, *e* lutni Zotinë; vetëmë dhëntë t' uaj e qetë t' uaj letë mbetenë; edhe djemtë t' uaj
25 të-vegjëlë letë vinjënë bashkë me ju. Edhe Moisiu tha, Po ti ka hije të na apç ndë duart t' ona edhe kurbanë, e *kurbanë* të-gjithëdjegurë, që t' j'a bëjmë kurban Zotit Pe-
26 rëndisë t' ënë. Po edhe bagëtitë t' ona dotë

vinjënë bashkë me ne; nukë dotë mbetetë prapa asnjë thundrë; sepse duhetë të marrëmë nga këto, që të lusëmë Zotinë, Perëndinë t' ënë; edhe neve nukë dimë me se duhetë të lusëmë Zotinë, gjersa të arrijmë atje.

27 Po Zoti e ashpëroj zëmërën' e Faraonit, edhe nukë desh t' i linte ata të shkoninë.
28 Edhe Faraoni i tha ati, Ikë prej meje; ki mënttë ndë vetëhet t' ënde, të mos më shohç më sytë; sepse atë ditë që të më shohç sytë dotë vdesç. Edhe Moisiu tha, Mirë the, s' kam për të parë më syt' e tu.

Krye 11.

1 Edhe Zoti i dha Moisiut, Edhe një plagë dotë bje mbi Faraonë edhe mbi Egjyptënë; pastaj dot' u lërë të shkoni së këtejmi; kur t'u lërë *juve* të shkoni, me të-vërtetë u ka
2 për të dëbuarë fare së këtejmi. Tashi fol'-i gjindjesë ndë veshët, edhe letë kërkonjë çdo burrë nga fëqinja e ti, edhe çdo grua nga fëqinja e saj, gjërëra t' ergjëntta, edhe gjërëra të-arta.
3 Edhe Zoti i dha gjindjesë hir përpara Egjyptianëvet. Po edhe *ky* njeri, Moisiu, ishte fort i-math ndë dhet të Egjyptësë, përpara shërbëtorëvet të Faraonit, e përpara gjindjesë.
4 Edhe Moisiu tha, Kështu thotë Zoti, Si nga mezi i natësë unë dotë dal ndë mest të E-
5 gjyptësë; Edhe çdo i-parëlindurë ndë dhet të

Egjyptësë dotë vdesë, që nga i-parëlinduri i Faraonit, që rri mbi frontt të ti, e gjer mbë të-parëlindurin' e shërbëtoresë që rri prapa mullirit, edhe gjer mbë çdo të-pjelë të-parë
6 të bagëtivet. Edhe ndëpër gjithë dhen' e Egjyptësë dotë jetë një klithmë e-madhe, që e-këtillë nuk' është bërë kurrë ndonjë herë,
7 as është për të bërë paskëtaj. Po kundrë ndonjëj nga të bijt' e Israilit asnjë qën s' ka për të luajturë gjuhën' e ti, që nga njeriu e gjer mbë bagëtinë; që të njihni, se Zoti bëri të-çquarë ndër mest të Egjyptianëvet e të I-
8 srailit. Edhe gjithë këta shërbëtorët' e tu dotë sbresënë tek unë, edhe dotë më bjenë ndër këmbë, dyke thënë, Dil ti, edhe gjithë gjindja që vjen pas teje; edhe pastaj dotë dal. Edhe dolli nga Faraoni me zëmërim të-math.
9 Edhe Zoti i tha Moisiut, Nukë dot' u dëgjonjë juve Faraoni; që të shumonenë çudit' e mia ndë dhet të Egjyptësë.
10 Edhe Moisiu edhe Aaroni bënë gjithë këto çudi përpara Faraonit. Po Zoti ashpëroj zëmërën' e Faraonit, edhe nukë la të dilninë të bijt' e Israilit nga dheu i ti.

Krye 12.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut edhe Aaronit ndë
2 dhet të Egjyptësë, dyke thënë, Ky muaj dotë jetë ndër ju krye muajsh; dotë jetë ndër ju
3 i-pari i muajvet të vitit. Flitni-i gjithë mble-

dhjes' së Israilit, dyke thënë, Të-dhjettën' e
këti muaji gjithë-si-cili letë marrë për vetë-
hen' e ti një qënq, pas shtëpivet t' atërvet,
4 një qënq për çdo shtëpi. Po ndë qofshinë të-
pakë ndë shtëpit për një qënq, atëhere ay
edhe fëqinja e ati, i-cili është më i-afërmi
ndë shtëpit t' ati, let'a marrënë pas numë-
rit të njerësvet; pas të-ngrënit të çdo njeriu
5 dotë bëni llogaritë t' uaj për qëngjinë. Qën-
gji juaj të jetë pa të-metë, mashkull motak;
6 dot'a merrmi nga dhënt' a nga dhitë; Edhe
dot'a ruani gjer mbë të-katrë-mbë-dhjettënë
ditë të gjithati muaji; edhe *atëhere* gjithë shu-
mica e mbledhjes' së Israilit t'a thernjë ndaj
7 mbrëma. Edhe të marrënë nga gjaku, e t'a
vënë mbi të dy shtyllat' e derësë, e mbi pra-
gun' e-sipërm të derës' së shtëpivet, atje ku
8 kanë për të ngrën' atë. Edhe atë natë të ha-
në mishinë, të-pjekurë ndë zjarr, edhe bukë
9 pa brumë; me barëra të-hidhura t'a hanë atë.
Të mos e hani të-papjekurë, as të-zjerë nd' ujë,
po të-pjekurë ndë zjarr: kryet' e ati me këm-
10 bët' e ati e me të-përbrëndëshmet' e ati. Edhe
të mos lini asgjë prej ati të mbetetë gjer ndë
mëngjest; po ç' të mbetetë prej ati gjer ndë
11 mëngjest digj-e-ni ndë zjarr. Edhe kështu
dot'a hani atë; me mezatë t'uaj të-ngjeshurë,
me këpucëtë t' uaj ndër këmbët t' uaj, edhe
me stapinë t' uaj ndë dorët t' uaj; edhe t'a
hani atë me nxitim; është pashka*) e Zotit.

*) Të-shkuarët' e Zotit.

12 Sepse këtë natë dotë shkonj ndëpër dhen' e Egjyptësë; edhe dotë vras çdo të-parëlindurë ndë dhet të Egjyptësë, që nga njeriu e gjer mbë bagëtinë; edhe dotë bënj gjyqe kundrë gjithë perëndivet të Egjyptësë. Unë jam Zoti.
13 Edhe gjaku dotë jetë ndër ju për shënjë mbë shtëpirat ku rrini; edhe kur të shoh gjakunë, dot' u kapërxenj juve, edhe plagë nukë dotë ketë mbi ju që t' u shuanjë *juve*, kur t'i bje dheut të Egjyptësë.
14 Edhe ajo ditë dotë jetë ndër ju për kujtim; edhe dot'a kremtëroni atë për të-kremte mbë Zotinë; ndë brezat t' uaj pas një nomi
15 të-përhershim dot'a kremtëroni atë. Shtatë dit keni për të ngrënë bukë pa brumë; që ditën' e-parë kini për të hequrë bruminë nga shtëpitë t' uaj; sepse kush të hajë bukë tëmbrumë që nga e-para e gjer mbë të-shtattënë ditë, ay shpirt dotë vdiretë nga Israili.
16 Edhe të-parënë ditë dotë jetë mbledhje eshënjtëruarë; edhe të-shtattënë ditë dotë jetë ndër ju mbledhje e-shënjtëruarë; ndër ato *dit* nukë dotë bënet' asndonjë punë, përveç ç' i duhetë çdo njeriu për të ngrënë, vetëmë
17 këtë keni për të bërë. Edhe dot'a ruani *të-kremten'* e pabrumjevet; sepse atë ditë nxora ushtëritë t' uaj nga dheu i Egjyptësë. Përandaj pas një nomi të-përhershim keni për të ruajturë këtë ditë ndër brezat t' uaj.
18 Të-parinë *muaj*, të-katrë-mbë-dhjettënë

ditë të muajt mbrëmanet, dotë hani bukë pa
brumë, e gjer mbë të-njëzet-e-njëjtënë ditë të-
19 muajt mbrëmanet. Shtatë dit të mos gjëndetë
brumë ndër shtëpirat t' uaj; sepse kushdo që
të hajë *gjë* të-mbrumurë, ay shpirt dotë vdi-
retë nga mbledhja e Israilit, ndo i-huaj qoftë,
20 ndo vëndës. Nukë dotë hani asgjë të-mbru-
murë; ndë gjithë vëndet t' uaj dotë hani bu-
kë pa brumë.
21 Atëhere Moisiu dërgoj e thirri gjithë ple-
qësin' e Israilit, e u tha atyre, Sgjithni, e merr-
ni për vetëhenë t' uaj *nga një* qënq, pas fë-
mijëvet t' uaj, edhe · bëni kurban pashkënë.
22 Pastaj të merrni një dorëzë hyssopi, e t'a
ngjyeni ndë gjakt që dotë jetë ndë legen, edhe
nga gjaku që është ndë legen të lyeni pra-
gun' e-sipërm edhe të dy shtyllat' *e dyervet;*
edhe asndonjë prej jush të mos dalë nga
23 dera e shtëpis' së ti gjer ndë mëngjest. Sepse
Zoti dotë shkonjë që t' u bjerë Egjyptianë-
vet; edhe kur të shohë gjakunë mbi prakt
të-sipërm, edhe mbi të dy shtyllat, Zoti dot'a
kapërxenjë derënë, edhe nukë dotë lërë pri-
shësinë të hynjë ndër shtëpit t'uaj që t'u vrasë.
24 Edhe t'a ruani këtë gjë posi nom për ve-
tëhenë t' ënde edhe për bijt' e tu, gjer ndë je-
25 tët të jetësë. Edhe kur të hyni nd' atë dhe
që dot' u apë juve Zoti, sikundrë është zo-
26 tuarë, dot'a ruani këtë lutje. Edhe kur t' u
thonë juve bijtë t' uaj, Ç' është kjo lutje ndër

27 ju? Të thoni, Ky është kurbani i pashkës' së Zotit, sepse kapërxeu shtëpit' e të bijvet të Israilit ndë Egjyptë, kur u ra Egjyptianëvet, edhe shpëtoj shtëpitë t' ona.

28 Atëhere gjindja unji kryetë, e ufal. Edhe të bijt' e Israilit si iknë, bënë kështu; sikundrë Zoti kishte urdhëruarë Moisin' e Aaroninë, kështu bënë.

29 Edhe ndë mest të natësë, Zoti vrau gjithë të-parëlindurìtë ndë dhet të Egjyptësë, që nga i-parëlinduri i Faraonit që rrinte mbi front të ti e gjer mbë të-parëlindurin' e skllavit, që ishte ndë burkt; edhe gjithë të-pjellat' e-para të bagëtivet.

30 Edhe Faraoni ungrit natënë, edhe gjithë shërbëtorët' e ati, edhe gjith' Egjyptianëtë; edhe ubë klithm' e-madhe ndë Egjyptë; sepse nukë kishte stëpi që të mos kishte një
31 të-vdekurë. Edhe *Faraoni* dërgoj e thirri Moisinë edhe Aaroninë natënë, e tha, Ngrihi, e dilni nga mezi i gjindjesë s' ime, edhe ju edhe të bijt' e Israilit; edhe shkoni, lutni Zotinë,
32 sikundrë thatë. Merrni edhe dhëntë t'uaj edhe lopëtë t' uaj, sikundrë thatë, edhe shkoni; po bekoni edhe mua.

33 Edhe Egjyptianëtë shtrënguanë gjindjenë, që t' i nxirninë ata nga vëndi me të-çpejtë;
34 sepse thanë, Neve të-gjithë po vdesëmë. Edhe gjindja ngriti brumin' e saj të-paardhurë, dy

ke pasurë sicili magjen' e ti mbi krahët të ti, të-pshtjellë ndë rrobat të tia.

35 Edhe të bijt' e Israilit bënë sipas fjalës' së Moisiut; edhe kërkuanë gjërëra te-ërgjënt-
36 ta, e gjërëra t' arta, e rroba. Edhe Zoti i dha hir gjindjesë përpara Egjyptianëvet, edhe u dhanë atyre çdo që deshnë. Edhe sveshnë Egjyptianëtë.

37 Edhe të bijt' e Israilit ungritnë nga Ramesesa e vanë ndë Sukkoth, sindonja gjashtë
38 qint mijë burra këmbësorë, veç djemvet. Bashkë me ata ungjit edhe një shumicë e-madhe *njerëzish* e-përzjerë, edhe dhën e lopë, po, fort
39 shumë bagëti. Edhe nga brumi i-paardhurë që prunë nga Egjypta poqnë kuleç pa brumë; sepse nukë kishinë brumë, sepse udëbuanë nga Egjypta, edhe nukë muntninë të mënoninë, as kishinë bërë gati ndonjë tëngrënë për vetëhen' e tyre.

40 Edhe *koha* e të-ndënjurit të të bijvet të Israilit që ndënjnë ndë Egjyptë ishte katrë
41 qint e tri-dhjetë vjet. Edhe ndë funtt të katrë qint e tri-dhjetë vjetvet, gjithatë ditë, duallnë gjithë ushtërit' e Zotit nga dheu i Egjyptësë.

42 Këjo është nata që duhetë të ruhetë për Zotinë, sepse i nxori ata nga dheu i Egjyptësë; këjo është ajo nata e Zotit që duhetë të ruhetë nga gjithë të bijt' e Israilit ndë brezat t' atyreve.

43 Edhe Zoti i tha Moisiut edhe Aaronit, Ky

është nomi i pashkësë; asndonjë komp i-huaj
44 të mos hajë nga ajo; Po shërbëtori i çdo
njeriu që është blerë me ergjënt, passi të
45 rrethpritetë, atëherë të hajë nga ajo. I-huaji
46 edhe i-pajtuari të mos hajë nga ajo. Ndë
gjithatë shtëpi të hajetë; të mos bjesh nga
mishi jashtë shtëpisë; as dotë thyeni *ndonjë*
47 është nga ajo. Gjithë mbledhja e Israilit do-
48 t'a mbanjë. Edhe ndonjë i-huaj, që rri bash-
kë me ty, ndë dashtë t'a mbanjë pashkënë
mbë Zotinë, letë rrethpritenë gjithë meshkujt'
e ati, edhe atëhere letë afëronetë e t'a mba-
një këtë; edhe dotë jetë posi ay që ka lin-
durë ndë dhet *t' uaj;* po asndonjë i-parreth-
49 prerë s' ka për të ngrënë nga ajo. Gjithay
nom dotë jetë për vëndësinë, edhe për të-
huajnë që rri ndër mest t' uaj.

50 Kështu bënë gjithë të bijt' e Israilit; si-
kundrë Zoti urdhëroj Moisinë edhe Aaroninë,
kështu bënë.

51 Edhe mbë gjithatë ditë Zoti nxori të bijt'
e Israilit nga dheu i Egjyptësë, pas ushtëri-
vet t' atyre.

Krye 13.

1 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
2 Shënjtëro për mua*) çdo të-parëlindurë, që
hap çdo shtrat *barku* ndër mest të bijvet të

*) a: I'al-më.

Israilit, që nga njeriu e gjer ndë bagëtit; ky është imi.

3 Edhe Moisiu i tha gjindjesë, Ki-e-ni ndër mëntt këtë ditë, ndë të-cilët dualltë nga Egjypta, nga shtëpia e robërisë; sepse me dorë të-fortë Zoti u nxori s' andejmi; asndonjë
4 nukë dotë hajë bukë të-mbrumë. Sot delni, ndë muajt të Abibit.

5 Zoti pra kur të të shpjerë ty ndë dhet të Hanaanitëvet, e të Hittitëvet, e të Amoritëvet, e të Hivitëvet, e të Jebusitëvet, për tëcilinë u bëri be atërvet të tu se dotë t'a apë ty, dhe që rrjeth qumësht e mjaltë, atëhere
6 dotë bënjç këtë lutje mbë këtë muaj. Shtatë dit ke për të ngrënë bukë pa brumë, edhe tështattënë ditë dotë jetë e-kremte mbë Zotinë.
7 Bukë pa brumë dotë hahetë shtatë dit; edhe nukë dotë duketë përanë teje bukë me brumë, as është për të dukurë përanë teje bru-
8 më, ndë gjithë sinorët të tu. Edhe atë ditë dot' i rrëfenjç t' yt bir, e t' i thuash, *Këjo bënetë* për atë që më bëri Zoti, kur dolla nga
9 Egjypta. Edhe *këjo* dotë jetë mbë ty për shënjë mbi dorënë t' ënde, edhë për kujtim ndër mest të syvet të tu, që të jetë nomi i Zotit ndë gojët t' ënde; sepse me dorë të-fortë Zoti
10 të nxori nga Egjypta. Dot'a ruanjç pra këtë nom ndë kohët t' ati për vit.

11 Edhe Zoti kur të të sjellë ty ndë dhet të Hanaanitëvet, sikundrë upërbetua mbë ty edhe

12 mbë atërit' e tu, edhe të t'a apë, Atëhere
dotë ndanjç veç për Zotinë çdo që hap shtra-
tinë *e barkut*, edhe çdo të-pjellë të-parë të
shtëzëvet *të tua* sa ke; meshkujtë dotë jenë
13 të Zotit. Edhe çdo pulisht të-parë gomareje
dot' e çpërblenjç me qënq; edhe ndë mos e
çpërblefsh, atëhere dot' i presç qafënë; edhe
çdo të-parëlindurë ndër mest të bijvet të tu
dot' e çpërblenjç.
14 Edhe ndë kohët të pritme kur të të py-
esë ty yt bir, dyke thënë, Ç' është këjo? t' i
thuash ati, Me dorë të-fortë Zoti na nxori
15 nga Egjypta, nga shtëpia e robërisë; Edhe
Faraoni kur qëndronte që të mos lij të shko-
nimë, Zoti vrau gjithë të-parëlinduritë ndë
dhet të Egjyptësë, që nga i-parëlinduri i
njeriut e gjer mbë të-parëlindurin' e bagë-
tisë; përandaj i bënj kurban Zotit çdo mash-
kull që hap shtratinë, edhe çpërblenj çdo të-
16 parëlindurë nga bijt' e mi. Edhe këjo dotë
jetë për shënjë mbi dorënë t' ënde, edhe për
balicë ndë mest të syvet të tu; sepse me
dorë të-fortë na nxori Zoti nga Egjypta.
17 Edhe kur la Faraoni gjindjenë të shko-
një, Perëndia nuk' u hoqi atyrë udhënë ndë-
për dhet të Filistinjvet, ndonëse ishte më e-
shkurtërë; sepse Perëndia tha, Se mos pen-
donetë gjindja, kur të shohë luftë, e kthenetë
18 ndë Egjyptë. Po Perëndia e pru rrotullë gjin-
djenë ndëpër udhët të shkretëtirësë, përanë

Detit të-Kuq. Edhe të bijt' e Israilit hipnë nga Egjypta të-armatosurë.

19 Edhe Moisiu mori eshtërat' e Josifit me vetëhen' e ti; sepse i kishte përbetuarë me be të bijt' e Israilit, dyke thënë, Perëndia me tëvërtetë dot' u vështronjë juve, edhe të merrni së këtejmi eshtërat' e-mia me vetëhenë t' uaj.

20 Edhe si ungritnë nga Sukkothi, ngulnë ushtërinë ndë Etham, ndë buzët të shkretë-

21 tirësë. Edhe Zoti printe përpara atyreve ditënë ndë shtyllë reje, që t'u hiqte udhënë; edhe natënë, ndë shtyllë zjarri, që t'u ndritte

22 atyre; që të ecëninë dit' e natë. Shtyll' e resë ditënë, edhe shtyll' e zjarrit natënë, nukë hiqeshinë që përpara gjindjesë.

Krye 14.

1 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë, Thuaj-u të bijvet të Israilit të kthenenë, e të ngulën' ushtërinë përpara Pi-hahirothit, ndë mest të Migdhollit edhe të detit, kundruell Baall-zefonit; kundruell këti vëndi dotë ngul-

3 ni ushtërinë afërë detit. Edhe Faraoni dotë thotë për të bijt' e Israilit, Ata e humpnë udhënë ndë dhet; shkretëtira i ka mbyllurë

4 brënda. Edhe unë dot' e ashpëronj zëmërën' e Faraonit, edhe dot' i ndjekë prapa ata; edhe dotë lavduronem mbi Faraonë, edhe mbi gjithë ushtërin' e ati; edhe Egjyptianëtë dotë njohënë, se unë jam Zoti. Edhe bënë kështu.

5 Edhe i dhanë zë mbretit të Egjyptësë se
iku gjindja. Edhe zëmëra e Faraonit edhe e
shërbëtorëvet t' ati undërrua për gjindjenë, e
thanë, Ç' është këjo që bëmë, e lamë Israi-
linë të shkonjë, e të mos na shërbenjënë më?
6 Bëri pra gati qerren' e ti, edhe mori gjindjen'
7 e ti bashkë me vetëhen' e ti; Edhe mori gjash-
të qint qerre të-sgjedhura, edhe gjithë qerret'
8 e Egjyptësë, edhe krerë mbi gjit' ato. Edhe
Zoti e ashpëroj zëmërën' e Faraonit, mbretit
të Egjyptësë, edhe ndoqi prapa të bijt' e I-
srailit; edhe të bijt' e Israilit po dilninë me
9 anë dore së-lartë. Edhe ndoqnë prapa ata
Egjyptianëtë, gjithë kuajtë *e* qerret' e Farao-
nit, e kalëria e ati, e ushtëria e ati; edhe i
arrinë ata atje tek kishinë ngulurë ushtërinë
afërë detit, përpara Pi-hahirothit, kundruell
Baall-zefonit.

10 Edhe kur uafërua Faraoni, të bijt' e Isra-
ilit ngritnë syt' e tyre, edhe na Egjyptianëtë
tek po vininë prapa atyreve; edhe ufrikësu-
anë fort; edhe të bijt' e Israilit klithnë mbë
11 Zonë. Edhe i thanë Moisiut, Sepse nukë
kishte varre ndë Egjyptë, *përandaj* na nxore,
që të vdesëmë ndë shkretëtirët? përse na
12 bëre këtë punë e na nxore nga Egjypta? A
nuk' është këjo fjala që të folmë ndë Egjy-
ptë, dyke thënë, Lërë-na, e let' u shërbejmë
Egjyptianëvet? Sepse më mirë ishte për ne

t'u shërbenimë Egjyptianëvet se të vdesëmë ndë shkretëtirët.

13 Edhe Moisiu i tha gjindjesë, Mos frikësohi; qëndroni, edhe shihni shpëtimn'e Zotit, që dotë bënjë për juve sot; sepse *ata* Egjyptianëtë që patë sot, nukë dot'i shihni më
14 prapë për gjithë jetënë. Zoti dotë luftonjë për ju, edhe ju dotë prëhi.

15 Edhe Zoti i tha Moisiut, Përse thërret mbë mua? thuaj-u të bijvet të Israilit të ni-
16 senë. Edhe ti ngri përpjetë stapnë t'ënt, edhe ndej dorënë t'ënde mbi dett, edhe çaj-e atë, edhe të bijt'e Israilit dotë shkonjënë ndëpër
17 mest të detit mbë të-thatë. Edhe na unë tek dot'u ashpëronj Egjyptianëvet zëmërënë, edhe dotë hynjënë prapa atyreve; edhe dotë lavduronem mbi Faraonë, e mbi gjithë ushtërin'e ati, mbi qerret'e ati, e mbi kalërin'e ati.
18 Edhe dotë njohën'Egjyptianëtë, se unë jam Zoti, kur të lavduronem mbi Faraonë, mbi qerret'e ati, e mbi kalërin'e ati.

19 Atëhere ëngjëlli i Zotit, i-cili ecënte përpara ushtëris'së Israilit, ungrit, e erdhi prapa atyreve; edhe shtylla e resë ungrit që përpara atyreve, edhe qëndroj prapa atyreve;
20 Edhe erdhi ndër mest të ushtëris's'Egjyptianëvet e të ushtëris'së Israilit; edhe *ndër ata* ishte re e errësirë, po *ndër këta* dritë natënë; edhe njëra nuk'i uafërua tjatërësë gjithë natënë.

21 Edhe Moisiu ndejti dorën' e ti mbi dett;
edhe Zoti bëri detinë të hiqetë gjith' *atë* na-
të prej një ere djelli së-fortë, edhe bëri deti-
22 në *tokë* të-thatë, edhe ujërat' undanë. Edhe
të bijt' e Israilit hynë ndë mest të detit ndë-
për të-thatë, edhe ujëratë ubënë ndër ata
mur mbë të-djathtë t' atyre e mbë të-mën-
gjërë t' atyre.
23 Edhe Egjyptianëtë ndoqnë, edhe hynë pra-
pa atyreve ndë mest të detit, gjithë kuajt' e
Faraonit, *e* qerret' e ati, e kalëria e ati.
24 Edhe ndë ruajtjet të mëngjezit, Zoti shtiu
sytë nga shtylla e zjarrit edhe të resë mbi
ushtërin' e Egjyptianëvet, edhe trubulloj u-
25 shtërin' e Egjyptianëvet. Edhe nxori vëndit
rrotovilet' e qerrevet t' atyre, kaqë sa i hiq-
ninë me të-vështirë. Atëhere Egjyptianëtë tha-
në, Let' ikëjmë nga syt' e Israilit, sepse Zoti
po lufton për ata kundrë Egjyptianëvet.
26 Edhe Zoti i tha Moisiut, Ndej dorënë t'
ënde mbi dett, që të kthenenë ujëratë mbi
Egjyptianët, mbi qerret t' atyre, e mbi kalërit
27 t' atyre. Edhe Moisiu ndejti dorën' e ti mbi
dett, edhe deti mori fërtomën' e ti ndaj të-
sbardhëllyerët të mëngjezit; edhe Egjyptianëtë
dyke ikurë e gjetnë atë përpara; edhe Zoti
28 prishi Egjyptianëtë ndë mest të detit. Sepse
ujërat' ukthyenë prapë, edhe mbuluanë qerre-
të, e kalërinë, gjithë ushtërin' e Faraonit, që
kishte hyrë ndë dett prapa atyreve; nukë

29 mbeti asnjë nga ata. Po të bijt' e Israilit
shkuanë ndëpër të-thatë ndë mest të detit;
edhe ujëratë ubënë ndër ata mur mbë të-
djathtë t' atyre e mbë të-mëngjërë t' atyre.
30 Kështu Zoti atë ditë shpëtoj Israilinë nga
dor' e Egjyptianëvet, edhe Israili pa Egjypti-
31 anëtë ndë buzët të detit. Edhe Israili pa atë
punë të-madhe, që bëri Zoti mbi Egjyptia-
nët; edhe gjindja i pat frikë Zotit, edhe i
besoj Zotit, edhe Moisiut, shërbëtorit t' ati.

Krye 15.

1 Atëhere Moisiu edhe të bijt' e Israilit i
kënduanë Zotit këtë kënkë, edhe këndu-
anë, dyke thënë,
Dot' i këndonj Zotit, sepse ulavdurua me
lavdurim;
Hodhi ndë dett kalin' edhe kalorësin' e ati.
2 Zoti është fuqia ime edhe kënka *ime*,
Edhe *ay* ubë shpëtimi im;
Ay është Perëndia im, edhe dot'a lavduronj;
Perëndia i t' im et, edhe dot'a lartonj.
3 Zoti është luftëtar i-fortë;
Emëri i ati është Zot.
4 Hodhi ndë dett qerret' e Faraonit edhe u-
shtërin' e ati;
Edhe të-sgjedhuritë krye-luftëtarë t' ati
umbytnë ndë Dett të Kuq.
5 Thellësirat' i mbuluan' ata;
Posi gur ukrethnë ndë të-thellat.

6 E-djathta jote, o Zot, ulavdurua për fuqinë,
E-djathta jote, o Zot, dërrmoj armikunë.
7 Edhe më të-matht' e madhërisë s' ate shuan
ata që ngrihenë kundrë teje;
Dërgon zëmërimnë t' ënt, edhe i fërkat
posi kallam.
8 Edhe me frymën' e hundësë s' ate ujërat
umblothnë tok,
Valëtë qëndruanë posi tok,
Pafundjetë ubënë akull ndë zëmërët të detit.
9 Armiku tha, Dot' i ndjek, dot' i arrinj,
Dotë ndanj plaçkatë;
Dëshira ime dotë nginjetë mbi ata,
Dotë heq kordhënë t' ime;
Dora ime i ka për të shuar' ata.
10 Fryjte me erënë t' ënde, *edhe* deti mbu-
loj ata;
Ukrethnë posi plump ndë ujëra të-frikshime.
11 Kush është, posi ti, o Zot, ndë mest të
perëndivet?
Kush është posi ti, i-lavduruarë ndë
shënjtëri,
I-frikshim ndë lavdurime, posi ti që bën
çudira?
12 Ndejtë të-djathtënë t' ënde,
Edhe dheu i përpiu ata.
13 Me përdëllimnë t' ënt i hoqe udhënë gjin-
djesë që çpërbleve;
U hoqe atyre udhënë me fuqinë t' ënde
për ndë vëntt t' ënt të-shënjtëruarë.

14 Gjindjetë dëgjuanë, *e* trëmbenë;
Dhëmbje i pushtuanë vëndësit' e Palestinësë.
15 Atëhere uhabitnë të-parët' e Edhomit;
Frika i merr të-parët e Moabit;
Gjithë vëndësit' e Hanaanit tretenë.
16 Frikë e të-dridhurë bje mbi ata;
Nga të-matht' e krahut t' ënt ngurosenë,
Gjersa të shkonjë gjindja jote, o Zot,
Gjersa të shkonjë gjindja që fitove.
17 Dot' i këllaç ata, e dot i mbeltonjç ata ndë malt të trashëgimit t' ënt,
Ndë vëntt, o Zot, që bëre gati për të-ndënjuritë t' ënt,
Ndë shënjtëroret, o Zot, *që* ngrehnë duart' e tua.
18 Zoti dotë mbretëronjë ndë jetët të jetëvet.
19 Sepse kuajt' e Faraonit hynë ndë dett bashkë me qerret' e ati e me kalorësit' e ati, edhe Zoti ktheu ujërat' e detit mbi ata; po të bijt' e Israilit shkuanë ndëpër të-thatë ndë mest të detit.
20 Edhe profitëresha Mariamë, e motëra e Aaronit, mori një tymbanë ndë dorët të saj, edhe gjithë gratë duallnë prapa asaj me tymbana
21 e me valle. Edhe Mariama u përgjigjej atyre,
Këndoni Zotit, sepse ulavdurua me lavdurim;
Hodhi ndë dett kalin' edhe kalorësin' e ati.
22 Atëhere Moisiu ngriti Isralitëtë nga Deti

i-Kuq, edhe duallnë ndë shkretëtirët të Shurit;
edhe ecnë tri dit ndë shkretëtirët; edhe nukë
23 gjetnë ujë. Edhe kur erdhë ndë Merahë, s'
muntninë të pininë nga ujërat' e Merahësë,
sepse ishinë të-hidhura; përandaj uquajt Me-
24 rahë*). Edhe gjindja murmuriste kundrë Mo-
25 isiut, dyke thënë, Ç' të pimë? Edhe *Moisiu*
thërriti mbë Zotinë; edhe Zoti i dëfteu ati
një dru, *te-cilinë* kur e hodhi ndë ujërat, u-
jërat' uëmbëlsuanë. Atje u dha atyre porosi e
26 urdhër, edhe atje i provoj ata; Edhe tha,
Ndë e dëgjofsh me kujdes zën' e Zotit, Pe-
rëndisë t' ënt, edhe ndë bëfsh atë që është
e-drejtë ndë syt t' ati, edhe ndë u vënç vesh-
në porosivet t' ati, edhe ndë ruajç gjith' ur-
dhërimet' e ati, nukë dotë bje mbi ty asnjë
nga sëmundjetë që prura mbi Egjyptianët;
sepse unë jam Zoti që të shëronj ty.
27 Pastaj erdhe ndë Elim, ku ishinë dy-
mbë-dhjetë burime ujërash edhe shatë-dhjetë
drurë hurmash; edhe ngulnë ushtërinë atje
afër' ujëravet.

Krye 16.

1 Edhe ungritnë nga Elimi, edhë gjithë mble-
dhja e të bijvet të Israilit erdhë ndë shkre-
tëtirët të Sinit, që është ndë mest t'Elimit e të
Sinajt, të-pesë-mbë-dhjettënë ditë të muajt
të-dytë pas të-dalit të tyre nga dheu i Egjy-

*) Hidhërim.

2 ptësë. Edhe gjithë mbledhja e të bijvet të
Israilit murmurisnë ndë shkretëtirët kundrë
3 Moisiut e Aaronit. Edhe të bijt' e Israilit u
thanë atyre, Makar të kishimë vdekurë prej
dorës' së Zotit ndë dhet të Egjyptësë, kur
rrinimë përanë kusivet të mishit, *edhe* hani-
më bukë e nginjeshimë; sepse na nxuartë ndë
këtë shkretëtirë, që të vritni me uri gjithë
këtë mbledhje.
4 Atëhere Zoti i tha Moisiut, Na tek dotë
bënj për ju të bjerë shi buke nga qielli; edhe
gjindja dotë dalë, e çdo ditë dotë mblethnjë
aqë sa i arrin për një ditë, që t' i provonj
ata, ndë dotë ecënjënë ndë nomt t' im, apo
5 jo. Edhe të-gjashttënë ditë letë bënjënë gati
atë që kanë për të mbledhurë, edhe letë jetë
dy herë kaqë sa ajo që mblethnjënë përdita.
6 Edhe Moisiu e Aaroni u thanë të bijvet
të Israilit, Prëmë dotë njihni, se Zoti u nxori
7 juve nga dheu i Egjyptësë; Edhe *nesërë* ndë
mëngjest dotë shihni lavdin' e Zotit; sepse
dëgjoj murmurimetë t' uaj kundrë Zotit; sepse
neve ç' jemi, që të murmurisni kundrë nesh?
8 Edhe Moisiu tha, *Këjo dotë bënetë*, kur t' u
apë juve Zoti prëmë mish të hani, edhe ndë
mëngjest bukë me të-plotë; sepse Zoti dë-
gjoj murmurimetë t' uaj që murmuristë kundrë
ati; e ç' jemi neve? murmurimetë t' uaj nukë
janë kundrë nesh, po kundrë Zotit.
9 Edhe Moisiu i tha Aaronit, Thuaj gjithë

mbledhjes' së të bijvet të Israilit, Afërohi përpara Zotit; sepse dëgjoj murmurimetë t' uaj.
10 Edhe kur po i fliste Aaroni gjithë mbledhjes' së të bijvet të Israilit, hodhë sytë nga shkretëtira, edhe na lavdia e Zotit tek uduk ndë ret.
11 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
12 Dëgjova murmurimet' e të bijvet të Israilit; fol'-u atyre, edhe thuaj, Prëmë dotë hani mish, e ndë mëngjest dotë nginji me bukë; edhe dotë njihni se unë jam Zoti, Perëndia juaj.
13 Edhe mbrëmanet erdhe shkurtëza, edhe mbuluan' ushtërinë; edhe ndë mëngjest kishte
14 rënë vesë rreth e rrotullë ushtërisë. Edhe kur ungrit vesa që kishte rënë, na mbi faqet të shkretëtirësë tek ishte një gjë e-hollë *e* rrumbullake, e hollë posi bryma mbi dhet.
15 Edhe kur panë të bijt' e Israilit i thanë njëri jatrit, Ç' është këjo? sepse ata nukë dininë se ç' është. Edhe Moisiu u tha atyre, Këjo është buka që u ep juve Zoti të hani;
16 Këjo është ajo që urdhëroj Zoti, Mblithni gjithë-si-cili nga ajo sa i duhetë për të ngrënë; nga një omer për krye, sipas numërit të njerësvet t' uaj, dotë merrni nga ajo, gjithë-si-cili për ata që janë ndë tendët të ti.
17 Edhe të bijt' e Israilit bënë kështu, edhe mblothnë kush më shumë e kush më pak.
18 Edhe kur e matnë me omerinë, ay që kishte mbledhurë shumë, nukë merrte më tepërë, edhe ay që kishte mbledhurë pak, nukë merr-

te më pak; gjithë-si-cili merrte sa i duhej për
të ngrënë.
19 Edhe Moisiu u tha atyre, Asnjeri të mos
lërë të mbetetë nga ajo gjer ndë mëngjest.
20 Po nuk' i dëgjuanë Moisiut; po ca *veta* nga
ata lanë të mbetetë gjer ndë mëngjest, edhe
zuri krymba, e uqelp; edhe Moisiu uzëmërua
kundrë atyre.
21 Edhe e mblithnin' atë mëngjes për mën-
gjes, gjithë-si-cili sa i duhej për të-ngrënët'
e ti; edhe kur nxehej djelli, çkrinte.
22 Edhe të-gjashttënë ditë mblothnë të-ngrë-
në dy herë aqë, dy omerë për çdo njeri;
edhe erthnë gjithë të-parët' e mbledhjesë,
23 edhe i dhanë zë Moisiut *për këtë*. Edhe ay
u tha atyre, Këjo ësht' ajo që tha Zoti, Ne-
sër' është të-prëjturë të-shënuerë, sabbatë e-
shënjtëruarë mbë Zotinë; piqni ç' kini për të
pjekurë, edhe zjeni ç' kini për të zjerë; edhe
gjithë ç' të tepëronjë vloj-e-ni për vetëhenë
t' uaj, që të ruhetë gjer *nesërë* ndë mëngjest.
24 Edhe *ata* e vluanë gjer ndë mëngjest, sikun-
drë urdhëroj Moisiu; edhe nuk' uqelp, as nukë
25 zuri krymba. Edhe Moisiu tha, Ha-e-ni atë
sot; sepse sot është sabbatë mbë Zotinë; sot
26 nukë dot'a gjeni atë ndë fushët. Gjashtë dit
dotë mblithni atë; po të-shtattënë ditë, sab-
batënë, nukë dotë gjëndetë nd' atë.
27 Edhe ca *veta* nga gjindja duallë të-shtat-
28 tënë ditë të mblidhinë, po nukë gjetnë. Edhe

Zoti i tha Moisiut, Gjer kur nukë dotë doni
të mbani porosit' e mia, edhe nomet' e mi?
29 Shihni, se Zoti u dha juve sabbatënë, *edhe*
përandaj të-gjashttënë ditë u ep juve bukë për
dy dit; letë rrijë gjithë-si-cili ndë vëntt të ti;
asndonjë të mos dalë nga vëndi i ti të-shtat-
30 tënë ditë. Kështu gjindja uprëjt të-shtattënë
ditë.
31 Edhe shtëpia e Israilit j'a vuri emërinë
asaj Mannë; edhe ishte posi koqe koriandre,
e-bardhë; edhe të-ngrënët' e asaj ishte posi
të-ngrënët' e petullavet me mjaltë.
32 Edhe Moisiu tha, Këjo është ajo gjë që
urdhëroj Zoti, Mbushni nga ajo një omer, që
të ruhetë ndë brezat t' uaj; që të shohënë
bukënë, me të-cilën' u ushqeva ndë shkretë-
tirët, kur u nxora juve nga dheu i Egjyptësë.
33 Edhe Moisiu i tha Aaronit, Merr një shtëm-
bë, edhe vërë nd' atë një omer plot me manne,
edhe vër' e atë përpara Zotit, që të ruhetë
34 ndë brezat t' uaj. Edhe Aaroni e vuri atë
përpara *arkës' së* Dëshmimit, që të ruhetë,
sikundrë Zoti urdhëroj Moisinë.
35 Edhe të bijt' e Israilit hëngrrë mannë dy-
zet vjet, gjersa erthnë ndë sinorët të Hanaa-
36 nit. Edhe omeri është një e-dhjettët' e efahut.

Krye 17.

1 Edhe gjithë mbledhja e të bijvet të Isra-
ilit ungritnë nga shkretëtira e Sinit, edhe bë-

në udhë prej vëndi mbë vënt, pas urdhërimit fë Zotit, edhe ngulnë ushtërinë ndë Refidim, ku nukë kishte ujë për të pirë gjin-
2 dja. Edhe gjindja uzu me Moisinë, e thoshte, Ep-na ujë të pimë. Edhe Moisiu u tha atyre,
3 Përse zihi me mua? përse ngitni Zonë? Edhe gjindjenë e mori atje etja për ujë; edhe gjindja murmuriste kundrë Moisiut, e thoshte, Përse na ngritë nga Egjypta, që të na vrasç neve edhe bijtë t' anë edhe bagëtitë t' ona me etje?
4 Edhe Moisiu thërriti mbë Zotinë, dyke thënë, Ç' t'i bënj kësaj gjindjeje? po-thua janë gati të më vrasënë me gurë.
5 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko përpara gjindjesë, edhe merr me vetëhe nga pleqt' e Israilit; merr ndë dorët t' ënde edhe stapnë,
6 me të-cilin' i re lumit, edhe shko; Na unë tek dotë rri atje përpara teje mbi shkëmpt ndë Horib; edhe dot' i bjesh shkëmbit, edhe dotë dalë ujë nga ay, që të pijë gjindja. Edhe Moisiu bëri kështu përpara pleqvet të Israilit.
7 Edhe j'a vuri emërinë vëndit Massah edhe Meribah*), për grindjen' e të bijvët të Israilit, edhe sepse nganë Zotinë, dyke thënë, Është Zoti ndër mest t' ënë, apo jo?
8 Atëhere erdhi Amaliku, edhe luftoj me
9 Israilinë ndë Refidim. Edhe Moisiu i tha Joshuajt, Sgjith burra prej jush, edhe dil, e lufto

*) Ngasje edhe Grindje.

me Amalikunë; nesërë unë dotë rri ndë majët
të kodrësë *dyke mbajturë* ndë dorët t' ime sta-
10 pin' e Perëndisë. Edhe Joshuaj bëri sikundrë
i tha ati Moisiu, edhe luftoj me Amalikunë;
edhe Moisiu, *e* Aaroni, e Huri hipnë ndë ma-
11 jët të kodrësë. Edhe kur ngrinte Moisiu do-
rën' e ti, muntte Israili; edhe kur unjte do-
12 rën' e ti, muntte Amaliku. Edhe Moisiut i u-
rënduanë duartë; andaj muarrë një gur, edhe
e vunë përposh ati, edhe *ay* ndënji mbi atë;
edhe Aaroni e Huri, njëri nga njëra anë, e
tjatëri nga tjatëra, *i* mbaninë lart duart' e ati;
edhe duart' e ati qëndruanë të-forta gjer mbë
13 të-perëndуarët të djellit. Edhe Joshuaj prishi
Amalikunë edhe gjindjen' e ati më presjen' e
kordhësë.
14 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shkruaj-e këtë
ndë një vivli për të mbajturë mënt, edhe tre-
goj-e ndë veshët të Joshuajt; se dotë shuanj
fare kujtimn' e Amalikut nga dheu ndënë qiellt.
15 Edhe Moisiu ndërtoj *atje* një therore, edhe
j'a vuri emërinë Jehovah-nissi,*) edhe tha,
Me-qënë-që *ungrit* dorë kundrë fronit të Zo-
tit, Zoti dotë ketë luftë me Amalikunë bres
pas brezi.

Krye 18.

1 Edhe Jethroj, prifti i Madhiamësë, i vëje-
hërri i Moisiut, dëgjoj për gjithë sa i bëri

*) Zoti është Flamuri im.

Perëndia Moisiut, edhe Israilit, gjindjes' së ti,
2 si Zoti e nxori Israilinë nga Egjypta. Edhe
Jethroj, i vëjehërri i Moisiut, mori Zippora-
hënë, të shoqen' e Moisiut, të-cilënë j'a kishte
3 dërguarë prapë, Edhe të dy të bijt' e asaj,
nga të-cilëtë njëri e kishte emërinë Gjershom,
sepse tha, Ndënja i-huaj ndë dhe të-huaj;
4 Edhe tjatëri e kishte emërinë Eliezer, sepse
tha, Perëndia i t'im et qe ndihma ime, e më
5 shpëtoj nga kordha e Faraonit; Edhe Jethroj,
i vëjehërri i Moisiut, erdhi te Moisiu bashkë
me të bijt' e ati, e me të shoqen' e ati, ndë
shkretëtirët, *atje* ku kishte ngulurë ushtërinë
6 ndë malt të Perëndisë; Edhe i tha Moisiut,
Unë Jethroj, yt vëjehërr, po vinj te ti, edhe
jot' shoqe, ëdhe të dy të bijt' e asaj bashkë
me atë.
7 Edhe Moisiu i dolli përpara të vëjehërrit,
edhe i unji kryetë, edhe e puthi; pastaj py-
etnë njëri jatrinë për shëndetinë, edhe hynë
8 ndë tendët. Edhe Moisiu i tregoj të vëjehë-
rrit gjithë sa i bëri Zoti Faraonit edhe Egjy-
ptianëvet për hir të Israilit, *edhe* gjithë mun-
dimetë që u gjanë atyre udhësë, edhe si Zoti
i shpëtoj ata.
9 Edhe Jethroj ugëzua tepërë për gjithë sa
të-mira që i bëri Zoti Israilit, të-cilin' e shpë-
10 toj nga dora e Egjyptianëvet. Edhe Jethroj tha,
Qoft' i-bekuarë Zoti, që u shpëtoj juve nga
dora e Egjyptianëvet, edhe nga dora e Fara-

onit; *Zoti*, i-cili shpëtoj gjindjenë që ndënë-
11 dorët të Egjyptianëvet. Tashi e njoh se Zoti
është më i-math se gjithë perëndiratë; sepse
ndë atë gjë që umbajtnë mbë të-math ubë
më i-lartë se ata.
12 Pastaj Jethroj, i vëjehërri i Moisiut, mòri
kurbanë të-gjithëdjegurë, edhe kurbanë për
Perëndinë; edhe erdhi Aaroni, edhe gjithë
pleqt' e Israilit, të haninë bukë bashkë me
të-vëjehërrin' e Moisiut përpara Perëndisë.
13 Edhe mbë të-nesërmet Moisiu ndënji të
gjykonte gjindjenë; edhe gjindja rrinte për-
para Moisiut, që ndë mëngjest e gjer mbrë-
14 manet. Edhe i vëjehërri i Moisiut, kur pa
gjithë sa i bënte *ky* gjindjesë, tha, Ç' është-
këjo punë që i bën ti gjindjesë? përse rri ti
vetëmë, edhe gjithë gjindja rri përpara teje
që ndë mëngjest e gjer mbrëmanet?
15 Edhe Moisiu i tha të vëjehërrit, Sepse
gjindja vjen tek unë, për të pyeturë Perën-
16 dinë, *Edhe* kur kanë ndonjë punë, vinjënë tek
unë, edhe unë gjykonj ndër mest të njërit e
të tjatërit, edhe *u* dëftenj urdhërimet' e Pe-
rëndisë, edhe nomin' e ati.
17 Edhe i vëjehërri i Moisiut i tha, Nuk' është'
18 e-mirë këjo punë që bën ti. Me të-vërtetë
edhe ti dotë lodhesh, edhe këjo gjindje që
është bashkë me ty; sepse puna është fort
e-rëndë për ty; nukë munt t'a bënjç këtë ve-
19 tëmë. Dëgjo pra zënë t' im; dotë të ap kë-

shillë, edhe Perëndia dotë jetë bashkë me ty;
ti të jesh përpara Perëndisë për gjindjenë,
20 që t'i sjellç punëtë përpara Perëndisë; Edhe
u mëso atyreve urdhërimetë edhe nometë,
edhe u dëfte atyre udhënë, ndë të-cilët du-
hetë të ecënjënë, edhe punënë që duhetë të
21 bënjënë. Edhe sgjith nga gjithë gjindja burra
të-zotër, t' atillë që i kanë frikë Perëndisë,
burra që duanë të-vërtetënë, që i kanë më-
ri fitimit të-shtrëmbërë; edhe vër' i *këta* kre-
rë mbi ata, krye-mijës, *e* krye-qindës, *e* krye-
22 pesëdhjetës, e krye-dhjetës; Edhe letë gjy-
konjënë gjindjenë mbë çdo kohë; edhe çdo
punë të-madhe ,let'a sjellënë te ti, po çdo
punë të-vogëlë let'a gjykonjënë ata vetë;
kështu dotë lehsohesh, edhe dotë mbanjënë
23 *barrënë* bashkë me ty. Ndë bëfsh këtë punë,
edhe Perëndia të urdhëron *kështu,* atëhere
dotë munç të qëndronjç, pastaj edhe gjithë
këjo gjindje dotë arrinjë ndë vëntt të saj me
paqtim.
24 Edhe Moisiu dëgjoj zën' e të vëjehërrit,
25 edhe bëri gjithë sa tha. Edhe Moisiu sgjodhi
nga gjithë llauzi burra të-zotër, edhe i vuri
ata të-parë mbi gjindjenë, krye-mijës, *e* krye-
qindës, *e* krye-pesëdhjetës, e krye-dhjetës;
26 Edhe gjykoninë gjindjenë mbë çdo kohë; *po*
punërat' e-rënda j'a bininë Moisiut, edhe çdo
punë të-vogëlë e gjykonin' ata vetë.
27 Pastaj Moisiu e la të vëjehërrinë të shko-
një; edhe ay shkoj ndë dhet të ti.

Krye 19.

1 Mbë të-tretinë muaj, pas të-dalit të të bij-
vet të Israilit nga Egjypta, gjithatë ditë erth-
2 në ndë shkretëtirët të Sinajt. Edhe kur u-
ngritnë nga Refidimi, e erthnë ndë shkretë-
tirët të Sinajt, ngulnë ushtërinë ndë shkre-
tëtirët; edhe atje Israili ngrehu tendat' e ti
kundruell malit.
3 Edhe Moisiu hipi te Perëndia; edhe Zoti
e thirri nga mali, e tha, Kështu t' i thuash
shtëpis' së Jakobit, edhe t' u apç zë të bijvet
4 të Israilit. Ju patë gjithë sa u bëra Egjypti-
anëvet, edhe si u mbajta juve mbi krahë
shqiponje, e u prura juve përanë vetëhesë
5 s' ime. Tashi pra, ndë i dëgjofshi me të-vër-
tetë zërit t' im, edhe ndë ruajçi dhiatënë t'
ime, atëhere dotë më jeni një thesar i-sgje-
dhurë përmbi gjithë kombetë; sepse gjithë
6 dheu është imi; Edhe ju dotë jeni tek unë
një mbretëri priftërsh, edhe komp i-shënjtë-
ruarë. Këto janë fjalëtë që dot' u flasç të bij-
vet të Israilit.
7 Edhe Moisiu erdhi, e dërgoj e thirri
pleqt' e gjindjesë, edhe vuri përpara aty-
reve gjithë këto fjalë, që i urdhëroj ati Zoti.
8 Edhe gjithë gjindja upërgjeq me një zë, e tha,
Gjithë sa foli Zoti dot' i bëjmë. Edhe Moisiu
i zuri n' gojë Zotit fjalët' e gjindjesë.
9 Edhe Zoti i tha Moisiut. Na unë tek po
vinj te ti ndë re të-dëndurë, që të dëgjonjë

gjindja, kur të flas me ty, edhe të të zërë besë ty përherë. Edhe Moisiu i dha zë Zotit për fjalët' e gjindjesë.

10 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko te gjindja, edhe shënjtëro ata sot edhe nesërë, edhe
11 letë lanjënë rrobat' e tyre, Edhe letë bënenë gati për të-tretënë ditë; sepse të-tretënë ditë dotë sbresë Zoti ndë malt të Sinajt përpara
12 gjithë gjindjesë; Edhe dot' i vësh sinorë gjindjesë përqark, dyke thënë, Ruhi të mos hipni ndë malt, a t' u piqni rrëzavet t' ati; kush
13 t' i pjekë malit, pa fjalë dotë vritetë. Asndonjë dorë të mos i pjekë ati, sepse pa fjalë dotë vritetë me gurë, a dotë shëgjetonetë me shëgjetë; a shtëzë qoftë, a njeri, nukë dotë mbetetë i-gjallë. Kur të bjerë trumbeta, atëhere dotë hipënjënë ndë malt.

14 Edhe Moisiu sbriti nga mali te gjindja, edhe shënjtëroj gjindjenë; edhe lanë rrobat'
15 e tyre. Edhe i tha gjindjesë, Bëhi gati për të-tretënë ditë; mos i afëhori gruaje.

16 Edhe të-tretënë ditë, ndë mëngjest, ubënë bubullima e vetëtima, edhe ishte një re edëndurë ndë malt, edhe një zë trumbete fort i-fortë; edhe udroth gjithë gjindja që ishte
17 nde fushatët. Atëhere Moisiu nxori gjindjenë nga fushata, që të dilte përpara Perëndisë,
18 edhe qënduanë ndënë malt. Edhe mali i Sinajt ishte gjithë tym; sepse Zoti sbriti mb'

atë ndë zjarr; edhe tymi i ati hipënte posi tym kumine, edhe tërë mali tundej fort.
19 Edhe zëri i trumbetësë tek po vinte dyke ushtuarë fort e më fort, Moisiu fliste, edhe Perëndia i përgjigjej ati me zë.
20 Edhe Zoti sbriti mbi malt të Sinajt, ndë majët të malit; edhe Zoti thirri Moisinë ndë
21 majët të malit; edhe Moisiu hipi. Edhe Zoti i tha Moisiut, Sbrit, edhe me pushtet urdhëro gjindjenë, semos kapërxenjënë sinorëtë *e hipënjënë* te Zoti për të vështruarë, edhe pri-
22 shenë shumë veta nga ata. Edhe priftëritë, të-cilëtë i afëronenë Zotit, letë shënjtëronenë, semos hidhetë Zoti mbi ata.
23 Edhe Moisiu i tha Zotit, Gjindja nukë munt të hipënjë ndë malt të Sinajt; sepse ti na urdhërove, dyke thënë, Vërë sinorë përqark malit, edhe shënjtëro-e atë.
24 Edhe Zoti i tha ati, Shko, sbrit; pastaj hipë ti, edhe Aaroni bashkë me ty; po priftërit' edhe gjindja të mos kapërxenjënë sinorëtë, që të hipënjënë te Zoti, semos hidhetë mbi ata. Kështu Moisiu sbriti te gjindja, e u foli atyre.

Krye 20.

1 Edhe Perëndia foli gjithë këto fjalë, dyke
2 thënë, Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të nxora nga dheu i Egjyptësë, nga shëpia e robë-
3 risë. Mos kesh të-tjerë perëndira veç meje.

4 Mos bënjç për vetëhenë t'ënde idhull, as
të-përgjaturë të ndonjë gjëje që është lart
ndë qiellt, a që është poshtë ndë dhet, a që
5 është ndër ujërat përposh dheut; Mos u fa-
lesh atyre, as mos i lusç; sepse unë Zoti,
Perëndia yt, jam Perëndi zilitar, që çpaguanj
fajet' e atërvet mbi djemt, gjer mbë të-tretinë edhe të-katrëtinë bres t' atyreve që më
6 kanë mëri; Edhe që bënj përdëllim mbë mi-
jëra *brezash* atyreve që më duanë edhe ru-
anjënë urdhërimet' e mi.
7 Mos marrç emërin' e Zotit, Perëndisë t' ënt,
mbë të-kotë; sepse Zoti nukë dotë nxjerrë
të-pafajm atë që merr emërin' e ati mbë të-
kotë.
8 Kujto ditën' e sabbatësë që t'a shënjtë-
9 ronjç atë. Gashtë dit dotë punonjç, edhe dotë
10 bënjç gjithë punët' e tua; Po e-shtatëta ditë
është sabbatë mbë Zotinë, Perëndinë t' ënt;
nd' atë ditë nukë dotë bënjç asndonjë punë,
as ti, as yt bir, as jot' bijë, as shërbëtori yt,
as shërbëtoreja jote, as bagëtia jote, as i-huaji
11 yt, që është përbrënda dyervet të tua; Sepse
ndë gjashtë dit Zoti bëri qiellin' edhe dhenë,
detinë, edhe gjithë sa janë nd' ata, edhe të-
shtattënë ditë uprëjt; përandaj Zoti e bekoj
ditën' e sabbatësë, edhe e shënjtëroj atë.
12 Ndero t' ët atë e t' ët ëmë, që të bënesh
jetë-gjatë mbi dhet, që të ep Zoti, Perëndia yt.
13 Mos vrasç.

14 Mos kurvëronjç.
15 Mos vjethç.
16 Mos bënjç dëshmi të-rreme kundrë t' afërmit t' ënt.
17 Mos dëshëronjç shtëpin' e të-afërmit t'ënt; mos dëshëronjç gruan' e të-afërmit t' ënt, as shërbëtorin' e ati, as shërbëtoren' e ati, as kan' e ati, as gomarin' e ati, as çdo gjë që është e të-afërmit t' ënt.
18 Edhe gjithë gjindja shihte bubullimat' e vetëtimatë, edhe zën' e trumbetësë, edhe malinë dyke nxierrë tym; edhe gjindja kur panë këto, utrëmpnë, edhe ndënjnë së-largu.
19 Edhe i thanë Moisiut, Ti fol'-na neve, edhe ne dotë dëgjojmë; edhe letë mos na flasë Perëndia, që të mos vdesëmë.
20 Edhe Moisiu i tha gjindjesë, Mos frikësohi; sepse Perëndia erdhi që t'u provonjë, edhe që të jetë frika e ati përpara jush, që të mos fëjeni.
21 Edhe gjindja ndënji për së-largu; edhe Moisiu uafërua ndë errësirët të-dëndurë *atje* ku ishte Perëndia.
22 Edhe Zoti i tha Moisiut, Kështu u thuaj të bijvet të Israilit, Ju vetë patë se fola nga
23 qielli me ju. Mos bëni perëndira të-ergjënttë me mua, as mos bëni perëndira të-artë për
24 vetëhenë t' uaj. Bëj për mua therore prej dheu, edhe bëj kurban mbi atë kurbanët' e tu të-gjithëdjegurë, dhuratat' e tua të paq-

timit., dhënt' e tua, edhe qet' e tu; mbë çdo vënt që të përmënt emërinë t' im, dotë vinj te ti, e dotë të bekonj ty. Edhe ndë më bëfsh therore prej guri, të mos e ndërtonjç prej gurësh të-gdhëndurë; sepse ndë shkofsh hekurishtenë t' ënde mbi atë, e ndyre atë. As mos hipç me shkallë mbi theroret t' ime, që të mos sbulonetë të-sveshuritë t' ënt mbi atë.

Krye 21.

1 Tashi këta janë gjyqetë, që dotë vësh përpara atyreve.

2 Ndë blefsh shërbëtuar Ebre, gjashtë vjet ka për të shërbyerë; e të-shtattinë dotë dalë i-liruarë, pa paguarë asgjë. Ndë pastë hyrë i-vetëmë, i-vetëmë dotë dalë. Ndë pastë pasurë grua, atëhere edhe gruaja e ati dotë dalë bashkë me atë. Ndë i pastë dhënë ati grua i zoti, edhe t'i ketë pjellë bij a bija, gruaja ëdhe djemt' e asaj dotë jenë të të zot t'asaj, edhe ay dotë dalë i-vetëmë. Po ndë thëntë shërbëtori me zëmërë të-kthjellëtë, Dua t' im zot, gruanë t' ime, e djemt' e mi; nukë dua të dal i-liruarë; Atëhere i zoti dot'a bjerë atë te gjykatësitë;*) edhe dot'a bjerë atë te dera, a te shtylla e derësë, edhe i zoti dot' i çponjë ati veshinë me çponjës; edhe *ay* dot' i shërbenjë ati për gjithë jetënë.

7 Edhe ndë shittë ndonjë bijën' e ti për shër-

*) A: te Perëndia.

bëtore, *ajo* s' ka për të dalë sikundrë dalënë
8 shërbëtoretë. Ndë mos e pëlqeftë atë i zoti,
që e vloj për vetëhen' e ti, atëhere dot'a çpër-
blenjë atë; nukë dotë ketë pushtet t'a shesë
ndë komp të-huaj; sepse dolli i-pabesë tek
9 ajo. Po ndë e vloftë atë me të birrë, atëhere
10 dot' j'a bënjë asaj pas udhës' së bijavet. Ndë
marrtë një tjetërë për vetëhe, nukë dot' i
shternjë asaj ushqimnë, *e* rrobat' e asaj, edhe
11 detyrën' e martesësë *mbë atë*. Po ndë mos i
bëftë asaj këto të tria, atëhere *ajo* dotë dalë
dhurëti, pa ergjënt.

12 Kush t'i bjerë ndonjë njeriu, edhe ky të
13 vdesë, pa fjalë dotë vritetë. Po ndë mos e
pastë priturë ndë pritë, po Perëndia j'a dha
ndë dorë, atëhere unë dotë shënonj vënt ku
14 të ikënjë. Po ndë ungrittë ndonjë kundrë të-
afërmit të ti dyke dashurë, që t'a vrasë me
dinakëri, dot'a çkëputç atë *edhe* nga thero-
reja ime, që të vritetë.

15 Edhe kush t' i bjerë t' et a s' ëmësë, pa
fjalë dotë vritetë.

16 Edhe kush të vjedhë njeri, edhe t'a shesë,
a ndë ugjënttë ndë dorët t' ati, pa fjalë dotë
vritetë.

17 Edhe kush të flasë keq për t' anë, a për
t' ëmënë, pa fjalë dotë vritetë.

18 Edhe ndë uhëngrëshinë me fjalë njerës,
edhe njëri t'i bjerë tjatërit me gur a me gruhst,
edhe ky të mos vdesë, po të dergjetë ndë

19 shtrat, Ndë ungrittë, edhe të ecënjë jashtë me
stapin' e ti, atëherë ay që i ra dorë jetë i-lirë;
vetëmë dot'a paguanjë për kohënë që humbi,
edhe dotë kujdesetë për atë gjersa të shë-
ronetë fare.
20 Edhe ndë i rëntë ndonjë njeri me stap shër-
bëtorit të ti a shërbëtores' së ti, edhe të vdesë
ndënë duart t' ati, pa fjalë dotë mundonetë.
21 Po ndë rroftë një ditë, a dy, nukë dotë mun-
donetë; sepse është ergjëndi i ati.
22 Ndë uzënçinë burra, e t' i bjenë *ndonjë*
gruaje së-mbarsurë, kaqë sa të dështonjë, po
asaj të mos *i* gjanjë ndonjë e-keqe, pa fjalë
dotë paguanjë atë pagë që t' i kërkonjë bu-
rri i asaj; edhe dotë paguanjë si të vëndos-
23 njënë gjykatësitë. Po ndë i gjaftë ndonjë e-
keqe, atëhere dotë apç jetë ndë vënt jete,
24 Sy ndë vënt syri, dhëmp ndë vënt dhëmbi,
dorë ndë vënt dore, këmbë ndë vënt këmbe,
25 Të-djegurë ndë vënt të-djeguri, plagë ndë
vënt plage, të-rënë ndë vënt të-rëni.
26 Ndë i rëntë ndonjë shërbëtorit të ti ndë
syt, a shërbëtores' së ti ndë syt, edhe t'a vër-
bonjë atë, dot'a lëshonjë këtë të-liruarë për
27 punë të syrit t'ati. Edhe ndë nxjerrtë dhëmbin'
e shërbëtorit të ti, a dhëmbin' e shërbëtores'
së ti, dot'a lëshonjë atë të-liruarë për punë
të dhëmbit t' ati.
28 Edhe ndë i rëntë ndonjë ka me bri burri
a gruaje, edhe të vdesë, *atëhere* kau pa fjalë

dotë vritetë me gurë, edhe mishi i ati të mos
29 hahetë; po i zot' i kaut dotë jetë pa faj. Po
ndë bij *kau* me brirë që më parë, e i ubë
dëshmim të zot, edhe nuk' e ruajti atë, edhe
kau vrau burr' a grua, *atëhere* kau dotë vri-
tetë me gurë, po dotë vritetë edhe i zoti.
30 Ndë i vënçinë ati nder çpërblimi, dotë apë
për çpërblimin' e jetës' së ti çdo që t' i vënë
31 ati. A ndë i rëntë me bri *ndonjë* djali, a ndë
i rëntë me bri *ndonjë* çupeje, dot' i bënet' ati
32 pas gjithati gjyqi. Ndë i rëntë kau *ndonjë*
shërbëtori a shërbëtoreje, dot' i apë të zot t'
atyre tri-dhjetë shekëlla ergjëndi; edhe kau
dotë vritetë me gurë.

33 Edhe ndë haptë gropë ndonjë, a ndë rë-
moftë gropë ndonjë, edhe të mos e mbulonjë,
34 edhe të bjerë nd' atë kâ a gomar, I zot'
i gropësë dotë paguanjë dëminë; dot' i apë
ergjënt të zot t' atyre; edhe kafsha që uvra
dotë jet' e ati.

35 Edhe kau i ndonjëj ndë i rëntë me bri kaut
të të-afërmit t' ati, edhe të ngorthnjë, atëhere
dotë shesënë kan' e-gjallë, edhe dotë nda-
njënë çëmimn' e ati; edhe atë që uvra dot'a
36 ndanjënë po ashtu. Po ndë dihej se kau bij
me bri që më parë, edhe i zoti nuk' e ruante
atë, pa fjalë dotë paguanjë ka ndë vënt kau,
edhe kau që uvra dotë jetë i ati.

Krye 22.

1 Ndë vjethtë ndonjë njeri ka a dele, edhe t'a thernjë a t'a shesë, *atëhere* dotë paguanjë pesë qe për një ka, edhe katrë dhën për një dele.

2 Ndë ugjënttë vjedhësi dyke thyerë, edhe t' i bjenë e të vdesë, nukë *dotë derdhetë* gjak 3 për atë. *Po* ndë linttë djelli mbi atë, *dotë derdhetë* gjak për atë; *sepse vjedhësi* dot'a paguante; *edhe* ndë mos kishte, dotë shitej për 4 atë që vodhi. Gjëj' e-vjedhurë ndë ugjënttë e-gjallë ndë duart t' ati, a ka, a gomar, a dele, dot'a paguanjë dy herë aqë.

5 Ndë ubëftë ngajë ndonjë njeri të hahetë arë a veshtë, edhe ndë lëntë bagëtin' e ti të-sgidhurë, edhe këjo të kullosë ndë arët të tjetërë njeriu, dot' j'a çpaguanjë nga më e-mira *pemë e* arës' së ti, edhe nga më e-mira *pemë* e veshtit të ti.

6 Ndë daltë zjarr, e të gjenjë gjëmba, edhe të digjenë mullarë drithi, a drithë të-pakorrurë, a arë, ay që ndezi zjarrinë pa fjalë dot'a paguanjë.

7 Ndë lëntë ndonjë njeri tek i-afërmi i ti ergjënt a plaçkë për të ruajturë, edhe të vidhenë nga shtëpia e ati njeriu, ndë ugjënttë 8 vjedhësi, dotë paguanjë dy hyrë aqë. *Po* ndë mos ugjënttë vjedhësi, atëhere i zot' i shtëpisë dotë bihetë përpara gjykatësvet*), *e dotë*

*) A: Perëndisë.

pyetetë ndë vuri a ndë mos vuri dorën' e ti mbi gjën' e të-afërmit të ti.

9 Për çdo farë dëmi, për ka, për gomar, për dele, për rrobë, *a* për çdo gjë të-humburë, për të-cilënë ndonjë thotë se ësht' e tia, pun' e të dy anëvet dotë bihetë përpara gjykatësvet; *edhe* cilinë të dënonjënë gjykatësitë, ay dot' i paguanjë të-afërmit të ti dy herë aqë.

10 Ndë i dhëntë ndonjë njeri të-afërmit të ti ndë dorë gomar, a ka, a dele, a çdo farë bagëtie, për të ruajturë, edhe të ngorthnjë, a të vritetë, a të rrëmbehetë, pa parë ndonjë

11 njeri, Bej' e Zotit dotë bënetë ndër mest të dyve, se nukë vuri dorën' e ti mbi gjën' e të-afërmit të ti; edhe i zoti dot'a presë *benë*,

12 edhe *tjatëri* nukë dot' *j'a* paguanjë. Po ndë

13 uvoth nga ay, dot' j'a paguanjë të zot. Ndë e pastë copëtuarë bishë, dot'a bjerë atë për dëshmim; s'e ka për të paguarë të-copëtuarënë nga bisha.

14 Ndë uhuajtë ndonjë njeri gjë *të-gjallë* nga i-afërmi i ti, edhe t' i thyetë gjë, a të ngorthnjë, *edhe* i zoti të mos jetë bashkë me atë,

15 pa fjalë dot'a paguanjë. *Po* ndë qoftë i zoti bashkë me atë, nukë dot' e paguanjë; ndë qoftë se e kiskte zënë me pagë, erdhi për pagën' e ti.

16 Ndë gënjeftë ndonjë njeri vajzë të-pavluarë, e të flerë bashkë me atë, pa fjalë dot' i

17 apë asaj pajë, edhe t'a marrë për grua. *Po*

ndë mos dashtë i ati i asaj t' j'a apë ati, dotë paguanjë ergjënt pas pajës' së vajzavet.

18 Të mos lësh magjistare të rronjë.

19 Kush të gjëndetë me bagëti pa fjalë të vritetë.

20 Kush t'u bënjë kurban perëndirave, përveç Zotit vetëmë, dotë shuhetë.

21 Mos i bënjç keq të-huajit, as mos e mundonjç atë; sepse *edhe* ju qetë të-huaj ndë dhet të Egjyptësë.

22 Mos mundonjç asndonjë grua të-ve, a djalë të-varfërë.

23 Ndë mundofsh ata me ndonjë mënyrë, edhe të thërresënë mbë mua, pa fjalë dotë
24 dëgjonj zën' e atyre; Edhe zëmërimi im dotë ndizetë, edhe dot' u vras juve me kordhë; edhe gratë t' uaj dotë mbetenë të-va, edhe djemtë t' uaj të-varfërë.

25 Ndë i dhënç hua ergjënt ndonjë të-vobegu prej gjindjesë s' ime që është bashkë me ty, nukë dotë sillesh tek ay posi uzurëtar; nukë dot' i vësh ati uzurë.

26 Ndë marrç penk rrobën' e të-afërmit t' ënt, t' j'a kthenjç ati më përpara se të perëndo-
27 një djelli; Sepse këjo është e-vetëma mbulesë e ati; këjo është rroba e ati për *të mbuluarë* lëkurën' e ti; me se dotë flerë? edhe kur të thërresë mbë mua, dotë dëgjonj; sepse unë jam i-përdëllyershim.

28 Mos flasç keq për gjykatësitë,*) as mos
mallëkonjç ndonjë të-parë të gjindjesë s'ate.
29 Nukë dotë mënonjç të *më* apç duart' e-
para të lëmit e të tirësë s' ate; nga bijt'e tu
30 dotë më apç të-parëlindurinë. Gjithashtu dotë
bënjç *edhe* për kanë t' ënt, *e* për delenë t'
ënde; shtatë dit dotë rrijë bashkë me t'ëmë-
në; të-tettënë ditë dotë m'a apç.
31 Edhe ju dotë jeni burra shënjtorë tek unë;
edhe të mos hani mish të-mbyturë nga bi-
shatë ndë fushët; t' u'a hithni qënvet.

Krye 23.

1 Mos nxjerrç zë të-rrem; mos bënesh mbë
një fjalë me të-paudhinë, që të dalç dësh-
2 mimtar i-rrem. Mos veç pas të shumëvet për
të bërë keq; as mos flasç ndë gjyq, që të
priresh pas të-shumëvet për të prishurë *gjy-*
3 *qinë;* As mos i mbanjç anë të-vobegut ndë
gjyqt t' ati.
4 Ndë gjeç përpara kan' e armikut t' ënt a
gomarin' e ati që ka humburë udhënë, pa
5 fjalë t' j'a shpjesh atë prapë. Ndë pafsh të-
rëzuarë nga barra gomarin' e ati që të ka
mëri, edhe ndë qoftë se nukë do t' i ndihç,
prapë pa fjalë duhetë të ndihç bashkë me atë.
6 Mos i prishç gjyqinë të-vobegut t' ënt ndë
7 gjyqt t' ati. Rri lark nga pun' e-paudhë; edhe
mos vrit të-pafajmin' edhe të-drejtinë; sepse

*) A:për Perëndinë.

8 unë nukë dotë nxjer të-drejtë të-ligunë. Edhe
mos marrç mitë; sepse mita verbon *edhe*
ata që kanë sy, edhe shtrëmbëron fjalët' e
të-drejtëvet.
9 Edhe mos mundonjç të-huajnë; sepse ju
e njihni zëmërën' e të-huajit, sepse *edhe ju*
qetë të-huaj ndë dhet të Egjyptësë.
10 Edhe gjashtë vjet të mbjellç dhenë t' ënt,
11 edhe të mblethç dhedhënjet' e ati; Po të-shtat-
tinë *vit* t'a lësh të prëhetë, e të mbesë i-papu-
nuarë, që të hanë të-vobeqt' e gjindjesë s'ate;
edhe atë që të lënë ata t'a hanë shtëzët' e
fushësë. Kështu dotë bënjç *edhe* për vështi-
në t' ënt, e për ulishtënë t' ënde.
12 Gjashtë dit të bënjç punët' e tua, edhe
të-shtattënë ditë të prëhesh, që të prëhetë
kau yt, e gomari yt, edhe të përsëritetë i li-
ri i shërbëtoresë s' ate, e i-huaji.
13 Edhe të kujdesi të bëni gjithë sa u thash-
shë juve; edhe mos përmëntni emër të pe-
rëndirave të-tjerë, as të dëgjonetë nga go-
ja jote.
14 Tri herë ndë vitt të mbanjç të-kremt: për
15 mua. Dotë ruanjç të-kremten' e të-pabrmjë-
vet; shtatë dit dotë hash bukë pa thumë,
sikundrë të urdhërova ty, ndë kohët ti-nda-
rë të muajit t' Abidit; sepse nd' atë *muaj* do-
lle nga Egjypta; edhe asndonjë të nos du-
16 ketë përpara meje me duar të-sbrazët; Edhe
të-kremten' e të-korrit, të drithëravet të-para

të mundimevet të tu, që mbolle nd' arët; edhe
të-kremten' e të-mbledhurit, ndë të-mbaruarët të vitit, passi të kesh mbledhurë *pemët'*
17 e mundimevet të tu nga ara. Tri herë ndë
vitt të dukenë gjithë meshkujt' e tu përpara
Zotit, Perëndisë.
18 Mos bjesh gjakun' e kurbanit t' im me
bukë të mbrumë; as të mos mbetetë të-majmit' e së-kremtesë s' ime tërë natënë gjer ndë
mëngjest.
19 Duart' e-para të pemëvet të-para të dheut
t' ënt t' i bjesh ndë shtëpit të Zotit, Perëndisë t' ënt. Mos zjesh kec ndë qumështt të
mëmës' së ti.
20 Na unë tek po dërgonj ëngjëll përpara
teje, që të të ruanjë udhësë, edhe të të sje-
21 llë ndë atë vënt që bëra gati. Ki frikë ati,
edhe dëgjo-i zërit t' ati; mos zëmëronjç atë;
sepse nukë dotë të ndjenjë fajetë; sepse e-
22 mëri im është nd' atë. Po ndë i dëgjofsh me
të-vërtetë zërit t' ati, edhe të bënjç gjithë sa
them, atëhere unë dotë jem armiku i armiqet
të tu, edhe kundrështari i kundrështarëvet të
23 tu. Sepse ëngjëlli im dotë shkonjë përpara teje,
edhe dotë të futnjë ty te Amoritët' e te Hittitët' e te Ferizitët' e te Hanaanitët' e te Hivitët'
e te Jebusitëtë; edhe unë dot' i shuanj ata.
24 Mos u falesh perëndiravet t' atyre, as mos
lusç ata, as mos punonjç pas punëvet t' atyre; po t' i shuanjç ata, e të thyenjç idhujt'

25 e atyreve. Edhe të lutni Zotinë, Perëndinë t' uaj, edhe ay dotë bekonjë bukënë t' ënde, edhe ujëtë t' at; edhe dotë largonj çdo sëmun-
26 dje prej mezit t' ënt. Ndë dhet t' ënt nukë dotë ketë femërë që të dështonjë a të jetë shterpë; numërin' e ditvet të tua dot'a bënj të-plotë.

27 Dotë dërgonj frikënë t' ime përpara teje, edhe dotë shuanj çdo gjindje, mbi të-cilënë vjen ti, edhe dotë bënj gjithë armiqt' e tu të
28 të kthejnë kurrizinë. Edhe dotë dërgonj grerëza përpara teje, edhe dotë dëbonjënë përpara teje Hivitet' e Hanaanitët' e Hittitëtë.
29 Nukë dot' i dëbonj ata që përpara teje mbë një vit, që të mos shkretonetë dheu, e shu-
30 monenë bishat' e fushësë kundrë teje; Pak nga pak dot' i dëbonj ata që përpara teje, gjersa të shtonesh, e të trashëgonjç dhenë.

31 Edhe dotë vë sinorët' e tu që nga Deti i-Kuq e gjer ndë dett të Filistinëvet, edhe që nga shkretëtira e gjer ndë Lumët; sepse dotë ap ndë dorët t' ënde ata që rrinë nd' *atë* vënt,
32 edhe dotë dëbonjç ata përpara teje. Të mos lithç fjalë me ata, as me perëndirat' e aty-
33 reve. Nukë dotë rrinë ndë dhet t' ënt, që të mos të bënjënë të fëjenjç kundrë meje; sepse ndë lusç perëndirat' e atyre, këjo pa fjalë dotë jetë një kurth për ty.

Krye 24.

1 Pastaj i tha Moisiut, Hipë te Zoti ti edhe
Aaroni, Nadabi edhe Abihuj, edhe shtatë-dhje-
të veta nga pleqt' e Israilit, edhe faluni për
2 së-largu; Edhe vetëmë Moisiu dot' i afëronetë
Zotit; po ata nukë dot' afëronenë; as gjindja
të mos ngjitetë bashkë me atë.

3 Edhe Moisiu erdhi, e i tregoj gjindjesë
gjithë fjalët' e Zotit, e gjithë gjyqetë; edhe
gjithë gjindja upërgjeq me një zë, e tha, Gji-
thë fjalëtë që foli Zoti dot' i bëjmë.

4 Edhe Moisiu shkroj gjithë fjalët' e Zotit;
edhe ungrit çpejt me natë, e ndërtoj një the-
rore ndënë malt, edhe *nguli* dy-mbë-dhjetë
shtylla, pas të dy-mbë-dhjetë faravet të Isra-
5 ilit. Edhe dërgoj djaloshë nga të bijt' e Israi-
lit, edhe i prunë Zotit kurbanë të-gjithëdje-
gurë, edhe bënë kurban dhurata paqtimi prej
6 demash. Edhë Moisiu mori gjysmën' e gjakut
edhe e vuri ndë lekanë; edhe me gjysmën' e
7 gjakut spërkati therorenë. Pastaj mori vivlin'
e dhiatësë, edhe *e* këndoj ndë veshët të gjin-
djesë; edhe ata thanë, Gjithë sa tha Zoti dot' i
8 bëjmë; edhe dotë bindemi. Edhe Moisiu mori
gjakunë, e spërkati gjindjenë, edhe tha, Na
gjaku i dhiatësë, që bëri Zoti bashkë me ju
pas gjithë këtyre fjalëve.

9 Atëhere hipi Moisiu e Aaroni, Nabadi e
Abihuj, edhe shtatë-dhjetë veta nga pleqt' e

10 Israilit; Edhe panë Perëndin' e Israilit; edhe
ndënë këmbët t' ati ishte posi truall i-shtru-
arë me gur sapfiri, edhe ishte i-kthjellëtë posi
11 qëndresa e qiellit. Edhe nukë vuri dorën' e
ti mbi të-sgjedhurit' e të-bijvet të Israilit;
edhe panë Perëndinë, e hëngrrë e pinë.
12 Edhe Zoti i tha Moisiut, Hipë ndë malt
tek unë, edhe ij atje; edhe dotë t' ap ty rra-
sat' e-gurta, edhe nominë, edhe porositë që
shkrova, që t' u'a mësonjç atyre.
13 Edhe Moisiu ungrit bashkë me Joshuanë,
shërbëtorin' e ti; edhe Moisiu hipi ndë malt
të Perëndisë.
14 Edhe u tha pleqvet, Prit-na-ni këtu gjer-
sa të kthenemi te ju; edhe na Aaroni edhe
Huri tek janë bashkë me ju; kushdo që të
ketë ndonjë punë, letë vinjë tek ata.
15 Moisiu pra hipi ndë malt, edhe reja mbu-
16 loj malinë. Edhe lavdia e Zotit ndënji mbi
malt të Sinajt, edhe reja e mbulloj gjashtë
dit; edhe të-shtattënë ditë *Zoti* i foli Moisiut
17 nga mezi i resë. Edhe të-pamët' e lavdis' së
Zotit ishte ndër syt të bijvet të Israilit posi
18 zjarr që djek mbi majët të malit. Edhe Mo-
isiu hyri ndë mest të resë, edhe hipi mbi
malt; edhe Moisiu ishte ndë malt dyzet dit
e dyzet net.

Krye 25.

1 Edhe Zoti i foli Moisiut, e tha, 2) U thuaj
të bijvet të Israilit të bjenë dhuratë për mua;

dotë merrni dhuratënë t' ime prej çdo njeriu
3 që *e* ep me gjithë zëmërë. Edhe këjo është
dhurata që dotë merrni nga ata; ar, e er-
4 gjënt, e ramë; E të-kaltërë[1]), e të-porfyrtë,
5 e të-kuq, e li të-hollë, e *lesh* dhish; E lë-
kurë deshësh ngjyerë të-kuqe, e lëkurë del-
6 finësh, e dru shittimi[2]); Vaj për dritënë, erëra
për vajin' e të-lyerit, e për thimiamënë me erë
7 të-mirë; Gurë të-thonjtë, e gurë për të vënë
8 ndë efodt e ndë rrasët të krahërorit. Edhe
letë më bënjënë një shënjtërore, që të rri ndër
9 mest t' atyreve. Pas gjith' atyre që të rrëfeva,
pas shëmbëllimit të tendësë, e pas shëmbë-
llimit të gjithë enëvet t' asaj, kështu dotë
bëni.
10 Edhe dotë ndërtonjënë një arkë prej druje
shittimi; dy kut e gjysmë dotë jetë të-gjatët'
e asaj, e një kut e gjysmë të-gjerët' e asaj,
11 e një kut e gjysmë të-lartët' e asaj. Edhe
dot'a mbulonjç me ar të-kulluarë, përbrënda
e përjashta dot'a mbulonjç, edhe dotë bënjç
mbi atë një kurorë t' artë rreth e rrotullë.
12 Edhe dotë derthç katrë rrethka t' arta për atë,
e t'i vësh mbë të katrë këmbët' e asaj; dy
rrethka mbë njërënë brinjë t' asaj, e dy rreth-
13 ka mbë tjetërënë brinjë t' asaj. Edhe dotë
bënjç shule prej druje shittimi, edhe dot' i
14 mbulonjç përqark me ar. Edhe dotë shkosh
shuletë ndë rrethkat të brinjëvet të arkësë,

[1]) Merretë vesh, lesh a pëlhure. [2]) Dru akaqie.

15 që të mbaretë arka me ata. Shuletë dotë jenë
ndë rrethkat të arkësë; nukë dotë hiqenë
16 nga ajo. Edhe dotë vësh nd' arkët dëshmim-
në që dotë të ap ty.
17 Edhe dotë bënjç një çpërblimtore*) prej
ari të-kulluarë; dy kut e gjysmë të-gjatë, e
një kut e gjysmë të-gjerë.
18 Edhe dotë bënjç dy qerubime prej ari;
të-rrahurë dot' i bënjç ata, mbë të dy anët'
19 e çpërblimtoresë. Edhe bëj një qerubim mbë
njërënë anë, e një qerubim mbë tjatërënë anë;
nga çpërblimtoreja dotë bënjç qerubimetë
20 mbë të dy anët' e asaj. Edhe qerubimetë
dotë ndenjënë krahët' e tyre përsipërë, dyke
mbuluarë çpërblimtorenë me krahët' e tyre;
edhe faqet' e atyreve dotë jenë kundruell
njëra tjatërësë; nga çpërblimtoreja dotë jenë
faqet' e qerubimevet.
21 Edhe dotë vësh çpërblimtorenë mbi ar-
kët përsipërë; edhe nd' arkët dotë vësh dësh-
22 mimnë që dotë t' ap ty. Edhe atje dotë pi-
qem me ty, edhe që përsipërë çpërblimtoresë,
nga mezi i të dy qerubimevet, që janë mbi
arkët të dëshmimit, dotë të flas ty për gjithë
sa dotë t'ap ty për porosi mbë të bijt' e
Israilit.
23 Edhe dotë bënjç një truvezë prej druje
shittimi; dy kut dotë jetë të-gjatët' e asaj, e
një kut te-gjerët' e asaj, e një kut e gjysmë

*) A: një të-mbuluarë.

24 të-lartët' e asaj. Edhe dot'a mbulonjç për-
qark me ar të-kulluarë, edhe dotë bënjç nd'
25 atë një kurorë t' artë përqark. Edhe dotë
bënjç nd' atë një buzë përqark një pëlëmbë
të-gjerë, edhe dotë bënjç ndë buzët t' asaj
26 një kurorë t' artë përqark. Edhe dotë bënjç
për atë katrë rrethka t' arta, edhe dotë vësh
rrethkatë ndë të katrë çipet që janë ndë të
27 katrë këmbët t' asaj. Ndënë buzët dotë jenë
të katrë rrethkatë për vënde të shulevet, që
28 të mbaretë truveza. Edhe shuletë dot' i bënjç
prej druje shitimi, edhe dot' i mbulonjç për-
qark me ar, që të mbaretë truveza me anë
29 t' atyreve. Edhe dotë bënjç dhisqet' e asaj, e
taset' e asaj, botilet' e asaj, e enët' e asaj, me
të-cilatë dotë bënenë të-spërkaturatë; prej
30 ari të-kulluarë dot' i bënjç ato. Edhe dotë
vësh mbi truvezët bukët' e parëvënjesë për-
para meje gjithënjë.
31 Edhe dotë bënjç një kandiler prej ari të-
kulluarë; dot'a bënjç kandilerinë të-rrahurë,
këmbën' e ati edhe trupin' e ati; lekanët' e
ati, sumbullat' e ati, edhe lulet' e ati të jenë
32 një trup me atë. Edhe dotë dalënë gjashtë
dega nga ijët' e atij; tri dega të kandilerit
nga njëra ijë, edhe tri dega të kandilerit nga
33 tjetëra ijë; Mbë njërënë degë dotë jenë tre
lekanë bërë si lule bajameje, një sumbullë e
një lule; edhe mbë degënë tjetërë tre lekanë
bërë si lule bajameje, një sumbullë e një

lule; kështu dotë bënjç për të gjashtë degatë
34 që dalënë nga kandileri. Edhe ndë kandilert
të jenë katrë lekanë bërë si lule bajameje,
sumbullat' e atyreve edhe lulet' e atyreve.
35 Edhe *të jetë* një sumbullë ndënë dy dega t'
ati, edhe një sumbullë ndënë dy dega t' atij,
edhe një sumbullë ndënë dy dega t' atij,
për të gjashtë degatë që dalënë nga kan-
36 dileri. Sumbullat' e atyreve, e degat' e aty-
reve, të jenë një trup me atë; e-tërë ajo *të-*
jetë një pun' e-rrahurë prej ari të-kulluarë.
37 Edhe dotë bënjç kandile t' ati shtatë; edhe
dotë ndizenë kandilet' e ati, që të ndrinjënë
38 përpara ati. Edhe gërshërët' e ati, edhe dhis-
qet' e shkrumbit të fitilevet t' ati, *të jenë* prej
39 ari të-kulluarë. Prej një tallandi ari të-kullu-
arë dotë ndërtonetë *kandileri*, edhe të-gjitha
40 këto enë. Edhe ki mëndjenë t' i bënjç pas
shëmbëllimit t' atyre që t' udëftue ndë malt.

Krye 26.

1 Edhe dotë bënjç tendënë *me* dhjetë kur-
tina prej liri të-hollë të-dredhurë, e prej të-
kaltëri, e prej të-porfyrti, e prej të-kuqi,
edhe dot' i bënjç ato me qerubime mjeshtë-
2 risht të-punuarë. Të-gjatët' e çdo kurtine do-
të jetë njëzet e tetë kut, edhe të-gjerët' e çdo
kurtine katrë kut; gjithë kurtinatë dotë kenë
3 gjithatë masë. Të pesë kurtinatë dotë jenë
bashkuarë njëra me tjetërënë mbë një; edhe

të pesë kurtinat' *e-tjera* dotë jenë bashkuarë
4 njëra me tjetërënë mbë një. Edhe dotë bënjç
mbërthecka prej të-kaltëri mb' anët të kurti-
nësë që është e fundit ndë pjesët të-parë; kë-
shtu dotë bënjç edhe mb' anët të kurtinësë që
5 është e-para ndë pjesët të-dytë. Pesë-dhjetë
mbërthecka dot' i bënjç njërësë kurtinë, edhe
pesë-dhjetë mbërthecka dotë bënjç mb' anët
të kurtinësë që është e-para ndë pjesët të-
dytë; mbërtheckatë dotë jenë kundruell njëra
6 tjetërësë. Edhe dotë bënjç pesë-dhjetë grep-
the të-artë, edhe me grepthetë dotë bash-
konjç kurtinatë njërënë me tjetërënë; edhe
kështu tenda dotë jetë një.
7 Edhe dotë bënjç kurtina prej *lesh* dhish,
për mbulesë mbi tendët; dotë bënjç një-mbë-
8 dhjetë të-këtilla kurtina. Të-gjatët' e çdo kur-
tine dotë jetë tri-dhjetë kut, edhe të-gjerët' e
çdo kurtine katrë kut; të një-mbë-dhjetë kur-
9 tinatë dotë kenë gjithatë masë. Edhe dotë
bashkonjç të pesë kurtinatë veç, edhe të
gjashtë kurtinatë veç; po të-gjashttënë kurti-
në dot' e palosç mbë dysh nga faqeja e ten-
10 dësë. Edhe dotë bënjç pesë-djetë mbërthe-
cka mb' anët të kurtinësë që është e fundit
ndë pjesët të-parë, edhe pesë-dhjetë mbër-
thecka mb' anët të kurtinësë që është e-para
11 ndë pjesët të-dytë. Dotë bënjç edhe pesë-
dhjetë grepthe të-ramtë, edhe grepthetë dot' i
shkonjç ndë mbërtheckat, edhe dotë bashkonjç

12 tendënë, që të jetë një. Edhe e-tepëra që te-
përon nga kurtinat' e tendësë, *do-me-thënë*
gjysma e kurtinësë që ka mbeturë dotë va-
13 retë prapa tendësë. Edhe kuti nga njëra ije,
edhe kuti nga tjetëra ije, që ka mbeturë për-
së-gjati nga kurtinat' e tendësë, dotë varetë
përsipërë mbi ijet të tendësë andej e këtej,
për të mbuluar' atë.
14 Edhe dotë bënjç mbulesë për tendënë prej
lëkurësh deshësh të-ngjyera të-kuqe, edhe
mbulesë përsipërë, prej lëkurësh delfinësh.
15 Edhe dotë bënjç për tendënë dhoga prej
druje shittimi, që të qëndronjënë drejt për-
16 pjetë. Dhjetë kut dotë jetë të-gjatët' e çdo
dhoge, edhe një kut e gjysmë të-gjerët' e çdo
17 dhoge. Dy dhëmbë dotë jenë mbë çdo dhogë
kundruell njëri tjatërit; kështu dotë bënjç
18 për gjithë dhogat' e tendësë. Edhe dotë bëjnç
dhogatë për tendënë, njëzet dhoga për anën'
19 e shiut nga mesdita. Edhe përposh të njëzet
dhogavet dotë bënjç dyzet shtresa t' ergjënta;
dy shtresa përposh njërësë dhogë për të dy
dhëmbët' e asaj, edhe dy shtresa përposh tje-
20 tërësë dhogë për të dy dhëmbët' e asaj. Edhe
për të-dytënë anë të tendësë, për atë nga
21 an' e borësë, dotë bënjç njëzet dhoga; Edhe
të dyzet shtresat' e-ergjëntta t' atyreve, dy
shtresa përposh njërësë dhogë, e dy shtrësa
22 përposh tjetërësë dhogë. Edhe për anën' e-
prapësme të tendësë, për atë nga të-perëndu-

23 arëtë, dotë bënjç gjashtë dhoga. Dotë bënjç
edhe dy dhoga për çipet' e tendësë nga an'
24 e-prapësme. Edhe dotë bashkonenë përposh,
edhe dotë bashkonenë bashkë përsipërë, me
një rreth; kështu dotë jetë për të dy; dotë
25 jenë për të dy çipetë. Edhe kështu dotë jenë
tetë dhoga, edhe shtresat' e atyre t' ergjëntta,
gjashtë-mbë-dhjetë shtresa; dy shtresa për-
posh njërësë dhogë, e dy shtresa përposh
tjetërësë dhogë.
26 Edhe dotë bënjç shule prej druje shitti-
mi; pesë për dhogat' e njërësë anë të tendësë,
27 Edhe pesë shule për dhogat' e tjetërësë anë
të tendësë, edhe pesë shule për dhogat' e
anës' së tendësë, për anën' e-prapësme nga
28 perëndimi. Edhe shuli i-mesm, që është ndë
mest të dhogavet, dotë shkonjë anë mb' anë.
29 Edhe dotë mbulonjç dhogatë përqark me ar,
edhe rrethkat' e atyre dot' i bënjç t' arta, *që
të jenë* vënde të shulevet; edhe dotë mbu-
lonjç shuletë përqark me ar.
30 Edhe dotë ngrehç tendënë pas formës' së
saj që t' udëftye ty ndë malt.
31 Edhe dotë bënjç kurtinë të-ndari prej të-
kaltëri e prej të-porfyrti, e prej të-kuqi, e
prej liri të-hollë të-dredhurë, me punë mje-
32 shtërie; dotë jet' e-bërë me qerubime. Edhe
dot'a varç atë mbi katrë shtylla prej shitti-
mi të-mbuluara përqark me ar; grepthet' e
atyre të jenë t' artë, mbë të katrë shtresat'

33 e-ergjëntta. Edhe dotë varç kurtinënë ndënë
grepthet, edhe dotë bjesh atje, përbrënda kur-
tinës' së të-ndarit, arkën' e dëshmimit; edhe
kurtina dotë jetë për ju një të-ndarë ndër
mest të shënjtëroresë e të shënjtërores' së
34 shënjtërorevet. Edhe dotë vësh çpërblimto-
renë mbi arkët të dëshmimit ndë shënjtëro-
ret të shënjtërorevet.
35 Edhe dotë vësh truvezënë përjashta kur-
tinësë, edhe kandilerinë kundruell truvezësë
nga an' e shiut të tendësë; edhe truvezënë
dot'a vësh nga an' e borësë.
36 Edhe për derën' e tendësë dotë bënjç kur-
tinë dere prej të-kaltëri, e prej të porfyrti, e
prej të-kuqi, e prej liri të-hollë të-dredhurë,
37 punuarë me të-qëndisurë. Edhe për kurtinën'
e derësë dotë bënjç pesë shtylla prej shitti-
mi, edhe dot' i mbulonjç ato përqark me ar;
Grepat' e atyreve të jenë t' artë; edhe dotë
derthç për ato pesë shtresa të-ramta.

Krye 27.

1 Edhe dotë bënjç therorenë prej druje shit-
timi, pesë kut të-gjatë, edhe pesë kut të-gje-
rë; theroreja dotë jetë me katrë çipe; edhe
2 të-lartët' e asaj dotë jetë tre kut. Edhe dotë
bënjç brirët' e asaj mbë të katrë çipet' e a-
saj; brirët' e asaj dotë jenë një trup me atë;
edhe dot'a mbulonjç atë për qark me ramë.
3 Edhe dotë bënjç enët' e asaj për të hequrë

hinë, edhe tërplotët'*) e asaj, edhe lekanët'e asaj, edhe sfurgjet' e asaj, për të zënë mishinë, edhe kacit' e asaj; gjithë enët' e asaj dot'
4 i bënjç të-ramta. Edhe dotë bënjç për atë një trirë të-ramtë të-punuarë si rrietë; edhe mbi rrietët dotë bënjç katrë rrethka të-ram-
5 ta mbë të katrë çipet' e asaj. Edhe dot'a vësh atë përposh ndënë rretht të theroresë, që të arrinjë rrieta përpjetë gjer ndë gjysmët të
6 theroresë. Edhe dotë bënjç shule për therorenë, shule prej druje shittimi, edhe dot' i
7 mbulonjç përqark me ramë. Edhe shuletë dotë shkonenë nde rrethkat, edhe shuletë dotë jenë mbë të dy brinjët' e theroresë, për të
8 mbajtur' atë. Dot'a bënjç atë gropë prej dhogash; sikundrë t' udëftye ndë malt, kështu dot'a bënjç.
9 Edhe dotë bënjç oborrin' e tendësë; për anën' e shiut nga mesdita të jenë për oborrinë kurtina prej liri të-hollë të-dredhurë, një
10 qint kut ndë të-gjatët për njërënë brinjë. Edhe shtyllat' e asaj të jenë njëzet, edhe shtresat' e atyre njëzet, prej rame; grepat' e shtyllavet edhe brezat' e atyreve të jenë prej er-
11 gjëndi. Gjithashtu edhe për brinjënë nga an' e borësë për-së-gjati *të jenë* kurtina, një qint kut ndë të-gjatët, edhe shtyllat' e asaj njëzet, edhe shtresat' e atyreve njëzet, prej rame; grepat' e shtyllavet edhe brezat' e atyreve të

*) Lopatatë.

jenë t' ergjënttë. Edhe për të-gjerët' e oborrit nga an' e perëndimit të jenë pesë-dhjetë kut kurtina; shtyllat' e atyre dhjetë, edhe shtresat' e atyre dhjetë. Edhe të-gjerët' e oborrit nga an' e lindjesë të jetë pesë-dhjetë kut. *Edhe* kurtinatë për njërënë anë *të derësë të jenë* pesë-mbë-dhjetë kut; shtyllat' e atyreve tri, edhe shtresat' e atyreve tri. Edhe për tjetërënë anë të jenë kurtina pesë-mbë-dhjetë kut; shtyllat' e atyreve tri, edhe shtresat' e atyreve tri. Edhe për derën' e oborrit të jetë një kurtinë njëzet kutsh, prej të-kaltëri, e prej të-porfyrti, e prej të-kuqi, e prej liri të-hollë të-dredhurë, me punë të-qëndisuri; shtyllat' e atyreve katrë, edhe shtresat' e atyreve katrë. Gjithë shtyllatë përqark oborrit të jenë ngjeshurë me ergjënt; grepat' e atyreve të jenë t' ergjënttë, edhe shtresat' e atyreve të-ramta. Të-gjatët' e oborrit dotë jetë një qint kut, edhe të-gjerëtë pesë-dhjetë kut mbë të dy anët, edhe të-lartëtë pesë kut, prej liri të-hollë të-dredhurë, edhe shtresat' e atyreve të-ramta. Gjithë enët' e tendësë për çdo shërbesë t' asaj, edhe gjithë hunjt' e asaj, edhe gjithë hunjt' e oborrit të jenë të-ramtë.

Edhe ti urdhëro të bijt' e Israilit të të sjellënë ty vaj të-kulluarë prej ullinjsh të-shtypurë për dritënë, që të digjetë kandilja përhere. Ndë tendët të përmbledhjesë përjashta kurtinësë, që është përpara dëshmimit,

Aaroni edhe të bijt' e ati dot'a radhitnjënë *që të ndritnjë* përpara Zotit që mbrëmanet e gjer ndë mëngjest; *kèjo dotë jetë* një nom i-përhershim për të bijt' e Israilit ndë brezat t' atyre.

Krye 28.

1 Edhe ti merr me vetëhe Aaroninë, t' ët vëlla, edhe të bijt' e ati bashkë me atë, nga mezi i të bijvet të Israilit, që të më bënjënë shërbesën' e priftërisë, Aaroninë, Nadabin' edhe Abihunë, Eleazarin' edhe Ithamarinë, të bijt' e Aaronit.

2 Edh t'i bënjç Aaronit, t' yt vëllaj, rroba
3 të-shënjtëruara, për lavdi e për bukuri. Edhe ti fol'-u gjithë të-mënçuret ndë zëmërët, të-cilëtë unë i kam mbushurë me frymë diturie, të bënjënë rrobat' e Aaronit, që t'a shënjtëronjç atë, që të më bënjë shërbesën' e priftërisë.

4 Edhe këto janë rrobatë që dotë bënjënë; një rrasë krahërori, edhe një efod, edhe një rrobë, edhe një rrobë *të-gjatë* të-qëndisurë, një mitrë, edhe një bres; edhe dotë bërjënë rroba të-shënjtëruara për Aaroninë, t'ët vëlla, edhe për të bijt' e ati, që të më bënjënë shërbesën' e priftërisë.

5 Edhe ata dotë marrënë arinë, e të-kaltëritë, e të-porfyrtëtë, e të-kuqtë, e lirin' e-hollë;
6 Edhe dotë bënjën' efodinë prej ari, *e* prej të-

kaltëri, e prej të-porfyrti, *e* prej të-kuqi, e prej liri të-hollë të-dredhurë, me punë mje-
7 shtërie. Dotë ketë të dy copat' e supevet të-ngjitura mbë të dy anët' e ti, që *kështu* të-
8 jetë i-bashkuarë. Edhe brezi i qëndisurë i efodit, që është mbi atë, për të ngjeshur' atë, dotë jetë si pun' e ati *edhe* prej gjithasaj gjëje; prej ari, prej të kaltëri, e prej të-porfyrti, *e* prej të-kuqi, e prej liri të-hollë të-dredhurë.

9 Edhe dotë marrç dy gurë të-thonjtë, edhe dotë gdhënjç mbi ata emërat' e të bijvet të-
10 Israilit; Gjashtë nga emërat' e atyre mbi njërinë gur, edhe të gjashtë emërat' e-tjerë mbi
11 tjatërinë gur, pas të-lindurit t' atyre; Me punë gur-gdhëndësi, pas të-gdhëndurit të vulës, dot' i gdhënjç të dy gurëtë, pas emëravet të bijvet të Israilit; dot' i vësh ata ndë shtëpiza
12 t' arta. Edhe dot' i vësh të dy gurëtë mbi copat të supevet t' efodit, *që të jenë* gurë kujtimi për të bijt' e Israilit; Edhe Aaroni ka për të mbartur' emërat' e atyreve përpara Zotit mbi të dy sypet' e ti për kujtim.

13 Edhe dotë bënjç shtëpiza t' arta; 14) Edhe dy varge prej ari të-kulluarë; posi kordhellë
14 dot' i bënjç ata, me punë të-gërshetuari; edhe dot' i ngjitç varyjet' e-gërshetuarë me shtëpizatë.

15 Edhe dotë bënjç rrasën' e krahërorit të gjyqit me punë mjeshtërie; dot' e bënjç atë

pas punës' s' efodit; prej ari, *e* prej të-kal-
tëri, e prej të-porfyrti, e prej të-kuqi, e prej
liri të-hollë të-dredhurë, dot' e bënjç atë;
16 Dotë jetë katrëçipëse *edhe* e-dymëzuarë; një
pëllëmbë dotë jetë të-gjatët' e asaj, edhe një
17 pëllëmbë të-gjerët' e asaj. Edhe dotë vësh nd'
atë gurë, katrë sërë gurësh; sëra e-parë *dotë*
ketë një sardi, një topaz, e një smaragdh; *kë-*
18 *shtu* dotë jetë sër' e-parë; Edhe sëra e-dytë,
19 një thëngjillës, një sapfir, e një diamant; Edhe
sëra e-tretë, një ligyr, një agat, e një ame-
20 thyst; Edhe sëra e-katrëtë, një berryl, e një
thua, e një jaspidhë; të jenë ngulurë ndër
21 ar ndë shtëpizat të tyrë. Edhe gurëtë dotë
jenë pas emëravet të bijvet të Israilit, dy-
mbë-dhjetë, pas emëravet t' atyre; *pas* të-
gërvishturit të vulësë, sicili me emërin' e ti,
dotë jenë për të dy-mbë-dhjetë faratë.
22 Edhe dotë bënjç mbi rrasën' e krahërorit
vargje posi kordhella, punë të-gërshetuari prej
23 ari të-kulluarë. Edhe dotë bënjç mbi rrasën'
e krahërorit dy rretka t' arta, edhe dotë vësh
të dy rrethkatë mbi të dy çipat' e rrasës' së
24 krahërorit. Edhe dotë shkonjç të dy *vargjet'*
e-artë të-gërshetuarë ndë të dy rrethkat që
25 janë ndë çipat të rrasës' së krahërorit. Edhe
të dy anët' *e-tjera* e të dy *vargjevet* të-gër-
shetuarë dot' i bashkonjç me të dy shtëpi-
zatë, edhe dot' i vësh ndë copat të supevet
26 t' efodit përpara ati. Edhe dotë bënjç dy reth-

ka t' arta, edhe dot' i vësh mbë të dy çipat' *e-tjerë* të rrasës' së krahërorit ndë buzët t' asaj, që është përbrënda nga an' e efodit.
27 Edhe dotë bënjç dy rrethka t' arta, edhe dot' i vësh mbë të dy ijët t' efodit përposh, ndë anët të-përparshime t' ati, përanë të-bashkuarit t' ati, përmbi brezin' e-endurë mjeshtë-
28 risht të efodit. Edhe dotë lithnjënë rrasën' e krahërorit me anë të rrethkavet të saj ndër rrethkat t' efodit me oviskë të-kaltërë, që të jetë përsipërë brezit të-endurë mjeshtërisht t' efodit, edhe që të mos jetë e-ndarë rrasa
29 e krahërorit nga efodi. Edhe Aaroni ka për të mbarturë emërat' e të bijvet të Israilit ndë rrasët të krahërorit të gjyqit mbi zëmërët të ti, kur të hynjë ndë shënjtëroret, për kujtim përpara Zotit përherë.
30 Edhe dotë vësh ndë rrasët të krahërorit të gjyqit Urimet' e Thummimetë*); edhe dotë jenë mbi zëmërët të Aaronit, kur të hynjë përpara Zotit; edhe Aaroni ka për të mbarturë gjyqin' e të bijvet të Israilit mbi zëmërët të ti përherë përpara Zotit.
31 Edhe dotë bënjç rrobën' e efodit të-tërë
32 prej të-kaltëri. Edhe dotë ketë për *të-hyrët'* e kokësë grykë ndë mest t' asaj; dotë ketë oviskë të-endurë përqark grykës' së saj, sikundrë është gryka e thurakësë, që të mos
33 çiretë. Edhe dotë bënjç mbi pëqinjt t' asaj

*) Dritat' e të-mbaruaratë.

shegë të-kaltëra, e të-porfyrta, e të-kuqe, mbi pëqinjt t' asaj rrotullë; edhe këmborëza
34 ndër mest t' atyreve përqark; Këmborëzë t' artë edhe shegë, këmborëzë t' artë edhe she-
35 gë, mbi pëqinjt të rrobësë përqark. Edhe dotë jetë mbi Aaroninë për të bërë punën' e lutjesë; edhe zëri i ati dotë dëgjonetë, kur të hynjë *ay* ndë shënjtëroret përpara Zotit, edhe kur të dalë, që të mos vdesë.

36 Edhe dotë bënjç një petullë prej ari të-kulluarë, edhe dotë gërvisht mbi atë, posi të-gërvishtur' unaze, **Shënjtërim te Zoti.**
37 Edhe dot' e vësh atë mbi oviskë të-kaltërë, edhe dotë jetë mbi mitrët, dotë jetë mbi
38 anët të-përparshime të mitrësë. Edhe dotë jetë mbi ballët të Aaronit, që të mbanjë Aaroni panomin' e të-shënjtëruaravet gjërëra që dotë shënjtëronjënë të bijt' e Israilit ndë gjithë dhuratat të tyre të-shënjtëruara; edhe dotë jetë gjithënjë mbi ballët t' ati, që të jenë të-pritura përpara Zotit.

39 Edhe dotë entç me të-qëndisurë rrobën' *e-gjatë* prej liri të-hollë, edhe dotë bënjç një mitrë prej liri të-hollë, edhe dotë bënjç një bres me punë të-qëndisuri.

40 Edhe për të bijt' e Aaronit dotë bënjç rroba *të-gjata* edhe dotë bënjç breza për ata edhe dotë bënjç mitra të-vogëla për ata, për lav-
41 di e për bukuri. Edhe dotë veshç me ato Aaroninë, t' ët vëlla, edhe të bijt' e ati bashkë

me atë; edhe dotë lyenjç ata, edhe dotë
mbushç duart' e atyre, edhe dot' i shënjtëronjç
ata që të më shërbenjënjë ndë punët të prif-
42 tërisë. Edhe dot' u bënjç atyre brekë të-linjtë,
që të mbulonjënë të-sveshurit' e mishit të
tyre; dotë arrinjënë që nga mezi e gjer ndë
43 kofshët; Edhe dotë jenë mbi Aaroninë, e mbi
të bijt' e ati, kur të hynjënë ndë tendët të për-
mbledhjesë, a kur t' i afëronenë theroresë që
të shërbenjënë ndë shënjtëroret, që të mos
bjenë mbi vetëhe panoni, e të vdesënë. Këjo
dotë jetë nom i-përjetëshm tek ay edhe nde
farët t' ati pas ati.

Krye 29.

1 Edhe këjo është ajo punë që dot' u bënjç
atyre që t' i shënjtëronjç ata që të më shër-
benjënë ndë punët të priftërisë; merr një viç
edhe dy desh, të-cilëtë të mos kenë ndonjë
2 të-metë, Edhe bukë pa brumë, edhe kuleç pa
brumë të-ngjeshurë me vaj, edhe petulla pa
brumë të-lyera me vaj; dot' i bënjç ato prej
3 athere mjelli të-grunjtë. Edhe dot' i vësh ato
ndë një kanistrë, me viçin' e me të dy deshtë.
4 Edhe dotë shpjesh Aaroninë edhe të bijt'
e ati ndë derët të tendës' së përmbledhjesë,
5 edhe dot' i lanjç ata me ujë. Edhe dotë marrç
rrobatë, edhe dot' i veshç Aaronit rrobën' *e-*
gjatë edhe rrobën' e efodit, edhe efodinë, edhe
rrasën' e krahërorit, edhe dot' e ngjeshç me

6 brezin' e-endurë mjeshtërisht të efodit. Edhe
dotë vësh mitrënë mbi kryet t' ati, edhe dotë
7 vësh kurorën' e-shënjtëruarë mbi mitrët. Atë-
here dotë marrç vajin' e të-lyerit, edhe dotë
derthç *prej ati* mbi kryet t' ati, edhe dot' e
lyenjç atë,
8 Edhe dotë bjesh të bijt' e ati, edhe dot' u
9 veshç atyre rrobat' *e-gjata;* Edhe dot' i ngjeshç
ata me brezatë, *si* Aaronin' edhe të bijt' e ati,
edhe dot' u vësh atyre mitrat' e-vogëla, edhe
priftëria dotë jet' e atyre pas nomi të-përje-
tëshm; edhe dotë shënjtëronjç Aaronin' edhe
të bijt' e ati.
10 Edhe dotë bjesh viçinë përpara tendës'
së përmbledhjesë, edhe Aaroni edhe të bijt'
e ati dotë vënë duart' e tyre mbi kryet të
11 viçit. Edhe dotë therç viçinë përpara Zotit,
12 ndë derët të tendës' së përmbledhjesë. Edhe
dotë marrç nga gjaku i viçit, edhe dotë vësh
mbi brirët të theroresë me gishtinë t' ënt;
edhe dotë derthç gjithë gjakunë ndë rrëzët
13 të theroresë. Edhe dotë marrç gjithë dhja-
mëtë që mbulon të-përbrëndëshmetë, edhe
këmishënë përsipërë mëlçis' së-zezë, edhe të
dy veshnjatë, edhe dhjamëtë që është mbi
14 ato, edhe dot' i djekç *ato* mbi theroret. Po
mishin' e viçit, edhe lëkurën' e ati, edhe baj-
gat' e ati dot' i djekç përjashta fushatësë; ky
është kurban për faj.
15 Edhe dotë marrç njërinë dash, edhe Aa-

roni edhe të bijt' e ati dotë vënë duart' e
16 tyre mbi kryet të dashit. Edhe dotë therç
dashinë, ëdhe dotë marrç gjakun' e ati, edhe
17 dotë spërkatç mbi theroret përqark. Edhe
dot'a bënjç dashinë copa copa, edhe dotë
lajsh të-përbrëndëshmet' e ati, edhe këmbët'
e ati, edhe dot' i vësh bashkë me copat' e
18 ati, e me kryet' e ati. Edhe dotë djekç gjithë
dashinë mbi theroret; ky është dhuratë e-
gjithëdjegurë mbë Zotinë; ësht' er' e-mirë,
kurban që bënetë me anë zjarri mbë Zotinë.
19 Edhe dotë marrç dashin' e-dytë; edhe Aa-
roni edhe të bijt' e ati dotë vënë duart' e tyre
20 mbi kryet të dashit. Atëhere dotë therç da-
shinë, edhe dotë marrç nga gjaku i ati, edhe
dotë vësh mbi lovidhet të veshit të-djathtë
të Aaronit, edhe mbi lovidhet të veshit të-
djathtë të bijvej t' ati, edhe mbi gishtt të-
math të dorës' së-djathtë t' atyreve, edhe mbi
gishtt të-math të këmbës' së-djathtë t' aty-
reve, edhe dotë spërkatç me gjak mbi the-
21 roret përqark. Edhe dotë marrç nga gjaku
që është mbi theroret, edhe nga vaji i të-
lyerit, edhe dotë spërkatç Aaroninë, edhe rro-
bat' e ati, edhe të bijt' e ati, edhe rrobat' e
të bijvet t' ati bashkë me atë; edhe dotë
shënjtëronenë, ay, edhe rrobat' e ati, edhe të
bijt' e ati, edhe rrobat' e të bijvet t' ati ba-
shkë me atë.
22 Edhe dotë marrç nga dashi dhjamët' edhe

bishtin' e dhjamurë, edhe dhjamëtë që mbulon të-përbrëndëshmetë, edhe këmishën' e mëlçis' së-zezë, edhe të dy veshnjatë, edhe dhjamëtë që është mbi ato, edhe shpatullën'
23 e-djathtë, (sepse është dash përhierimi); Edhe një bukë, edhe një kulaç buke të-lyerë me vaj, edhe një petullë nga kanistra e të-pa-
24 mbrumjevet që janë vënë përpara Zotit; Edhe dot' i vësh të-gjitha ndë duart të Aaronit, edhe ndë duart të bijvet t' ati; edhe dot' i lëkunç ato, *për* dhuratë të-lëkundurë përpara
25 Zotit. Edhe dotë marrç ato nga duart' e atyre, edhe dot' i djekç ato mbi theroret përsipërë dhuratës' së-gjithëdjegurë, për erë tëmirë përpara Zotit; ky është kurban që bënete me anë zjarri mbë Zotinë.
26 Edhe dotë marrç krahërorin' e dashit të përhierimit, që është për Aaroninë, edhe dot' e lëkunç atë *për* dhuratë të-lëkundurë përpara Zotit, edhe dotë jetë pjesa jote.
27 Edhe dotë shënjtëronjç krahërorin' e dhuratës' së-lëkundurë, edhe shpatullën' e dhuratës' së lartimit, e-cila ulëkunt, edhe e-cila ulartua, nga dashi i përhierimit, nga ay që është për Aaroninë, edhe nga ay që është
28 për të bijt' e ati; Edhe dotë jet' e Aaronit edhe e të bijvet t' ati si një detyr' e-përjetëshme prej të bijvet të Israilit; sepse është dhuratë lartimi; edhe dotë jetë dhuratë lartimi prej të bijvet të Israilit nga kurbanët'e

dhuratavet t' atyre për paqtimit, po, dhurata e atyre e-lartuarë mbë Zotinë.

29 Edhe rrobat' e-shënjtëruara të Aaronit dotë jenë të të bijvet t' ati pas ati, që të lyhenë
30 nd' ato, edhe të përhieronenë nd' ato. Shtatë dit dot' i veshnjë biri që dotë jetë prift ndë këmbët t' ati, kur hyn ndë tendët të përmbledhjesë për të bërë punën' e lutjesë ndë shënj-
31 tëroret. Edhe dotë marrë dashin' e përhierimit, edhe dotë zjenjë mishin' e ati ndë një
32 vënt të-shënjtëruarë. Edhe Aaroni edhe të bijt' e ati dotë hanë mishin' e dashit, edhe bukënë që është ndë kanistrët përanë derës'
33 së tendës' së përmbledhjesë. Edhe dotë hanë ato gjërëra, me të-cilatë ubë çpërblim për përhierim e shënjtërim t' atyreve; po i-huaj nukë dotë hajë *nga ato*, sepse janë gjërëra
34 të-shënjtëruara. Edhe ndë mbettë gjë nga mishi i përhierimit, a nga buka, gjer ndë mëngjest, atëherë dotë djekç atë që të mbesë ndë zjar; nukë dotë hahetë, sepse është gjë e-shënjtëruarë.

35 Edhe kështu dot' i bënjç Aaronit edhe të bijvet t' ati, pas gjith' atyreve që të urdhëro-
36 va; shtatë dit dot' i përhieronjç ata; Edhe përdita dotë bjesh viçin' e dhuratësë për faj, për çpërblim. Edhe dot'a qëronjç therorenë, dyke bërë çpërblim për atë; edhe dot' e lyënjç
37 atë, që t'e shënjtëronjç. Shtatë dit dotë bënjç çpërblim për therorenë, edhe dot'a shënjtë-

ronjç; edhe dotë jetë therore fort e-shënjtëruarë; çdo gjë që t' i pjekë theroresë dotë jet' e-shënjtëruarë.

38 Edhe këjo ësht' ajo që ke për të prurë mbi theroret, dy shqera motakë çdo ditë, gji-
39 thënjë; Njërinë qënq dot' e bjesh ndë mëngjest; edhe tjetërinë qënq dot' e bjesh ndë
40 zëmërë-herët; Edhe bashkë me qëngjinë një të-dhjetëtë *të efahut* atherë mjelli të-ngjeshurë me një të-katrëtë të hinit vaj të-shtypurë, edhe një të-katërtë të hinit verë për të
41 spërkaturë; Edhe qëngjin' e-dytë dot' e bjesh ndë zëmërë-herët; pas dhuratës' së mëngjezit prej buke, edhe pas të-spërkaturit t' asaj dota bënjç atë, për erë të-mirë, *për* dhuratë bërë me anë zjarri mbë Zotinë.

42 Këjo dotë jetë dhuratë e-gjithëdjegurë nga hera ndër brezat t' uaj, ndë derët të tendës' së përmbledhjesë, përpara Zotit; ku dot' u
43 dukem juve, që të flas me ty atjë. Edhe atje dotë dukem ndër të bijt' e Israilit; edhe *Ten-*
44 *da* dotë shënjtëronetë me lavdinë t' ime. Edhe dotë shënjtëronj tendën' e përmbledhjesë, edhe therorenë; dotë shënjtëronj edhe Aaroninë edhe të bijt' e ati, që të më bënjënë shërbe-
45 sën' e priftërisë. Edhe dotë rri ndë mest të bijvet të Israilit, edhe dotë jem Perëndia i
46 atyreve. Edhe dotë njohënë se unë jam Zoti, Perëndia i atyreve, që i nxora nga dheu i Egjyptësë, që të rri ndë mest t' atyreve; unë jam Zoti, Perëndia i atyreve.

Krye 30.

1 Edhe dotë bënjç një therore që të djekç
thimiamë mbi atë; prej druje shitimi dot'a
2 bënjç atë. Një kut dotë jetë të-gjatët' e asaj,
edhe një kut të-gjerët' e asaj; dotë jetë me
katrë çipe, edhe dy kut dotë jetë të-lartët'
e asaj; brirët' e asaj dotë jenë një trup me
3 atë. Edhe t'a mbulonjç përqark me ar të-ku-
lluarë, të-sipërmen' e asaj, e ijët' e asaj për-
qark, e brirët' e asaj; edhe t'i bënjç asaj një
4 kurorë t' artë përqark. Edhe t' i bënjç asaj
dy rethka t' arta ndënë kurorët t' asaj; t'i
bënjç ato afërë të dy çipevet t' asaj mbë të
dy ijët t' asaj; edhe dotë jenë vënde për shu-
5 letë me të-cilëtë dot'a mbanjënë. Edhe shu-
letë t'i bënjç prej druje shittimi, edhe t' i
6 mbulonjç përqark me ar. Edhe të vesh atë
përpara tendës' së dëshmimit, kundruell çpër-
blimtoresë që është mbi dëshmimnë, atje ku
dotë piqem me tynë.

7 Edhe Aaroni dotë djegë mbi atë thimiamë
erërash të-mira; çdo mëngjes, kur të bënjë
8 gati kandiletë, dotë djegë *thimiamë*. Edhe Aa-
roni, kur të ndesnjë kandiletë mbrëmanet,
dotë djegë thimiamë gjithënjë përpara Zotit
9 ndër brezat t'uaj. Nukë dotë bini thimiamë
të-huaj mbi atë, as dhuratë të-gjithëdjegurë,
as dhurata të-ngrënash; as mos derthç mbi
atë dhurata të-pirash.

10 Edhe Aaroni dotë bënjë çpërblim mbi
brirët t' asaj një herë ndë vitt, me gjakun' e
dhuratës' së çpërblimit për faj; një herë ndë
vitt dotë bënjë çpërblim mbi atë ndër brezat
t' uaj; këjo është fort e-shënjtëruarë te Zoti.
11 Edhe Zoti i foli Moisiut, e tha, 12) Kur të
marrç numërin' e-tërë *të emëravet* të bijvet
të Israilit, sipas atyre që numëronenë prej a-
tyreve, atëhere çdo njeri t' i apë Zotit çkëm-
besë për shpirtin' e ti, kur t' i numëronjç ata,
që të mos vinjë ndonjë plagë mbi ata, kur
13 t' i numëronjç ata. Këtë dotë apënë; çdo njeri
që shkon ndër të-numëruarët, gjysmë shekëlle
pas shekëllës' së shënjtëroresë; (shekëlla është
njëzet gjerahë;) gjysmë shekëlle *dotë jetë* dhu-
14 ratë për Zotinë. Gjithëkush që shkon ndër
të-numëruarët, që nga njëzet vjet e lart ndë
15 moshët, dotë apë dhuratën' e Zotit. I-pasuri
nukë dotë apë më tepërë, edhe i-vobegu nukë
dotë apë më pak se gjysmë shekëlle, kur të
apënë dhuratën' e Zotit, që të bënjënë çpër-
blim për shpirtëratë t' uaj.
16 Edhe dotë marrç ergjëndin' e çpërblimit
nga të bijt' e Israilit, edhe dot'a përndorç atë
për shërbesën' e tendës' së përmbledhjesë, që
të jetë një kujtim për të bijt' e Israilit për-
para Zotit, që të bënetë çpërblim për shpir-
tëratë t' uaj.
17 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
18 Edhe të bënjç një lanjëtore të-ramtë, edhe *të*

bënjç shtresën' e asaj të-ramtë, që të lahenë nd' atë; edhe t'a vësh atë ndër mest të tendës' së përmbledhjesë e të theroresë, edhe të
19 vësh ujë nd' atë. Edhe Aaroni edhe të bijt' e ati dotë lanjënë duart' e tyre e këmbët' e tyre
20 prej asaj; Kur të hynjënë ndë tendët të përmbledhjesë, të lahenë me ujë, që të mos vdesënë; a kur t'i afëronenë theroresë për të shërbyerë, që të djegënë dhuratë që bënetë
21 me anë zjarri mbë Zotinë. Kështu të lanjënë duart' e tyre e këmbët' e tyre, që të mos vdesënë; edhe ky dotë jetë një nom i-përhershim ndër ata, tek ay edhe ndë farët t' ati ndër brezat t' atyre.

22 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
23 Edhe ti merr nga më të-miratë erëra, pesë qint *shekëlla* smyrnë të-kulluarë, edhe qinanom me erë sa gjysmën' e asaj, dy qint e pesëdhjetë *skekëlla*, edhe kallam me erë dy qint
24 e pesë-dhjetë *shekëlla*, Edhe pesë qint *shekëlla* kassi, pas shekëllës' së shënjtëroresë, edhe një
25 hin vaj ulliri; Edhe dot' e bënjç atë vaj të-shënjtëruarë për të lyerë, një erë pas mjeshtëris' s' ati që bën erëra; dotë jetë vaj i-shënjtëruarë për të lyerë.

26 Edhe të lyenjç me atë tendën' e përmble-
27 dhjesë, edhe arkën' e dëshmimit, Edhe truvezën' edhe gjithë enët' e asaj, edhe kandilerin' edhe enët' e ati, edhe theroren' e thimia-
28 mësë, Edhe theroren' e dhuratës' së-gjithëdje-

gurë me gjithë enët' e saj, edhe lanjëtoren'
29 edhe shtresën' e asaj. Edhe t' i shënjtëronjç
ato, që të jenë fort të-shënjtëruara; çdo gjë
që u mbështetet' atyre dotë jet' e-shënjtëru-
30 arë. Edhe të lyenjç Aaronin' edhe të bijt' e
ati, edhe t' i shënjtëronjç ata, që të më shër-
benjënë ndë punët të priftërisë.
31 Edhe t' u flasç të bijvet të Israilit, e t' u
thuash, Ky dotë jetë tek unë vaj i-shënjtë-
32 ruarë për të lyerë ndër brezat t' uaj. Mbi
mish njeriu të mos derdhetë, as të mos bë-
ni *tjetërë* posi atë, sipas të-përzjerit t' ati;
ky është i-shënjtëruarë, edhe dotë jetë i-
33 shënjtëruarë ndër ju. Kush të ndërtonjë *vaj*
posi atë, a kush të vërë prej ati mbi të-huaj,
ay dotë shuhetë nga gjindja e ati.
34 Edhe Zoti i tha Moisiut, Merr erëra të-
mira, të-pikuarë erërash, e thua, e halbanë,
këto erëra të-mira bashkë me livan të-kthje-
llëtë; prej gjithësicilësë *nga këto* dotë ketë
35 pjesë si-një-një nga të-rënditë; Edhe t' i bënjç
thimiamë, të-përzjerë pas mjeshtëris' s' ati që
bën erëra të-mira, të-kripurë me kripë të-
36 qëruarë *e* të-shënjtëruarë; Edhe dotë shtypç
ca nga këjo shumë të-imëtë, edhe dotë vësh
nga këjo përpara dëshmimit ndë tendët të
përmbledhjesë, atje ku dotë piqem me ty;
këjo dotë jetë fort e-shënjtëruarë ndër ju.
37 Edhe sipas të-përzjerit të kësaj thimiame që
dotë bënjç, ju të mos bëni për vetëhenë t' uaj;

38 dotë jet' e-shënjtëruarë te ti për Zotinë. Kush
të bënjë *tjatërë* posi atë, që t'i marrë erë,
dotë shuhetë nga gjindja e ti.

Krye 31.

1 Edhe Zoti i foli Moisiut, e i tha, 2) Shih,
unë thirra më emër Bezaleilinë, të birin' e
3 Hurit, nga fara e Judësë; Edhe e mbusha atë
me frymën' e Perëndisë, ndë urtësi, e ndë ku-
pëtim, e ndë dituri, e ndë çdo farë mjeshtë-
4 rie, Që të nxjerrë nga mëndja punë mjesh-
tërie, që të punonjë ar, e ergjënt, e ramë,
5 E të gërvishtnjë gurë për të vënë, e të gdhënt-
një dru, për punë çdo farë mjeshtërie.
6 Edhe na unë tek i dhashë ati Oholiabinë,
të birin' e Ahisamahut, nga fara e Danit; edhe
ndë zëmërët të gjithë njerësvet të-urtë vura
dituri, që të muntnjënë të bënjënë gjithë sa
7 të urdhërova ty; Tendën' e përmbledhjesë,
e arkën' e dëshmimit, e çpërblimtorenë që
është përsipër' asaj, edhe gjithë enët' e Ten-
8 dësë; E truvezën' e enët' e asaj, e kandilerin' e-
kulluarë bashkë me gjithë enët' e atij, e the-
9 roren' e thimiamësë; E theroren' e dhuratës'
së-gjithëdhjegurë bashkë me gjith' enët' e asaj,
10 e lanjëtoren' e shtresën' e asaj; E rrobat' e
punës' së lutjesë, e të-shënjtëruaratë rroba të
Aaronit, priftit, e rrobat' e të bijvet' t' ati, që
11 të shërbenjënë ndë punët të priftërisë; E va-
jinë për të lyerë, edhe thimiamënë me erëra

për shënjtërorenë; dot' i bënjënë të-gjitha si-
kundrë të urdhërova.
12 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
13 Edhe ti fol'-u të bijvet të Israilit, e thuaj,
Pa fjalë të ruani sabbatat' e mia; sepse këjo
është një shënjë ndër mest meje edhe jush
ndër brezat t' uaj, qe të njihni, se unë jam
14 Zoti, që u shënjtëronj juve. Ruani pra sab-
batënë; sepse është e-shënjtëruarë ndër ju;
kush të ndyrnjë atë, pa fjalë të vritetë; sepsë
cilido që të bënjë ndonjë punë atë *ditë*, ay
shpirt dotë shuhetë nga mezi i gjindjes' së
15 tij. Gjashtë dit të bënetë punë; po të-shtat-
tënë ditë është sabbatë, prëhje e-shënjtëru-
arë mbë Zotinë; kush të bënjë ndonjë punë
16 ditën' e sabbatësë, pa fjalë të vritetë. Të bijt'
e Israilit pra dot' e ruanjënë sabbatënë, që
t' e kremtëronjën' atë ndër *gjithë* brezat të
7 tyre, për dhiatë të-përjetëshme. Këjo është
një shënjë ndër mest meje edhe të bijvet të
Israilit për gjithënjë; sepse mbë gjashtë dit
Zoti bëri qiellin' e dhenë, edhe të shtattënë
ditë pushoj edhe uprëjt.
18 Edhe passi mbaroj dyke folurë me atë
ndë malt të Sinajt, i dha Moisiut të dy rra-
sat' e dëshmimit, rrasa të-gurta, të-shkruara
me gjishtin' e Perëndisë.

Krye 32.

1 Edhe gjindja kur pa se Moisiu mënoj të
:briste nga mali, gjindja umbloth te Aaroni,

edhe i thoshin' ati, Ngreu, *e* na bëj perëndira, që të shkonjënë përpara nesh; sepse ky Moisiu, njeriu që na nxori nga dheu i Egjyptësë, nukë dimë se ç' ubë.

2 Edhe Aaroni u tha atyre, Hiqni vëthët' e-artë që kanë ndër veshët gratë t' uaj, *e* bijtë
3 t' uaj, e bijatë t' uaj, edhe bir-m' i-ni. Edhe gjithë gjindja hoqnë vëthët' e-artë, që kishi-
4 në ndër veshët, e j'a prunë Aaronit. Edhe ay u'a mori nga duartë, edhe e ndërtoj atë me hekurishte që gërvisht, edhe e bëri një viç të-derdhurë; edhe ata thanë, Këta janë perëndirat' e tu, o Israil, të-cilëtë të nxuarrë nga dheu i Egjyptësë.

5 Edhe Aaroni kur pa *këtë*, ndërtoj një therore përpara ati; edhe Aaroni lëçiti e tha,
6 Nesërë dotë jet' e-kremte mbë Zotinë. Edhe ata ungritnë çpejt ndë mërgjest, edhe prunë dhurata të-gjithëdjegura, e prunë dhurata paqtimi; edhe gjindja ndënji të hante e të pinte; pastaj ungritnë to losinë.

7 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko, *e* sbrit; sepse gjindja jote që nxore uga dheu i E-
8 gjyptësë uprishnë; Sa-kaqë-herash dualnë jashtë nga udha që u urdhërova atyreve; bënë për vetëhen' e tyre një viç të-derdhurë, edhe i ufalnë, e i bënë kurban, e thanë, Këta janë perëndirat' e tu, o Israil, që të nxuarrë nga dheu i Egjyptësë.

9 Edhe Zoti i tha Moisiut, E pashë këtë

gjindje, edhe na tek është një gjindje kokë-
10 trashë; Tashi pra lërë-më vetëmë, që të ndizetë zëmërimi im kundrë atyreve, edhe t' i prish ata; edhe dotë të bënj ty një komtë-math.
11 Edhe Moisiu i ulut Zotit, Perëndis' së ti, e tha, O Zot, përse ndizetë zëmërimi yt kundrë gjindjesë s' ate, të-cilën' e nxore nga dheu i Egjyptësë me fuqi të-madhe, e me dorë të-
12 fortë? Përse të thonë Egjyptianëtë, dyke thënë, I nxori ata për të-keqe, që t' i vrasë ndëpër malet, e t' i shuanjë nga faqeja e dheut; kthehu nga të-ndezurit' e zëmërimit t'ënt, edhe pendohu për të-keqenë *që the të bënjç* kun-
13 drë gjindjesë s' ate. Kujto Abraaminë, Isaakunë, e Israilinë, shërbëtoret' e tu, të-cilëvet u bëre be mbë vetëhenë t' ënde, e u the atyre, Dotë shumonj farënë t' uaj posi yjt' e qiellit, edhe gjithë këtë dhe, për të-cilënë fola, dot' j'a ap farësë s' uaj, edhe dot' e trashëgonjënë
14 atë për gjithë jetënë. Edhe Zoti upendua për të-keqenë, që tha se dot' i bënte gjindjes' së ti.
15 Edhe Moisiu ukthye, e sbriti nga mali, me të dy rrasat' e dëshmimit ndë duart të ti; rrasa që ishinë të-shkruara mbë të dy anëtë; ishinë shkruarë mbë njërën' anë e mbë tje-
16 trënë. Edhe rrasat' ishinë punë Perëndie, edhe të-shkruarëtë ishte të-shkruarë Perëndie, gërvishturë mbi rrasat.
17 Edhe Joshuaj, kur dëgjoj zën' e gjiddjesë-

tek po klithninë, i tha Moisiut, Zë lufte është
18 ndë fushatët. Edhe ay tha, Nuk' është zë a-
sish që brohorinjënë kur fitonjënë, as a-
sish që këlthasënë kur thyhenë; unë po dë-
gjonj zë asish që këndonjënë.
19 Edhe posa uafërua ndë fushatët, pa vi-
çinë, edhe valletë; edhe Moisiut i undes zë-
mërimi, edhe hodhi rrasatë nga duart' e tia,
20 edhe i theu ato ndënë malt. Edhe mori vi-
çinë që kishinë bërë, edhe e dogji ndë zjarr,
edhe si e thërrmoj gjersa ubë *pluhur* i-imetë,
e hodhi ndë ujët, edhe u'a dha të bijvet të
Israillt t'a pininë.
21 Edhe Moisiu i tha Aarorit, Ç' të bëri këjo
gjindje, kaqë sa prure mbi ata faj të-math?
22 Edhe Aaroni tha, Letë mos ndizetë zëmërimi
i t'im zot; ti e njeh këtë gjindje, se vais
23 ndë të-keqet; Sepse më thanë, Bën-na perën-
dira, të-cilëtë te shkonjënë përpara nesh;
sepse ky Moisiu, njeriu që na nxori nga
24 dheu i Egjyptësë, nukë dimë se ç' ubë. Edhe
un' u thashë atyre, Kush të ketë ar, let' e
heqënë; edhe ata m'a dhanë; edhe un' e
hodha ndë zjarrt, edhe dolli ky viç.
25 Edhe Moisiu kur pa gjindjenë se ishte pa
fre, (sepse Aaroni e kishte lënë pa fre, për
26 turpëri ndër mest të armiqvet t' atyre,) Moisiu
qëndroj ndë derët të fushatësë, e tha, Kush
të jetë nga an' e Zotit, *letë vinjë* me mua.
Edhe gjithë të bijt' e Leviut umblothnë nga

27 ana e ati. Edhe ay u tha atyre, Kështu thotë
Zoti, Perëndia i Israilit, Gjithësicili prej jush
letë vërë kordhën' e ti mbi kofshët të ti, edhe
shkoni e dilni derë mbë derë ndëpër gjithë
fushatënë, edhe gjithësicili letë vrasë të vë-
llan' e ti, e gjithësicili shokun' e ti, e gjithë-
28 sicili të-afërmin' e ti. Edhe të bijt' e Leviut
bënë pas fjalës' së Moisiut; edhe ranë nga
29 gjindja atë ditë sindonja tri mijë burra. Edhe
Moisiu tha, Mbushni duartë t' uaj sot për
Zotinë*), po, çdo njeri kundrë të birit të ti,
e kundrë të vëllat të ti, që t' u epetë juve
bekim sot.

30 Edhe mbë të-nesërmet Moisiu i tha gjin-
djesë, Ju fëjyetë një faj të-math; edhe tashi
dotë hipënj te Zoti; mbase mos e sbut për
fajinë t' uaj.

31 Edhe Moisiu ukthye te Zoti, e tha, Mjerë!
këjo gjindje fëjeu një faj të-math, edhe bënë
32 për vetëhen' e tyre perëndira t' artë. Po tashi
ndë u ndjefsh atyre fajnë,... po ndë mos,
të lutem, shuaj-më nga ajo vivlia jote, që
shkrove.

33 Edhe Zoti i tha Moisiut, Kush fëjeu kun-
drë meje, këtë dot' e shuanj nga vivlia ime.
34 Andaj tashi shko, hiq-i udhënë gjindjesë *ndë
atë vënt*, për të-cilinë të fola ty; na ëngjëlli
im tek po shkon përpara teje; po ndë ditët
të çpagimit t'im dot'a çgaguanj fajinë mbi ata.

*) A, Përhieroni sot vetëhenë t' uaj te Zoti.

35 Edhe Zoti i ra gjindjesë për ndërtesën' e viçit që bëri Aaroni.

Krye 33.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shko, hipë së këtejmi, ti edhe gjindja që nxore nga dheu i Egjyptësë, nd' *atë* dhe që i bëra be Abraamit, Isaakut e Jakobit, dyke thënë, Farësë s'
2 ate dot' j'a ap atë; Edhe dotë dërgonj një ëngjëll përpara teje, edhe dotë dëbonj Hanaanitin' e Amoritin' e Hittitin' *e* Ferizzitin' *e* Hi-
3 vitin' e Jebusitinë; *Edhe dot' u shpje* ndë një dhe që rrjeth qumësht e mjaltë; sepse unë nukë dotë ngjitem bashkë me ty, (sepse je një gjindje kokë-trashë,) që të mos të shuanj mb' udhët.
4 Edhe gjindja kur dëgjoj këtë fjalë të-ke-
qe, mbajtnë zi, edhe asndonjë nukë vuri sto-
5 lit' e ti mbi vetëhet të ti. Sepse Zoti i tha Moisiut, Thuaj-u të bijvet të Israilit, Ju jeni një gjindje kokë-trashë; për një të-fillme ndë arça ndë mest teje, dotë të shuanj; përandaj tashi svish stolit' e tua prej teje që të
6 njoh se ç' kam për të bërë ty. Edhe të bijt' e Israilit sveshnë stolit' e tyre, që afërë malit të Horibit.
7 Edhe Moisiu mori tendënë, edhe e nguli jashtë fushatësë, lark ushtërisë; edhe e quajti atë Tendë të përmbledhjesë. Edhe kushdo që kërkonte Zotinë dilte jashtë ndë Ten-

dët të përmbledhjesë, që ishte jashtë fusha-
8 tësë. Edhe kur dilte Moisiu ndë Tendët, gjithë gjindja ngrihej e rrinte *mbë këmbë, edhe* gjithësicili qëndronte ndë derët të tendës' së ti, edhe shikonte pas Moisiut, gjersa hynte ndë Tendët.
9 Edhe posa hynte Moisiu ndë Tendët, shtylla e resë sbriste, edhe qëndronte ndë derët
10 të Tendësë; edhe *Zoti* fliste me Moisinë. Edhe gjithë gjindja shihte shtyllën' e resë që qëndronte ndë derët të Tendësë; edhe gjithë gjindja ngrihej mbë këmbë e falej, çdo njeri
11 ndë tendët të ti. Edhe Zoti i fliste Moisiut faqe për faqe, posi një njeri kur flet me mikun' e ti. Edhe kthenej përsëri ndë fushatët; po një djalosh, shërbëtori i ati, Joshuaj i bir' i Naviut, nukë ndahej nga Tenda.
12 Edhe Moisiu i tha Zotit, Shih, ti më thua, Hipe këtë gjindje; edhe ti nukë më dëfteve cilinë dotë dërgonjç bashkë me mua. Edhe ti the, Ty të njoh mb' emër, edhe hir gjete për-
13 para meje. Tashi pra, ndë kam gjeturë hir përpara teje, të lutem, dëfte-më udhët' e tua, që të të njoh ty, që të gjenj hir përpara teje; edhe shih se ky komp është gjindja jote.
14 Edhe *Zoti* tha, Faqeja ime dotë vinjë *bashkë me ty*, edhe dotë t' ap të-prëjturë.
15 Edhe ay i tha ati, Ndë mos arthtë faqeja jote *bashkë me mua*, mos na ngre së-këtej-
16 mi. Sepse qysh dotë njihetë thashi se kam

gjeturë hir përpara teje, un' edhe gjindja jote? nukë nga të-ardhuritë t' at bashkë me ne? kështu dotë jemi të-ndarë, un' edhe gjindja jote, nga gjithë gjindjetë që janë mbi qafet të dheut.

17 Edhe Zoti i tha Moisiut, Edhe këtë punë që the dot'a bënj; sepse gjete hir përpara meje, edhe të njoh mb' emër.

18 Edhe tha, Të lutem, dëfte-më lavdinë t' ënde.

19 Edhe *ay* tha, Unë dotë bënj të shkonjë përpara teje gjithë të-mirëtë t' im, edhe dotë lëçis emërin' e Zotit përpara teje, edhe dotë përdëllenj atë që përdëllenj, edhe dotë më,

20 dhëmbetë për atë që më dhëmbetë. Edhe *ay* tha, Nukë munt të shohç faqenë t' ime; sepse nukë dotë më shohë njeri, e të rronjë.

21 Edhe Zoti tha, Na tek është vënt përanë meje,

22 edhe dotë rrish mbi gurt; Edhe kur të shkonjë lavdia ime, dotë të vë ndë të-çarët të gurit, edhe dotë të mbulonj me dorënë t' ime

23 gersa të shkonj; Edhe dotë ngre dorënë t ime, edhe dotë shohç kurrizinë t' im; po faqeja ime nukë dotë shihetë.

Krye 34.

1 Edhe Zoti i tha Moisiut, Gdhënt dy rrasa të-gurta, posi të-paratë; edhe dotë skkruanj mbi rrasat fjalëtë që ishinë mbi rrasat

2 të-para, që theve. Edhe bënu gati ndë mën-

gjest, edhe hipë ndë mëngjest ndë malt të Sinajt, edhe dil atje përpara meje ndë majët
3 të malit. Edhe asndonjë të mos hipënjë bashkë me ty, as të duketë njeri ndëpër gjithë malinë; as dhëntë a lopëtë të kulosënë përpara ati mali.
4 Edhe gdhëndi dy rrasa të-gurta posi tëparatë; edhe Moisiu ungrit çpejt ndë mëngjest, e hipi lart ndë malt të Sinajt, sikundrë e urdhëroj Zoti, edhe mori të dy rrasat' e-gurta ndë duart të tia.
5 Edhe Zoti sbriti ndë ret, edhe qëndroj atje bashkë me atë, edhe lëçiti emërin' e Zo-
6 tit. Edhe Zoti shkoj përpara ati edhe lëçiti, Zoti, Zoti Perëndia, i-dhëmçuri e i-përdëllyershimi, zëmërë-gjeri e përdëllim-madhi e i-
7 vërteti, Që ruan përdëllim për mijëra, që ndjen panomi, e paudhëri, e faj, edhe fare nukë nxjer të-pafajm *fajtorinë;* që çpaguan paudhërin' e atërvet mbë djemt *t' atyre*, edhe mbë djemt të djemvet, *gjer* mbë të-tretin' edhe *gjer* mbë të-katrëtinë *bres.*
8 Edhe Moisiu çpejtoj, e unji kryet' e ti
9 përdhe, edhe ufal; Edhe tha, Tashi ndë kam gjeturë hir përpara teje, o Zot, letë vinjë, të lutem, Zoti ndër mest t' ënë; sepse këjo gjindje është kokë-trashë; edhe ndje panominë t' ënë edhe fajnë t' ënë, edhe merr-na ndë trashëgimt t' ënt.
10 Edhe tha, Na unë tek po bënj dhiatë;

përpara gjindjesë s' ate dotë bënj çudira, që s' janë bërë mbë gjithë dhenë, edhe as mbë ndonjë komp; edhe gjithë gjindja, ndë mest të së-cilësë je, dotë shohë punën' e Zotit; sepse është' e-frikshime ajo që dotë bënj bashkë me ty.

11 Ruaj atë që të urdhëronj ty unë sot; na unë tek dotë përzë që përpara teje Amoritin' e Hanaanitin' e Hittitin' e Ferizzitin' e Hivitin' e Jebusitinë.

12 Ruhu, semos lithç fjalë me vëndësit' e *ati* dheu, ndë të-cilët po vete, semos bënetë *kjo*
13 kurth ndër mest t' ënt; Po të prishç theroret' e atyreve, e të thyenjç idhujt' e atyreve, e të
14 rrëzosh Asherimet' e atyre*). Sepse s' ke për të luturë tjetërë perëndi; sepse Zoti, emëri i të-cilit është Zelitar, është Perëndi zelitar;
15 *Edhe* s' ke për të lidhurë fjalë me vëndësit' *e ati* dheu, semos, kur të knrvëronjënë prapa perëndivet të tyre, e t' u bënjënë kurban perëndivet të tyre, të gërshesë ndonjë, e hash
16 nga kurbanët' e ati. Edhe të mos marrç nga të bijat' e ati për bijt' e tu, semos, kur të bijat' e ati të kurvëronjënë prapa perëndivet të tyre, i bënjënë edhe bijt' e tu të kurvëronjënë prapa perëndivet t' atyre.

17 Mos bënjç për vetëhenë t' ënde perëndira të-derdhurë.

*) Një farë shtyllash prej druri të-përhieruara te perëndesha Asherahë, e-cila është mbase ajo që thuhetë Astaroth.

18 Të ruanjç të-kremten' e të-pabrumjevet. Shtatë dit të hash bukë pa brumë, sikundrë të urdhërova, ndë kohët të-ndarë të muajt t' Abibit; sepse ndë muajt t' Abibit dolle nga Egjypta.

19 Çdo që hap shtratin' *e barkut* është imi, *si* edhe çdo mashkull i-parëlindurë ndër mest 20 të bagëtivet të tua, a ka, a dele. Edhe të-parëlindurin' e gomaresë t'a çpërblenjç me qënk; edhe ndë mos e çpërblefsh, atëhere 21 t' i presç kryetë. Të çpërblenjç gjithë të-parëlindurit' e bijvet të tu. Edhe asndonjë të mos duketë përpara meje *me duar të*-sbrazëta.

22 Edhe dotë ruanjç të-kremten' e javëvet, *do-me-thënë* të dorës' së-parë të të-korrit të drithit, edhe të-kremten' e të-mbledhurit të pronjavet ndë funtt të motit.

23 Thi herë ndë vitt dotë duketë çdo nga meshkujt' e tu përpara Zotit Perëndi, Perën-24 dis' së Israilit. Sepse passi të dëbonj kombetë përpara teje, edhe të sgjeronj sinorët' ë tu, asndonjë nukë dotë dëshëronjë dhenë t' ënt, kur të hipënjç që të dukesh përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, tri herë ndë vitt.

25 Nukë dotë bjesh gjakun' e kurbanit t' im me bukë të-mbrumë; as dhurata e së-kremtes' së pashkësë nukë dotë mbetetë gjer ndë mëngjest.

26 Të-parat' e pemëvet të-para të dheut t'

ënt dot' i bjesh ndë shtëpit të Zotit, Perëndisë t' ënt.

Nukë dotë zjesh kec ndë qumështit të s' ëmësë.

27 Edhe Zoti i tha Moisiut, Shkruaj këto fjalë; sepse pas këtyre fjalëve bëra dhiatë
28 me ty, edhe me Israilinë. Edhe ishte atje bashkë me Zotinë dyzet dit e dyzet net; as bukë hëngri, as ujë piu. Edhe shkroj mbi rrasat fjalët' e dhiatësë, të dhjetë porositë.
29 Edhe kur sbriti Moisiu nga mali i Sinajt, edhe të dy rrasatë e dëshmimit ishinë ndë dorët të Moisiut, kur sbriti nga mali, Moisiu nukë dinte se lëkura e faqes' së ti ishte bërë e-
30 ndriturë për të-folurit' e ti me *Perëndinë*. Edhe Aaroni edhe gjithë të bijt' e Israilit panë Moisinë, edhe na tek ndritte lëkura e faqes' s' ati; edhe kishinë frikë t' i afëroneshin' ati.
31 Atëhere Moisiu thirri ata; edhe ukthyenë tek ay Aaroni edhe gjithë të-parët' e përmble-
32 dhjesë; edhe Moisiu u foli atyre. Edhe pastaj gjithë të bijt' e Israilit erthnë përanë; edhe u urdhëroj atyre gjithë sa kishte folurë Zoti
33 me atë ndë malt të Sinajt. Edhe Moisiu mbaroj së-foluri me ata; edhe vuri një mbulesë
34 mbi faqet të ti. Edhe Moisiu, kur hynte përpara Zotit për të folurë me atë, ngrinte mbulesënë, gjersa që dilte; edhe dilte e u fliste të bijvet të Israilit ç' ishte urdhëruarë.
35 Edhe të bijt' e Israilit panë faqen' e Moisiut

se ndritte lëkura e faqes' së Moisiut; edhe Moisiu vinte përsëri mbulesënë mbi faqet të ti, gjersa që të hynte, që të fliste bashkë me Perëndinë.

Krye 35.

1 Edhe Moisiu mblodhi gjithë përmbledhjen' e të bijvet të Israilit, e u tha atyre, Këto janë fjalët që urdhëroj Zoti, për të bërë ato.
2 Gjashtë dit dotë bënetë punë; po e-shtatëta dotë jetë ndër ju dit' e-shënjtëruarë, sabbatë të-prëjturi të-shënuarë mbë Zotinë; gjithëkush që të bënjë punë nd' atë *ditë* dotë vri-
3 tetë. Nukë dotë ndisni zjarr ndëpër gjithë tëndënjuratë t' uaj ditën' e sabbatësë.
4 Edhe Moisiu i foli gjithë përmbledhjes' së të bijvet të Israilit, dyke thënë, Këjo është
5 ajo gjë që urdhëroj Zoti, dyke thënë, Merrni nga mezi juaj dhuratë për Zotinë; kush ka zëmërë të-gatishime *për të dhënë*, let'a bjerë atë, dhuratën' e Zotit; ar, e ergjënt, e ramë;
6 E të-kaltërë, e të-porfyrtë, e të-kuq, e li të-
7 hollë, e lesh dhish, E lëkurë deshësh ngjyerë të-kyqe, e lëkurë delfinësh, e dru shit-
8 timi; E vaj për dritënë, e erëra të-mira për vajin' e të-lyerit, e për thimiamënë me erë
9 të-mirë, E gurë të thonjtë, e gurë për të vënë ndë efodt, e ndë rrasët të krahërorit.
10 Edhe çdo njeri i-mënçim ndë zëmërët ndër mest t' uaj letë vinjë e letë bënjë gji-

11 thë sa urdhëroj Zoti; Tendënë, të-mbuluarët·
e asaj përqark, e mbulesën' e asaj, grepkat'
e asaj, e dhogat' e asaj, shulet' e asaj, shty-
12 llat' e asaj, e shtresat' e asaj; Arkënë, e shu-
let' e asaj, çpërblimtorenë, edhe kurtinënë që
13 mbulon *shënjtëroren' e shënjtërorevet;* Truve-
zënë, edhe shulet' e asaj, edhe gjithë enët' e
14 asaj, e bukën' e parëvënjesë; Kandilerinë për
dritënë, e enët' e ati, e kandilet' e ati, e vajinë
15 për dritënë; E theroren' e thimiamësë, e shu-
let' e asaj, e vajin' e të-lyerit, e thimiamënë me
erë të-mirë, e kurtinën' e derës' së të-hyrit ndë
16 tendët; Theroren' e dhuratës' së-gjithëdjegurë,
e trirën' e-ramtë t' asaj, shulet' e saj, e gjithë
enët' e asaj, lanjëtoren' e shtresën' e asaj;
17 Kurtinat' e oborrit, shtyllat' e ati, e shtresat'
18 e atyreve, e kurtinën' e derës' së oborrit; Hunjt'
e tendësë, e hunjt' e oborrit, e litarët' e aty-
19 reve; Rrobat' e-punuara bukurë, për sbërbe-
sënë ndë shënjtëroret, rrobat' e-shënjtëruara
për Aaroninë, priftinë, edhe rrobat' e të bijvet
t' ati, për të bërë punën' e priftërisë.
20 Edhe gjithë përmbledhja e të bijvet të Isra-
21 ilit dolli që përpara Moisiut. Edhe erthnë, çdo
njeri që i rrihte zëmëra edhe gjithëkujt që i
donte shpirti, *e* prunë dhuratën' e Zotit, për
punën' e tendës' së përmbledhjesë, edhe për
gjithë shërbesën' e asaj, edhe për rrobat' e-
22 shënjtëruara. Edhe erthnë, burra e gra, gjithë
ata që u donte zëmëra, edhe prunë rrathë

duarsh, e vëthë, e unaza, e qafore, gjithë stolit' e-arta; po, gjithë sa prunë dhuratë ari për
23 Zotinë. Edhe çdo njeri, tek i-cili gjëndej tëkaltërë, e të-porfyrtë, e të-kuq, e li të-hollë, e *lesh* dhish, e lëkurë deshësh ngjyerë të-
24 kuqe, e lëkurë delfinësh, i prun' ato. Gjithëkush që muntte t' epte dhuratë ergjëndi e rameje, e pruri dhuratën' e Zotit; edhe çdo njeri, tek i-cili gjëndej dru shittimi për çdo punë të shërbesësë, *e* pruri *atë*.
25 Edhe çdo grua e-mënçime ndë zëmërët drithte me duart' e saj, edhe binte ato që kishte dredhurë, të-kaltëritë, e të-porfyrtëtë,
26 *e* të-kuqtë, e lirin' e-hollë. Edhe gjith' *ato* gra që u dëftente zëmëra dituri drithninë *leshn'* e dhivet.
27 Edhe parësia prunë gurët' e-thonjtë, e gurët' e të-ngulurit, për efodinë, e për rrasën'
28 e krahërorit; Edhe erërat' e-mira, e vajinë për dritënë, e për vajinë për të lyerë, e për thimiamënë me erë të-mirë.
29 Të bijt' e Israilit prunë dhuratë për Zotinë me dashuri prej vetiu, çdo burrë e *çdo* grua, që u donte zëmëra të bininë *dhurata* për gjithë *atë* punënë që kishte urdhëruarë Zoti të bënetë me anë të dorës' së Moisiut.
30 Edhe Moisiu u tha të bijvet të Israilit, Shihni, Zoti thirri më emër Bezaleilinë, të birin' e Uriut; birit të Hurit, nga fara e Ju-
31 dësë; Edhe e mbushi me frymë Perëndie,

ndë dituri, ndë kupëtim, ndë dijë, edhe ndë
32 çdo farë punë njeriu; Edhe që të çpiknjë punëra mjeshtërie, për të punuarë ndë ar, e ndë
33 ergjënt, e ndë ramë; Edhe për të gërvishturë gurë për të vënë, e për të gdhëndurë dru,
34 për të bërë çdo farë pune mjeshtërie. Edhe i dha ndë zëmërët të mësonjë *edhe të-tjerë*, atij, edhe Oholiabit, të birit të Ahisamahut,
35 nga fara e Danit. Këta i mbushi me urtësi, që të punonjënë çdo punë gërvishtari, e mjeshtëri të-çquarë, e qëndisësi, ndë të-kaltërë, e ndë të-porfyrtë, e ndë të-kuq, e ndë li të-hollë, e endësi, po, t' atyreve që punonjënë çdo punë, edhe t' atyreve që çpiknjënë punë mjeshtërie.

Krye 36.

1 Edhe Bezaleili e Oholiabi edhe çdo i-mënçim ndë zëmërët, të-cilit i kishte dhënë Zoti dituri e urtësi, që të dijë si të punonjë çdo punë për shërbesën' e shënjtëroresë, dotë punonjë sipas gjith' atyreve që e kishte urdhëruarë Zoti.

2 Edhe Moisiu thirri Bezaleilinë e Oholiabinë, e çdo njeri të-mënçim ndë zëmërët, ndë zëmërët të të-cilit Zoti kish vënë dituri, po, gjithësicilinë që i rrihte zëmëra të vinte
3 ndë punët, që t'a bënte atë; Edhe muarrë nga Moisiu gjithë dhuratatë, që kishinë prurë

të bijt' e Israilit për punën' e shërbesës' së shënjtëroresë, që me ato t'a bëninë atë.

4 Pastaj i bininë ati dhurata me dashuri prej vetiu mëngjes për mëngjes. Edhe erthnë gjithë njerëzit' e-diturë, të-cilëtë punoninë çdo punë të shënjtëroresë, gjithësicili nga puna
5 e ti që bënte; Edhe i folnë Moisiut, dyke thënë, Gjindja po bje më tepërë se sa duhetë për shërbesën' e punësë që urdhëroj
6 Zoti të bënetë. Edhe Moisiu urdhëroj, edhe lëçiti ndë fushatët, dyke thënë, Asndonjë burrë, asndonjë grua, letë mos bënjë më punë për dhuratën' e shënjtëroresë. Kështu pushoj
7 gjindja së pruri. Sepse lënda që kishinë ishte mjaft për gjithë punënë që kishinë për të bërë, edhe tepëronte.

8 Edhe çdo njeri i-mënçim ndë zëmërët nga ata që punoninë punën' e tendësë, bënë dhjetë kurtina prej liri të-hollë të-dredhurë, e prej të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi; me qerubime
9 ë-punuarë mjeshtërisht i bën' ato. Të-gjatët' çdo kurtine ishte njëzet e tetë kut, edhe ë-gjerët' e çdo kurtine katrë kut; gjithë kur-
10 natë ishinë mbë një masë. Edhe bashkoj të psë kurtinatë njërënë me tjetërënë; edhe të psë kurtinat' *e-tjera* i bashkoj njërënë me
11 tjtërënë. Edhe bëri mbërthecka të-kaltëra mi buzët të kurtinësë që është e fundit ndë pjsët të-parë nga ija e të-bashkuarit; gjithaslu bëri edhe mbi buzët të kurtinësë që

12 ishte e-para ndë pjesët të-dytë. Bëri pesë-
dhjetë mbërthecka mbë njërënë kurtinë, bëri
edhe pesë-dhjetë mbërthecka ndë buzët të
kurtinësë që ishte ndë të-dytët pjesë; mbër-
13 thecka të ishinë kundruell njëra tjetrësë. Edhe
bëri pesë-dhjetë grepka t' arta, edhe me grep-
katë bashkoj kurtinatë njërënë me tjetërënë
kështu tenda ubë një.
14 Edhe bëri kurtina prej *leshi* dhish, që t
jenë për mbulesë mbi tendët; bëri ato një-
15 mbë-dhjetë kurtina. Të-gjatët' e çdo kurtin
ishte tri-dhjetë kut, edhe katrë kut të-gjerë'
e çdo kurtine; të një-mbë-dhjetë kurtinat
16 kishinë gjithatë masë. Edhe bashkoj të pe
kurtinatë veç, edhe të gjashtë kurtinatë ve.
17 Edhe bëri pesë-dhjetë mbërthecka mbi buzët
të kurtinësë që ishte e fundit ndë pjesët ë-
parë, edhe pesë-dhjetë mbërthecka bëri mbi
buzët të kurtinësë që ishte e-para ndë pje-
18 sët të-dytë. Bëri edhe pesë-dhjetë grepkatë-
ramta, për të bashkuarë tendënë, që të jetënjë.
19 Edhe bëri mbulesë për tendënë pre lë-
kurësh deshësh ngjyerë të-kuqe, edhe mbule-
së përsipërë prej lëkurësh delfinësh.
20 Edhe bëri dhogatë për tendënë prej druje
21 shittimi, për të qëndruarë *drejt* përpjetë. Dhjetë
kut ishte të-gjatët' e çdo dhoge, edhe një kut
22 e gjysmë të-gjerët' e çdo dhoge. Çdo dhogë
kishte dy veshë kundruell njëri tjatët; kë-
23 shtu bëri për gjithë dhogat' e tendës Edhe

bëri dhogatë për tendënë, njëzet dhoga për
24 anën' e shiut nga mesdita. Edhe bëri dyzet
shtresa t' ergjëntta ndënë të njëzet dhogatë;
dy shtresa ndënë njërënë dhogë për të dy
veshët' e asaj, edhe dy shtresa ndënë tjetërënë
25 dhogë për të dy veshët' e asaj. Edhe për të-
dytënë anë të tendësë, nga an' e borësë, bëri
26 njëzet dhoga, Edhe të dyzet shtresat' e atyre
t' ergjënta; dy shtresa ndënë njërënë dhogë,
27 edhe dy shtresa ndënë tjetërënë dhogë. Edhe
për anën' e-prapësme të tendësë nga të-pe-
28 rënduarëtë bëri gjashtë dhoga. Edhe dy dho-
ga bëri për çipet' e tendësë nd' anët të-pra-
29 pësme. Edhe ubashkuanë përposh, edhe pas
githasaj mënyre ubashkuanë mbë një ndë
majët t' atyre me anë një rredhi; kështu bë-
30 ri për të dyja ato ndë të dy çipet. Edhe i-
shinë tetë dhoga, edhe shtresat' e atyreve t'
ergjëntta, gjashtë-mbë-dhjetë shtresa; ndënë
çdo dhogë dy shtresa.
31 Edhe bëri shule prej druje shittimi; pesë
32 për dhogat' e njërësë anë të tendësë, Edhe
pesë shule për dhogat' e tjetërës' anë të ten-
dësë, edhe pesë shule për dhogat' e tendësë,
për anën' e-prapësme nga të-perënduarëtë.
33 Edhe bëri shulin' e-mesm që të shkonte dho-
34 gatë ndë mest anë mb' anë. Edhe mbuloj
përqark dhogatë me ar, edhe bëri rrethkat'
e atyreve t' arta që të jenë vënde për shuletë,
edhe i mbuloj përqark shuletë me ar.

35 Edhe bëri kurtinën' *e të-ndarit* prej të-
kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e liri të-hollë
të-dredhurë; me qerubime të-punuarë mje-
36 shtërisht e bëri atë. Edhe i bëri asaj katrë
shtylla prej shittimi, edhe i mbuloj përqark
me ar; grepat' e atyre ishinë t' artë; edhe
derdhi për ato katrë shtresa t' ergjëntta.
37 Edhe bëri kurtinënë për derën' e tendësë
prej të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e liri
të-hollë të-dredhurë, me punë të-qëndisuri;
38 Edhe të pesë shtyllat' e asaj me grepat' e
atyreve; edhe mbuloj krerët' e atyreve, edhe
oviskat' e atyreve, me ar; po të pesë shtresat'
e atyreve ishinë të-ramta.

Krye 37.

1 Edhe Bezaleili bëri arkënë prej druje shit-
timi; dy kut e gjysmë të-gjatë e një kut e
gjysmë të-gjerë, e një kut e gjysmë të-lartë;
2 Edhe e mbuloj përqark me ar të-kulluarë
përbrënda e përjashta, edhe i bëri asaj për-
3 qark një kurorë t' artë. Edhe derdhi për atë
katrë rrethka t' arta, për të katrë çipet' e a-
saj; dy rrethka mbë njërënë ijë t' asaj, edhe
4 dy rrethka mbë tjetërënë ijë t' asaj. Edhe bëri
shule prej druje shittimi, edhe i mbuloj për-
5 qark me ar. Edhe vuri shuletë ndë rrethkat
ndë ijët të arkësë, për të mbarturë arkënë.
6 Edhe bëri çpërblimtorenë prej ari të-ku-
lluarë; dy kut e gjysmë të-gjatë, e një kut e
gjysmë të-gjerë.

7 Edhe bëri dy qerubime prej ari; të-rra-
hur' i bëri ata, ndë të dy anët të çpërblim-
8 toresë; Një qerubim mbë njërënë anë, e një qe-
rubim mbë tjetërën' anë; një trup me çpërblim-
torenë i bëri qerubimetë mbë të dy anët t'
9 asaj. Edhe qerubimetë ndeninë krahët' e tyre
përpjetë, e mbuloninë çpërblimtorenë me kra-
hët' e tyre, edhe faqet' e atyre ishinë kundruell
njëra tjatërësë; nga çpërblimtoreja shikoninë
faqet' e qerubimevet.
10 Edhe bëri truvezënë prej druje shittimi;
dy kut të-gjatë, e një kut të-gjerë, e një kut
11 e gjysmë të-lartë; Edhe e mbuloj përqark me
ar të-kulluarë, edhe i bëri asaj një kurorë
12 t' artë rreth e rrotullë. Edhe i bëri asaj një
buzë përqark, një pëlëmbë *të-gjerë*, edhe bëri
një kurorë t' artë mbi buzët t' asaj rreth e
13 rrotullë. Edhe derdhi për atë katrë rrethka
t' arta, edhe vuri rrethkatë ndë të katrë çi-
pet, që ishinë mbë të katrë këmbët' e asaj.
14 Ndënë buzët ishinë rrethkatë, vëndet' e shu-
15 levet, për të mbarturë truvezënë. Edhe bëri
shuletë prej druje shittimi, edhe i mbuloj
përqark me ar, për të mbarturë truvezënë.
16 Edhe bëri enëtë që ishinë mbi truvezët, dhis-
qet' e asaj, e thimiatorët' e asaj, e taset' e a-
saj, e botilet' e asaj, për të çpërkaturë me
to, *të-gjitha* prej ari të kulluarë.
17 Bëri edhe kandilerinë prej ari të-kulluarë;
kandilerinë e bëri të-rrahurë, po, fron' e ati'

e trupin' e ati; lekanët' e ati, sumbullat' e ati,
e lulet' e ati, ishinë një kurm bashkë me atë.
18 Edhe gjashtë dega dilninë nga ijët' e ati; tri
dega të kandilerit nga njëra ijë e ati, edhe
tri dega të kandilerit nga tjetëra ijë e ati;
19 Tre lekanë bërë si lule bajameje, një sum-
bullë e një lule mbë njërënë degë, edhe tre
lekanë bërë si lule bajameje, një sumbullë,
e një lule mbë tjetrënë degë; kështu *bëri* për
të gjashtë degatë, që dilninë nga kandileri.
20 Edhe ndë kandilert ishinë katrë lekanë bërë
si lule bajameje, sumbullat' e atyre, edhe lu-
21 let' e atyre; Edhe një sumbullë ndënë të dy
degatë nga ay, e një sumbullë ndënë të dy
degatë nga ay, e një sumbullë ndënë të dy
degatë nga ay; *kështu bëri* për të gjashtë
22 degatë që dilninë nga ay. Sumbullat' e aty-
reve e degat' e atyreve ishinë një trup me
atë; i-tërë ay ishte pun' e-rrahurë prej ari
23 të-kulluarë. Edhe bëri të shtatë kandilet' e ati
edhe gërshërët' e ati, edhe dhisket' e shkrum-
24 bit t' ati, prej ari të-kulluarë. Prej një tallan-
di ari të-kulluarë e bëri atë, edhe gjithë
enët' e ati.
25 Edhe bëri theroren' e thimiamësë prej
druje shittimi; një kut të-gjatë, e një kut të-
gjerë, me katrë çipe; edhe dy kut ishte të-
lartët' e asaj; brirët' e asaj ishinë një trup
26 me atë. Edhe e mbuloj atë përqark me ar
të-kulluarë, të-sipërmen' e asaj, e ijët' e asaj

rreth e rrotullë, edhe brirët' e asaj; edhe i
bëri asaj një kurorë t' artë rreth e rrotullë.
27 Edhe bëri për atë dy rrethka t' arta ndënë
kurorët t' asaj, afërë të dy çipevet t' asaj, mbë
të dy ijët' e asaj, që *të-jenë* vënde për shu-
28 letë, që t'a mbaninë me anë t' atyreve. Edhe
bëri shuletë prej druje shittimi, edhe i mbu-
loj përqark me ar.
29 Edhe bëri vajin' e-shënjtëruarë për të ly-
erë, edhe thimiamën' e-qëruarë me erë të-
mirë, pas mjeshtëris' s' ati që bën erëra të-
mira.

Krye 38.

1 Edhe bëri theroren' e dhuratës' së-gjithë-
djegurë prej druje shittimi; pesë kut të-gjatë,
e pesë kut të-gjerë, me katrë çipe; edhe tre
2 kut të-lartë. Edhe bëri brirët' e asaj mbë të
katrë çipet' e asaj; brirët' e asaj ishinë një
trup me atë; edhe e mbuloj përqark me ra-
3 më. Edhe bëri gjith' enët' e theroresë, kusitë,
e tërplotetë, e lekanëtë, e sfurgjetë për të zënë
mishinë, e kacitë; gjithë enët' e asaj i bëri
4 të-ramta. Edhe bëri për therorenë një trirë
të-ramtë punuarë si rjetë, ndënë rrethin' e
asaj rrotullë përposh, që arrinte përpjetë gjer
5 ndë gjysmët t' asaj. Edhe derdhi katrë rreth-
ka për të katrë çipet' e trirës' së-ramtë, që
6 të jenë vënde për shuletë. Edhe bëri shuletë
prej druri shittimi, edhe i mbuloj përqark me

7 ramë. Edhe kalli shuletë ndë rrethkat mbë
ijët të theroresë, për të mbarurë atë me anë
t' atyreve; e bëri atë prej dhogash posi gropë.
8 Edhe bëri lanjëtorenë të-ramtë, edhe shtre-
sën' e asaj të-ramtë, nga pasqyrat' e gravet,
të-cilatë mblidheshinë për të shërbyerë pë-
ranë derës' së tendës' së përmbledhjesë.
9 Edhe bëri oborrinë; për brinjën' e shiut
nga mesdita kurtinat' e oborrit ishinë prej liri
10 të-hollë të-dredhurë, një qint kut. Shtyllat' e
atyreve ishinë njëzet, edhe shtresat' e atyreve
njëzet, të-ramta; grepat' e shtyllavet edhe
11 brezat' e atyreve *ishinë* t' ergjënttë. Edhe për
brinjënë nga an' e borësë *kurtinatë* ishinë një
qint kut; shtyllat' e atyreve njëzet, edhe shtre-
sat' e atyreve një-zet, të-ramta; grepat' e
shtyllavet e brezat' e atyreve ishinë t' ergjent-
12 të. Edhe për brinjënë nga ana e të-perënduarit kurtinatë ishinë pesë-dhjetë kut; shtyllat'
e atyreve dhjetë, e shtresat' e atyreve dhjetë;
grepat' e shtyllavet e brezat' e atyreve ishinë
13 t'ergjënttë. Edhe për brinjënë nga ana e lindje-
14 së që lint djelli pesë-dhjetë kut. Kurtinatë për
njërënë anë *të derësë* ishinë pesë-mbë-dhjetë
kutsh; shtyllat' e atyreve tri, e shtresat' e a-
15 tyreve tri; Kështu edhe për tjetërënë anë,
mbë këtʼ anë e mbʼ atë anë të derës' s' obo-
rrit ishinë kurtina pesë-mbë-dhjetë kutsh;
shtyllat' e atyreve tri, e shtresat' e atyreve tri.
16 Gjithë kurtinat' e oborrit rreth e rrotullë i-

17 shinë prej liri të-hollë të-dredhurë. Edhe
shtresatë për shtyllatë ishinë të-ramta; gre-
pat' e shtyllavet edhe brezat' e atyreve ishinë
t' ergjënttë; edhe krerët' e shtyllavet ishinë
18 mbuluarë me ergjënt. Edhe kurtina për de-
rën' e oborrit ishte punuarë me të-qëndisurë,
prej të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e liri
të-hollë të-dredhurë; edhe njëzet kut ishte e-
gjatë, edhe pesë kut e-lartë për-së-gjeri, si-
19 kundrë ndë kurtinat të oborrit. Edhe shtyllat'
e atyreve ishinë katrë, edhe shtresat' e aty-
reve katrë, të-ramta; grepat' e atyreve t' er-
gjënttë, edhe krerët' e shtyllavet ishinë mbu-
luarë me ergjënt, edhe brezat' e atyreve i-
20 shinë t' ergjënttë. Edhe gjithë hunjt' e tendës'
e të oborrit rreth e rrotullë ishinë të-ramtë.
21 Ky është numëri i plaçkavet të tendësë,
të tendës' së dëshmimit, sikundrë unumëruanë,
pas urdhërit të Moisiut, për shërbesën' e
Levitëvet, me dorë të Ithamarit, të birit të
priftit Aaron.
22 Edhe Bezaleili, i biri i Uriut, birit të Hu-
rit, nga fara e Judësë, bëri gjithë sa i ur-
23 dhëroj Zoti Moisiut. Edhe ishte bashkë me
atë Oholiabi, i bir' i Ahisamahut, nga fara e
Danit, një gërvishtar edhe mjeshtër që i pill-
te mëndja, edhe qëndisës ndë të-kaltërë, e
ndë të-porfyrtë, e ndë të-kuq, e ndë li të-
hollë.
24 Gjithë ari që uprish për punënë ndë gji-

thë punët të shënjtëroresë, ari i dhurëtisë, ishte njëzet e nëntë tallandë edhe shtatë qint e tri-dhjetë shekëlla, pas shekëllës' së shënjtëroresë.

25 Edhe ergjëndi i atyreve që unumëruanë nga përmbledhja ishte një qint tallandë, edhe një mijë e shtatë qint e gjashtë-dhjet' e pesë
26 shekëlla, pas shekëllës' së shënjtëroresë; Nga një beka për krye, do-me-thënë gjysmë shekëllë, pas shekëllës' së shënjtëroresë, për gjithësicilinë, që shkonte mbë të-numëruarëtë, që njëzet vjet e përpjetë, për gjashtë qint e tri mijë e pesë qint e pesë-dhjetë *shpirt.*
27 Edhe të pesë qint tallandët' e ergjëndit ishinë për të uderdhurë shtresat' e shënjtëroresë, edhe shtresat' e kurtinës' *së të-ndarit*; një qint shtresa nga një qint tallandë, një tallant për
28 një shtresë. Edhe nga të një mijë e shtatë qint e shtatë-dhjet' e pesë *shekëllatë* bëri grepatë për shtyllatë, edhe mbuloj përqark krerët' e shtyllavet, edhe bëri breza për ato.
29 Edhe rama e dhurëtisë ishte shtatë-dhjetë talandë, e dy mijë e katrë qint shekëlla.
30 Edhe me këtë bëri shtresatë ndë derët të tendës' së përmbledhjesë, edhe theroren' e-ramtë, edhe trirën' e-ramtë për atë, edhe gji-
31 thë enët' e theroresë, Edhe shtresat' e oborrit rreth e rrotullë, edhe shtresat' e derës' s' oborrit, edhe gjithë hunjt' e oborrit rreth e rrotuilë.

Krye 39.

1 Edhe nga të-kaltëritë, e të-porfyrtëtë, e të-
kuqtë, bënë rroba të-punuara bukurë, për të
shërbyerë ndë shënjtëroret, edhe bënë rrobat'
e-shënjtëruara për Aaroninë, sikundrë urdhë-
roj Zoti Moisinë.
2 Edhe bëri efodinë prej ari, *e* të-kaltëri, e
të-porfyrti, e të-kuqi, e liri të-hollë të-dre-
3 dhurë. Edhe e rrahnë arinë *edhe e bënë* petë
të-holla edhe e prenë fije fije, që t' e puno-
ninë ndë të-kaltërë, e të-porfyrtë, e të-kuq,
4 e ndë li të-hollë, me punë mjeshtërie. Bënë
copa të supevet për atë, të-cilatë bashko-
neshinë; mbë të dy anët ishte i-bashkuarë.
5 Edhe brezi, i-endurë mjeshtërisht i-cili ishte
mbi atë, për të ngjeshur' atë, ishte prej gjith-
asaj gjëje, *edhe* si pun' e ati; prej ari, prej
të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e liri të-
hollë të-dredhurë; sikundrë urdhëroj Zoti
Moisinë.
6 Edhe punuanë gurët' e-thonjtë e i ngulnë
ndë shtëpiza t' arta, e i gërvishtnë, sikundrë
gërvishtenë vulatë, pas emëravet të bijvet të
7 Israilit. Edhe i vuri mbi copat të supevet t'
efodit, që të jenë gurë kujtimi për të bijt' e
Israilit; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
8 Edhe bëri rrasën' e krahërorit me punë
mjeshtërie, pas punës' s' efodit, prej ari, prej
të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e liri të-

9 hollë të-dredhurë. Ishte me katrë çipe; të-
dymëzuarë e bënë rrasën' e krahërorit; një
pëllëmbë të-gjatë, e një pëllëmbë të-gjerë, të-
10 dymëzuarë. Edhe ngulnë nd' atë katrë sërë
gurësh; e-para sërë me një sardi, me një to-
11 paz, e me një smaragdh. Edhe e-dyta sërë
kishje një thëngjillës, një sapfir, e një dia-
12 mant. Edhe e-treta sërë, një ligjyr, një agat,
13 e një amethyst. Edhe e-katrëta sërë, një be-
ryl, një thonjës, e një jaspidhe; këta ishinë
ngulurë ndë shtëpiza t' arta ndë të-mbyllurat
14 të tyre. Edhe gurëtë ishinë pas emëravet të
bijvet të Israilit, dy-mbë-dhjetë, pas emëravet
t' atyre; mbë sicilinëdo nga ata, pas të-gërvi-
shturit të vulësë, *ishte gërvishturë* një emër
nga emërat' e të dy-mbë-dhjetë faravet.
15 Edhe mbi rrasët të krahërorit bënë vargje
të-gërshetuarë si kordhella, prej arí të-kullu-
16 arë. Edhe bënë dy shtëpiza t'arta, e dy rrethka
t' arta; edhe vunë të dy rrethkatë ndë të dy
17 çipet të rrasës' së krahërorit. Edhe vunë të
dy vargjet' e-artë të-gërshetuarë ndë të dy
rrethkat *që ishinë* mbë çipet të rrasës' së
18 krahërorit. Edhe të dy anët' *e-tjera* e të dy
vargjevet të-gërshetuarë i ngjitnë ndë të dy
shtëpizat, edhe i vunë mbi copat të supe-
19 vet t' efodit, nga an' e-përparshime e ati. Edhe
bënë dy rrethka t' arta, edhe i vunë ato ndë
të dy ijët të rrasës' së krahërorit, ndë buzët
t' ati, që ishte përbrënda nga an' e efodit.

20 Edhe bënë dy rrethka t' arta, e i vunë ndë
të dy copat të supevet të efodit që përposh,
ndë anët të-përparshime t' ati, përanë të-ba-
shkuarit t' ati, përmbi uvëjen' e-endurë mje-
21 shtërisht të efodit. Edhe lithnë rrasën' e kra-
hërorit me anë të rrethkavet t' asaj ndë rreth-
kat të efodit me një oviskë të-kaltërë, që të
jetë përmbi uvëjen' e-qëndisurë mjështërisht
të efodit, edhe që të mos jetë e-ndarë rrasa e
krahërorit nga efodi; sikundrë urdhëroj Zoti
Moisinë.
22 Edhe bëri rrobën' e efodit të-endurë, të-
23 tërë prej të-kaltëri; Edhe grykën' e rrobësë
ndë mest t' asaj, posi grykë thurakeje, me
oviskë përqark grykës' s' asaj, që të mos çi-
24 rej. Edhe mbi pëqinjt të rrobësë bënë shegë
prej të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, e *liri*
25 të-dredhurë. Edhe bënë këmborëza prej ari
të-kulluarë, edhe vunë këmborëzatë ndë mest
të shegëvet mbi pëqinjt të rrobësë rreth e
26 rrotullë, ndër mest të shegëvet; Një këmbo-
rëzë e një shegë, një këmborëzë e një shegë,
rreth e rrotullë mbi pëqinjt të rrobësë, për të
bërë shërbesënë; sikundrë urdhëroj Zoti Mo-
isinë.
27 Edhe bënë rroba *të-gjata* të-endura prej liri
të-hollë për Aaronin' edhe për të bijt' e ati,
28 Edhe mitrënë prej liri të-hollë, edhe mitrat'
e-vogëla të-bukura prej liri të-hollë, edhe
brekët' e-linjtë prej liri të-hollë të-dredhurë,

29 Edhe brezinë prej liri të-hollë të-dredhurë, e
prej të-kaltëri, e të-porfyrti, e të-kuqi, me
punë qëndisësi; sikundrë urdhëroj Zoti Mo-
isinë.
30 Edhe bënë petullën' e kurorës' së-shënjtë-
ruarë prej ari të-kulluarë, edhe shkruanë mbi
atë shkronja, pas të-gërvishturit të vulësë,
31 **Shënjtërim te Zoti.** Edhe lithnë mbi atë
një oviskë të-kaltërë, që t'e siguroninë së-
sipërmi mbi mitrënë; sikundrë urdhëroj Zoti
Moisinë.
32 Kështu umbarua gjithë puna e të-Ndënju-
rit të tendës' së përmbledhjesë; edhe të bijt'
e Israilit bënë sipas gjith' atyreve që urdhëroj
Moisinë Zoti; kështu bënë.
33 Edhe e prunë tendënë te Moisiu, tendën'
edhe gjithë enët' e asaj, grepkat' e asaj, dho-
gat' e asaj, shulet' e asaj, e shtyllat' e asaj, e
34 shtresat' e asaj; Edhe mbulesënë që ishte
prej lëkurësh deshësh ngjyerë të-kuqe, edhe
mbulesën' *e-sipërme* që ishte prej lëkurësh del-
35 finësh, edhe kurtinën' e të-ndarit; Arkën' e
dëshmimit, e shulet' e asaj, e çpërblimtorenë;
36 Truvezënë, gjithë enët' e asaj, edhe bukët' e
37 parëvënjesë; Kandilerin' e-kulluarë, kandilet'
e ati, kandiletë pas të-radhiturit t' atyre, e
38 gjithë enët' e ati, e vajin' e dritësë; E theror-
en' e-artë, e vajinë për të lyerë, e thimiamë-
në me erë të-mirë, e kurtinënë për derën' e
39 tendësë; Theroren' e-ramtë, e trirën' e asaj

të-ramtë, shulet' e asaj, e gjithë enët' e asaj,
40 lanjëtorenë edhe shtresën' e asaj; Kurtinat' e oborrit, shtyllat' e ati, e shtresat' e ati, e kurtinënë për derën' e oborrit, litarët' e asaj, e hunjt' e asaj, edhe gjithë enët' e shërbesës' së tendësë, për tendën' e përmbledhjesë;
41 Rrobat' e-punuara mjeshtërisht, për punën' e shërbesësë ndë shënjtëroret, edhe rrobat' e-shënjtëruara për priftinë Aaron, edhe rrobat' e të bijvet t' ati, për të bërë shërbesën' e priftërisë.
42 Sipas gjith' atyreve që urdhëroj Zoti Moisinë, kështu bënë të bijt' e Israilit gjithë pu-
43 nënë. Edhe Moisiu pa gjithë punënë, edhe na tek e kishinë bërë atë; sikundrë kishte urdhëruarë Zoti, kështu e kishinë bërë; edhe Moisiu i bekoj ata.

Krye 40.

1 Edhe Zoti i foli Moisiut, dyke thënë,
2 Të-parënë ditë të muajt të-parë dotë ngrehç
3 të-Ndënjurit' e tendës' së përmbledhjesë. Edhe dotë vësh nd' atë arkën' e dëshmimit, edhe dotë
4 mbulonjç arkënë me kurtinënë. Edhe dotë bjesh brënda truvezënë, edhe dotë vësh mbë sërë gjërëratë që janë mbi atë; edhe dotë bjesh brënda kandilerinë, edhe dotë ndesç
5 kandilet' e atij. Edhe dotë vësh theroren' e-artë për thimiamënë përpara arkës' së dëshmimit, edhe dotë vësh kurtinën' e derësë ndë

6 tendët. Edhe dotë vësh theroren' e dhuratës'
së-gjithëdjegurë përpara derës' së të-Ndënjurit
7 të tendës' së përmbledhjesë. Edhe dotë vësh
lanjëtorenë ndër mest të tendës' së përmble-
dhjesë e të theroresë, edhe dotë vësh ujë nd'
8 atë. Edhe dotë ngrehç avllinë rreth e rrotullë,
edhe dotë varç kurtinën' e derës' s' oborrit.
9 Edhe dotë marrç vajin' e të-lyerit, e dotë
lyenjç tendënë e gjith' ato që janë nd' atë,
edhe dotë shënjtëronjç atë, e gjith' enët' e a-
10 saj; edhe dotë jet' e-shënjtëruarë. Edhe dotë
lyenjç 'theroren' e dhuratës' së-gjithëdjegurë,
e gjith' enët' e asaj, edhe dot' e shënjtëronjç
therorenë; edhe theroreja dotë jetë fort e-
11 shënjtëruarë. Edhe dotë lyenjç lanjëtoren'
edhe shtresën' e asaj, edhe dot' e shënjtë-
ronjç atë.
12 Edhe dotë bjesh Aaroninë edhe të bijt' e
ati ndë derët të tendës' së përmbledhjesë, e
13 dot' i lash ata me ujë. Edhe dot' i veshç Aa-
ronit rrobat' e-shënjtëruara; edhe dot' e lyenjç
atë, e dot' e shënjtëronjç, që të më shërbenjë
14 mua ndë shërbesët të priftërisë. Edde dotë
bjesh të bijt' e ati, e dot' u veshç rrobatë;
15 Edhe dot' i lyenjç ata, sikundrë leve t' an' e
atyre, që të më shërbenjënë mua ndë shër-
besët të priftërisë; edhe të-lyerit' e atyreve
dotë jetë ndër ata për priftëri të-përjetëshme
ndër brezat t' atyreve.
16 Kështu bëri Moisiu; pas gjith' atyreve që

17 e urdhëroj Zoti atë, kështu bëri. Edhe të-parinë muaj të vitit të-dytë, të-parënë ditë të muajt, ugreh tenda.
18 Edhe Moisiu ngrehu tendënë, edhe vuri shtresat' e asaj, edhe ngrehu dhogat' e asaj, edhe vuri shulet' e asaj, edhe ngrehu shtyllat'
19 e asaj. Edhe ndejti kurtinatë mbi tendët, edhe vuri mbulesën' e tendësë mbi atë përsipërë; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
20 Edhe mori dëshmiminë, edhe e vuri nd' arkët, edhe vuri shuletë mbi arkët, edhe vuri
21 çpërblimtorenë mbi arkët, përsipërë; Edhe pruri arkënë ndë tendët, edhe vuri kurtinënë e të-mbuluarit, edhe mbuloj arkën' e dëshmimit; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
22 Edhe vuri truvezënë ndë tendët të përmbledhjesë, mb' anët të tendësë nga ana e
23 borësë, përjashta kurtinës' *së të-ndarit*. Edhe vuri ndë radhë bukëtë mbi atë përpara Zotit; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
24 Edhe vuri kandilerinë ndë tendët të përmbledhjesë, kundruell truvezësë, mb' anët të
25 tendësë nga an' e mesditësë, Edhe dezi kandiletë përpara Zotit; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
26 Edhe vuri theroren' e-artë ndë tendët të përmbledhjesë përpara kurtinës' së të-ndarit,
27 Edhe dogji mbi atë thimiamë me erë të-mirë; sikundrë urdhëroj Zoti Moisinë.
28 Edhe vari kurtinënë ndë derët të tendësë.

29 Edhe theroren' e dhuratës' së-gjithëdjegurë e
vuri përanë derës' së të-Ndënjurit të tendës' së
përmbledhjesë, edhe pruri mbi atë dhuratë
të-gjithëdjegurë edhe dhuratë të-ngreni; si-
kundrë Zoti urdhëroj Moisinë.
30 Edhe vuri lanjëtorenë ndër mest të ten-
dës' së përmbledhjesë e të theroresë, edhe
31 vuri ujë nd' atë, që të laheshinë me atë. Edhe
Moisiu e Aaroni e të bijt' e ati laninë prej
32 ati duart' e tyre e këmbët' e tyre. Kur hyninë
ndë tendët të përmbledhjesë, e kur i afëro-
neshinë theroresë, laheshinë; sikundrë Zoti
urdhëroj Moisinë.
33 Edhe ngrehu oborrinë përqark tendës' e
theroresë, edhe vari kurtinën' e derës' s' obo-
rrit. Kështu Moisiu mbaroj punënë.
34 Atëhere reja mbuloj tendën' e përmble-
dhjesë, edhe lavdia e Zotit mbushi tendënë.
35 Edhe Moisiu nukë muntte të hynte ndë ten-
dët të përmbledhjesë; sepse reja rrinte mbi
atë, edhe lavdia e Zotit mbushi tendënë.
36 Edhe reja kur ngrihej lart që përmbi ten-
dët, të bijt' e Israilit ngriheshinë e merrninë
37 udhë, ndë gjithë të-udhëtuarat të tyre; Po
ndë mos ngrihej reja lart, atëhere nukë merr-
ninë udhë gjer ditënë që të ngrihej lart.
38 Sepse reja e Zotit ishte mbi tendët ditënë,
edhe zjarr ishte mbi atë natënë, përpara sy-
vet të gjithë shtëpis' së Israilit, ndë gjithë të-
udhëtuarat t' atyre.